



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK**

Korçë më 21.1.2026

Lënda: Njoftim

Drejtuar: Këshilltarëve të Këshillit Bashkiak Korçë

Kryetarit të Bashkisë Korçë **z.Sotirag Filo**

Njoftohen të gjithë këshilltarët e Këshillit Bashkiak Korçë dhe Kryetari i Bashkisë Korçë z.Sotirag Filo, se ditën **e enjte, datë 29 janar 2026, ora 12⁰⁰** do të zhvillohet mbledhja e Këshillit në sallën e Këshillit Bashkiak, në zbatim të ligjit nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni 53,pika 4 si dhe bazuar në Rregulloren e Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Korçë miratuar me VKB nr.80, datë 30.07.2020 , neni 63, neni 64 me rend dite si më poshtë:

- 1- “PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS”.
- 2- “PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 26 DHJETOR 2025.”
- 3- “ MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6 % E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR PËR PERIUDHËN 1-31 DHJETOR 2025”.

(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, të Drejtave të Njeriut) , znj.Anxhela Taho, znj. Edlira Mitre, znj. Ornella Alikaj, z. Erion Kurti, znj. Jorida Romaçka, z.Lorenc Nako, znj. Laureta Alidinaj.

- 4- “MBI DHËNIEN E MBËSHTETJES FINANCIARE, SIPAS VKM NR.835, DATË 30.12.2025 “PËR MBËSHTETJEN FINANCIARE TË DISA KATEGORIVE TË VEÇANTA PËR VITIN 2025”, PËR 12 FAMILJE TË NDIHMËS EKONOMIKE”.

(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, të Drejtave të Njeriut) , znj.Anxhela Taho, znj. Edlira Mitre, znj. Ornela Alikaj, z. Erion Kurti, znj. Jorida Romaçka, z.Lorenc Nako, znj. Laureta Alidinaj.

5- “ PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE, ME 6 % NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE, PËR VITIN 2026.”

(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, të Drejtave të Njeriut) , znj.Anxhela Taho, znj. Edlira Mitre, znj. Ornela Alikaj, z. Erion Kurti, znj. Jorida Romaçka, z.Lorenc Nako, znj. Laureta Alidinaj.

6- “ PËR MIRATIMIN E KRITEREVE PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE, NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, PËR VITIN 2026”.

(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, të Drejtave të Njeriut) , znj.Anxhela Taho, znj. Edlira Mitre, znj. Ornela Alikaj, z. Erion Kurti, znj. Jorida Romaçka, z.Lorenc Nako, znj. Laureta Alidinaj.

7- “ MBI MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA”.

(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, të Drejtave të Njeriut) , znj.Anxhela Taho, znj. Edlira Mitre, znj. Ornela Alikaj, z. Erion Kurti, znj. Jorida Romaçka, z.Lorenc Nako, znj. Laureta Alidinaj.

8- “PËR MIRATIMIN E FONDIT PUBLIK TË BANESAVE SOCIALE DHE PËRDORIMIN E TIJ NË BUXHETIN E VITIT 2026”.

(Komisioni i Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, të Drejtave të Njeriut) , znj.Anxhela Taho, znj. Edlira Mitre, znj. Ornela Alikaj, z. Erion Kurti, znj. Jorida Romaçka, z.Lorenc Nako, znj. Laureta Alidinaj.

(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake dhe planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare) z.Altin Habip, znj. Ada Përmeti, z.Petrika Tollkuçi, znj.Mirela Qeleshi, znj. Alketa Zheku.

9- “PËR VLERËSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME TË TË ARDHURAVE PËR VITET 2027-2029.”

(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake dhe planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare) z.Altin Habip, znj. Ada Përmeti, z.Petrika Tollkuçi, znj.Mirela Qeleshi, znj. Alketa Zheku.

- 10- “ PËR MIRATIMIN E RRITJES SË PLANIT TË TË ARDHURAVE DHE PËRDORIMIN E FONDIT TË FINANCUAR NGA KËSHILLI I QARKUT KORÇË NË VLERËN 641,850 LEKË PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT “ SHËRBIME SOCIALE E SHËNDETËSORE TË PËRSHTATSHME TË INTEGRUARA PËR TË MOSHUARIT.”

(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake dhe planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare) z. Altin Habip, znj. Ada Përmeti, z. Petrika Tollkuçi, znj. Mirela Qeleshi, znj. Alketa Zheku.

- 11- “ PËRMIRATIMIN E GRANDIT TË BAZUAR NË PERFORMANCË, ME BURIM FINANCIAR TË HUAJ NË VLERËN 1.111.093.19 LEKË”.

(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake dhe planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare) z. Altin Habip, znj. Ada Përmeti, z. Petrika Tollkuçi, znj. Mirela Qeleshi, znj. Alketa Zheku.

- 12- “ PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL PËR INSTITUCIONIN E BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2026”.

(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë) z. Erjon Nexhipi, znj. Edlira Mitre, z. Kristiano Koçibelli, z. Erion Kurti dhe znj. Mirela Qeleshi.

- 13- “ MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRZGJEDHJEN NËPËRMJET KONKURIMIT TË SUBJEKTIT QË DO TË PROMOVOJË KORÇËN SI DESTINACION TURISTIK”.

(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë) z. Erjon Nexhipi, znj. Edlira Mitre, z. Kristiano Koçibelli, z. Erion Kurti dhe znj. Mirela Qeleshi.

- 14- “ PËR MIRATIMIN E DISA VLERËSIMEVE, QË MUND TË JEPEN NGA KRYETARI I BASHKISË KORÇË”.

(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë) z. Erjon Nexhipi, znj. Edlira Mitre, z. Kristiano Koçibelli, z. Erion Kurti dhe znj. Mirela Qeleshi.

- 15- “ PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT “STIMULIM I ARTIZANËVE” DHE PËRZGJEDHJEN E PARTNERIT PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTI NË PAZARIN KORÇËS.”

(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurive të Bashkisë) z. Erjon Nexhipi, znj. Edlira Mitre, z. Kristiano Koçibelli, z. Erion Kurti

dhe znj. Mirela Qeleshi.

- 16- “PËR MIRATIMIN DHE PËRDORIMIN E SIMBOLIT “KORÇA EUROPEAN CITY OF SPORT” NË KUADËR TË MARRJES SË TITULLIT “KORÇA QYTETI EUROPIAN I SPORTIT 2026.”

(Komisioni i Rregullores, Çështjeve Ligjore dhe Administrative dhe Pasurivve të Bashkisë) z. Erjon Nexhipi, znj. Edlira Mitre, z. Kristiano Koçibelli, z. Erion Kurti dhe znj. Mirela Qeleshi.

- 17- SIPAS KËRKESËS TË SHOQËRISË “KORÇA 2008 ” SH.A PËR THIRRJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE PËR SHQYRTIMIN E MATERIALIT SI MË POSHTË:

- PËR EMËRIMIN DHE MIRATIMIN E AUDITUESVE LIGJORË PËR AUDITIMIN LIGJOR TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN 2025 “TË KORÇA 2008” SH.A.

(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake dhe planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare) z. Altin Habip, znj. Ada Përmeti, z. Petrika Tollkuçi, znj. Mirela Qeleshi, znj. Alketa Zheku.

- 18- SIPAS KËRKESËS TË SHOQËRISË “QËNDRA SPORTIVE KORÇË” SH.A PËR THIRRJEN E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË AKSIONERËVE PËR SHQYRTIMIN E MATERIALIT SI MË POSHTË:

- PËR MIRATIMIN E TRAJTIMIT USHQIMOR DHE DIETAVE PËR EKIPI E PARË DHE AKADEMINË “SKËNDERBEU” PËR VITIN 2026.

(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake dhe planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare) z. Altin Habip, znj. Ada Përmeti, z. Petrika Tollkuçi, znj. Mirela Qeleshi, znj. Alketa Zheku.

- PËR EMËRIMIN DHE MIRATIMIN E SKEMËS TË SHPËRBLIMEVE TË AUDITUESVE LIGJORË PËR AUDITIMIN LIGJOR TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN 2025 TË “QËNDRA SPORTIVE KORÇË” SH.A.

(Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake dhe planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare) z. Altin Habip, znj. Ada Përmeti, z. Petrika Tollkuçi, znj. Mirela Qeleshi, znj. Alketa Zheku.

- 19- RAPORTI I PERFORMANCËS I BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2024.

- 20- PIKA TË NDRYSHME.

21- KËRKESA-ANKESA TË QYTETARËVE.

Mbledhjet e komisioneve do të zhvillohen ditën e hënë, datë 26.01.2026 , ora 11⁰⁰

**Komisioni i Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, dhe Mbikqyrjes Financiare) z. Altin Habip, znj. Ada Përmeti
z. Petrika Tollkuçi, znj. Mirela Qelesi, znj. Alketa Zheku ditën e hënë 26.01.2026, ora 12⁰⁰**

Komisionet do të zhvillojnë mbledhjet në sallën e Këshillit Bashkiak.

Kryetare e Këshillit Bashkiak

Ana VERUSHI

PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 26 DHJETOR 2025

Kryesuesi I mbledhjes është: Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi

Ora e hapjes së mbledhjes: 10:00

Zhvillimi i mbledhjes: Në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 27

Sekretari i Këshillit deklaroi kourumin prej këshilltarësh: 27

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Kryetari i Bashkisë Sotiraq Filo dhe Drejtorë të Administratës.

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 0

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Mirëmengjesi të gjithëve së pari dua t'ju uroj Gëzuar Krishtlindjet, paçi bekime, mirësi në familjet tuaja. Ndonse është ditë pushimi ne jemi dakortësuar që mbledhjen e Këshillit të programuar ta zhvillojmë sot. Së pari doja ta filloja me rendin e ditës kush është dakort?

Këshilltar E.Bregu: Propozoj disa ndryshime për rendin e ditës.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Çfarë ndryshime?

Këshilltar E.Bregu: Është një qytetare që ka bërë kërkesën për ngritjen e komisionit për verifikimin e banesave ka disa muaj dhe Këshilli është dakortësuar se do e ngreje komisionin, pavarisht se në një mbledhje u ngrit një komision për zgjerimin e subjektit apo miratimin e disa rregulloreve shtesë, thelbi kryesor mbi të cilin është rënë dakort ngritja e komisionit të verifikimit, gjë që nuk është bërë prej kohësh, para dy javësh le të themi zonja ka bërë kërkesë për tu futur në rendin e ditës.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Së pari doja t'ju njoftoja se ne e kemi të dedikuar këtë mbledhje dhe nëse zonja e ka bërë para dy javësh dhe ju ishit të interesuar mund ta kishit futur në mbledhjen e datës 18 sepse kjo mbledhje është e dedikuar vetëm për materialet në rendin e ditës dhe e dyta pa u bërë rregullorja sesi do funksionojë ky komision nuk mund të ngreme komisionin para se të ndërtojmë rregulloren.

Këshilltar E.Bregu: Rregullorja për komisionin është.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Për këtë çështje sepse duhet të ndërtojmë një rregullore vetëm për këtë çështje.

Sekretaria e Këshillit E.Naçi: Në lidhje me kërkesën që ka bërë zonja Këshilli do hartojë një rregullore dhe do sanksionojë disa rregulla në lidhje me banesat sociale dhe për këtë arsye në mbledhjen e muajit nëntor është miratuar me vendim nga disa anëtarë të Këshillit Bashkiak që do jenë pjesë e komisionit që do merret me hartimin e rregullores, pasi të hartohet kjo rregullore më

pas të kalojmë tek komisioni i verifikimit të banesave, në momentin që nuk kemi rregullore nuk mund të bëjmë verifikimin pa pasur disa rregulla të sanksionuara.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Me zonjën që ka bërë kërkesën unë kam biseduar dhe jemi dakortësuar të shohim çështjen e saj në muajin janar.

Këshilltar E.Bregu: Përsa i përket rregullores, rregullorja nuk e pengon ngritjen e komisionit që ka kërkuar kjo zonja dhe më vjen keq që jam detyruar ta rikthejoj që mos u përpiqni të kapeni pas kësaj shtese të rregullores sepse ne nuk po kërkojmë krijimin e rregullores, por zbatimin e rregullores ekzistuese të mos kalojmë në debate apo diskutime të tjera sepse nuk ja vlen dhe këto justifikime po presim të bëhet rregullorja pa të ngrihet komisioni nuk vlejné, do doja të tërhiqeshit nga këto pirueta në lidhje me këtë komision është më mirë t'i bihem drejt, e ndërton komisionin apo jo, nëse nuk e ndërton është në dorën e Këshillit sesi do vendoset por që të gjesh barriera të tjera që do ndërtojmë rregulloren pa të ngremë komisionin është e papranueshme për logjikën e një këshilltari, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po e rikthejoj edhe njëherë që sot mbledhja është e dedikuar dhe ne materialet i kemi sjellë vetëm për këtë çështje, nëse do kishim vullnetin e mirë do ta kishim trajtuar mbledhjen e kaluar. E hedhim në votim rendin e ditës, kush është dakort?

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 26

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 26 pro, 0 kundër, 1 abstenim.

Pika 2 e rendit të ditës.

“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË DATËS 18 DHJETOR 2025.”

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka nga këshilltarët, nëse jo e hedhim në votim. Kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 27 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 3 e rendit të ditës.

“ PËR MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNOJËSVE E TË PERSONAVE TË TJERË TË ZGJEDHUR OSE TË EMËRUAR NË INSTITUCIONIN E BASHKISË DHE INSTITUCIONEVE TË VARËSISË PËR VITIN 2026”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem komisioni.

Këshilltar A.Habip: Ekzekutivi ka sjellë për miratim, nivelin e pagave të punojësve nuk ka ndryshim në nivelin e pagave, përveç pages minimale e cila është miratuar me vendimin e fundit të Këshillit të Ministrave të dhjetorit të vitit 2025, në total janë rreth 300 punojës që do përfitojnë pagën nga 400 mijë në 500, komisioni vendosi t’ja kalojë Këshillit për miratim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka diçka nga këshilltarë?

Këshilltare S.Dinellari: Ajo që vura re dhe dje kur ndoqa me kujdes mblwdhjen e komisionit, vura re disa pasaktësi nuk e di nëse janë për shkak të shpejtësisë. Përshembull evidentohet në relacion që ka ende paga me 400 mijë dhe në lidhje me specialitet e tjera që ju keni evidentuar në Klubi Shumësportësh Skënderbeu evidentohen dy specialistë sipas asaj që ju keni thënë ditën e djeshme me vlerën e pages minimale ndërkohë që këtu nuk është evidentuar ky numër punojësish, është diçka që ka të bëjë vetëm me çështjet teknike apo?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje tjetër?

Këshilltar L.Petri: Përshëndetje znj.kryetare, uroj gjithë kolegët ditë të gëzuara të kalojnë sa më mirë. Pyetje ime është kjo si dhe sa janë mundësitë që i bën buxhetit kjo vkm-ja për rritjen e pages minimale nga 400 mijë lekë në 500 mijë lek, sigurohet vetëm prej transfertës të pakushtëzuara, pra që të mos preken të ardhurat nga Bashkia. Pyetja tjetër pse do prihet lapsi 1239 punojës dhe jo për 1322 aq sa është projeksioni?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje tjetër?

Nëse do e kishit ndjekur me vëmendje dhe live mbledhjen e komisioneve z.Petri u bënë këto pyetje edhe atje, megjithatë ka dikush nga ekzekutivi që do ju përgjigjet këtyre dy pyetje?

Drejtorja e Financës V.Ziko: Në mbledhjen e komisionit që u zhvillua pardje, domthënë materiali është bërë kur vendimi për pagën minimale nuk ishte botuar ende në fletoren zyrtare, vetëm është shënuar në relacion por u diskutua në komision që kur të zbardhet vendimi do saktësohet në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave që është 766 datë 19.12.2025 dhe është botuar në fletoren zyrtare në datën 23, pra kjo do reflektohet. Këtu nuk mund të shënohet sepse

ngaqë është e përcaktuar me vkm dhe pagat që janë fikse si për këtë dhe për kategoritë e tjera që do ndryshojnë në një të ardhme nuk mund të pasqyrohen sepse janë të vendosura, nuk ka ndryshim, paga minimale do reflektohet në momentin që do zbardhet buxheti, kurse nivelet e tjera me daljen e vendimit të Këshillit të Ministrave do zbatohen edhe nivelt e tjera. Efekti financiar i fondit të pagave që është në vlerë 126 milion e 778 mijë lekë është vetëm efekti i zbatimit të pagës minimale dhe pagave të tjera që është llogaritur që për gjitha kategoritë nga 1-10 të bëhet një shtesë me 10 mijë lekë të reja, është llogaritur vetëm efekti i rritjes të pagës minimale dhe efekti i vjetërisë sepse vjetërsia tashmë nuk llogaritet mbi diplomën por mbi shtesën e funksionit. Efekti financiar i fondit të pagave dua ta saktësoj shkon në vlerën 1 milion e 284 mijë e 545 mijë lekë nga këto 128 milion e 979 mijë lekë do të këtyre do përballohet nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale , transfertat për rritjen e pagave dhe pesha specifike që ze ndaj totalit të fondit të pagave është 10 %, 447 mijë e 640 mijë lekë nga transfertat e pakushtëzuar sektoriale e cila ze 35 % të peshës specifike, nga transfertat e pakushtëzuar 417 mijë e 722 mijë lekë ze 33% dhe nga të ardhurat e Bashkisë 290 mijë e 204 mijë lekë 22 % pesha specifike.

Këshilltar L.Petri: Për procedurë znj.kryetare, kolegët e ekzekutivit i pyeta se sa janë mundësitë që ky ndikim financiar të bëhet vetëm nga fondi i transfertës të pakushtëzuar dhe nuk mora përgjigje për këtë pyetje.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka përgjigje nga ekzekutivi për këtë pyetje?

Drejtorja e Financës V.Ziko: Jo e thashë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëse nuk ka pyetje apo diskutime e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 27

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 27 këshilltarë, 27 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 4 e rendit të ditës.

“ PËR PËRCAKTIMIN E PRIORITETEVE TË INVESTIMEVE PËR VITET 2026-2028”.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem komisioni.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Komisioni nuk u mblodh.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka ndonjë relativ nga komisioni lidhur me këtë çështje?

Atëherë këshilltarët e kanë para një material reference që ne i kemi dërguar ekzekutivit lidhur me konsultimet që kemi bërë. Ka diskutim pyetje?

Këshilltar K.Pllaha: Mundet që për efekt shkurtim kohe mos e marr fjalën 100 herë, të bëj edhe pyetjet edhe përgjigjet bashkë?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po.

Këshilltar K.Pllaha: Ky material që na sillet sot për proritetin e investimeve më duket se është trajtuar si një listë dëshirash dhe jo prioritet sepse me fjalën prioritet në shqip do kuptonim përparësi dhe nga ky document nuk kuptohet se cili prej këtyre investimeve ka përparësi, nëse ne duam të bëjmë një dokument të plotë të prioritetëve të investimeve duhet të shohim se cila prej tyre janë ato që janë urgjente, cilat janë të nevojshme dhe cilat të dobishme ose të dëshirueshme, ndërkohë këtu nuk shoh ndonjë prioritetim ose të më thotë ekzekutivi se renditja e bërë është në bazë të prioritetimit sepse është një listë e gjatë investimesh që sigurisht Bashkia nuk mund t'i mbulojë të gjitha në afat kohor, besoj. Kështu që së pari pse janë zgjedhur këto prioritet, janë zgjedhur si kërkesë e qytetarëve, si emergjente, apo si mendim i specialistëve përkatës?

Së dyti sa lidhen këto prioritet me strategjitë që ka miratuar Bashkia, apo me buxhetin përkatës?

Ky dokument duhet të jetë një mundësi për llogari dhënie që në fund të vitit 2028 të shohin qytetarët e Korçës se cilat janë realizuar dhe cilat jo, të njëjtën gjë bëjmë ne sot për listën e prioritetëve që janë miratuar në vitin 2023 dhe për hir të së vërtetës ka pak ndryshime nga ajo listë, do thotë që një pjesë e mirë e prioritetëve që janë shënuar para 3 vitesh nuk janë realizuar që do të thotë ose nuk ka qënë vërtet prioritare ose Bashkia nuk ka qënë e aftë të realizojë prioritetet e veta dhe më pas duhet patur edhe një mundësi kontrolli të vazhdueshëm, një herë në disa muaj Bashkia duhet të na ofrojë ne se cila prej tyre prioritetëve janë realizuar përndryshe kjo kthehet në listë dëshirash. Unë do i sygjeroja ekzekutivit të vendoste pranë çdo prioriteti sa emergjent është dhe e dyta duke vendosur një afat kohor duke qënë se kjo është një periudhë 3-vjeçare cili prioritet duhet zhvilluar në vitin e parë, cili në i dyti dhe cili në i treti, duke vendosur edhe lidhjen me strategjitë, duke vendosur edhe nga cilat të ardhura do realizohen këto. Pa këto detajime kjo listë nuk është e plotë, nëse ekzekutivi nuk pranon apo nuk mundet ta editojë do ftoja këshilltarët mos e pranonin në respekt të detyrës që qytetarët na kanë besuar, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ky është mendimi juaj, unë tek një pikë doja të ndalesha një nga detyrat e Këshillit është të monitorojë dhe ekzekutivi nuk ka penguar askënd nga ne monitorimin e çështjeve qoftë edhe me pjesën e investimeve. Ka pyetje të tjera?

Këshilltare S.Dinellari: Duke vlerësuar së pari planin strategjik të Bashkisë që është një plan i parashikur prej 2017 deri në 2031, duke vlerësuar edhe projektbuxhetet që ne kemi miratuar në vitet në vazhdim dhe ai që parashikohet në dy-vjeçarin e ardhshëm dhe duke vlerësuar dhe objektivat që Bashkia ka ndërmarrë, vura re se tek prioritet e vendosur janë klasifikuar disa prej programeve të rëndësishme që Bashkia parashikon. Ajo që unë do doja të dija është fakti që nëse shtyllat kryesore të rritjes ekonomike të Bashkisë janë përpos infrastrukturës, arsimit, edukimit, inovacionit dhe buqësia, çfarë është marrë si prioritet në lidhje me dy drejtime, buqësinë edhe inovacionin?

Së dyti në lidhje me disa specifitime që Bashkia ka menduar t'i ketë prioritet për investim në arsim, janë përzgjedhur disa shkolla për rikonstruksion dhe nuk e di sa informacion ka Bashkia në lidhje me numrin e përfituesve, numri i fëmijëve dhe komuniteti që përfiton nga

rikosntruksioni i këtyre shkollave, duke pasur që bëhet fjalë edhe për rikosntruksion tek shkollat 9-vjeçare tek njësitë administrative. Njëkohësisht ajo që unë do zygjeroja megjithëse këtu është përërndur ndërtim banesash për komunitetin Rom dhe Egjyptian në kuadër të kërkesës që Bashkia i ka vendosur edhe vetes por edhe zhvillimit në përgjithësi të të gjitha drejtorive, ky prioritet duhet të shtihet edhe më gjerë, konkretisht tek familjet e reja. Për familjet e reja çfare mendojmë për banesat dhe ndihmën në strehimin e tyre?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje të tjera?

Këshilltar L.Petri: Unë e mbështes sygjërimin e z.Pllaha për atë ç'ka ai sygjeri, unë dua të them se e gjej të përgëzueshme faktin se tek pika e tek efiçienca shoh se është vendosur prioritare vendosjen e paneleve diellore për kopshte dhe shkolla dhe vazhdimin me bashkëfinancim për termoizolim sepse ne tashme si Bashki jemi edhe strategjinë për efiçiençën energjitike. Ajo që unë do sygjeroja do ishte se është pothuajse 1 lagje e tërë, dikur quheshin zona informale, rruga quhet "Tefta Tashko Koço" ose ish Fabrika e Qelqit për ne që jetojmë këtu dhe e dimë vendndodhjen të cilat kanë bërë edhe peticion në Bashki dhe po bëhen 2-3 vjet kur ka zgjedhje dhe thonë se do çakullohet rruga dhe vazhdon e njëjta gjë, nuk është bërë disiplinimi i ujërave të zeza dhe nuk është ndërhyrë në nivelin e denjë për një zonë urbane. Kështu që do sygjeroja ta konsideronit sepse tashmë ajo është pjesë e qytetit dhe kanë edhe ata të drejtën e tyre, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, ka pyetje të tjera?

Nëse nuk ka diçka tjetër, meqënëse u bënë këtë pyetje të përgjigjet kryetari, pastaj hapim fjalën për diskutime.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Si fillim më lejoni t'ju uroj edhe unë Gëzuar Festat, përse i përket këtij materiali, hartimi i listës të prioriteteve të investimeve është detyrimi ligjor që ne kemi i cili është hap që i paraprin pastaj financimit të investimeve, pra në bazë të ligjit që ne të financojmë një investim të caktuar në bazë të ligjit buxhetor duhet që ky investim të jetë i listuar tek lista e prioriteteve të investimeve. Lista është e gjatë dhe siç u tha dhe me të drejtë patjetër nuk pretendohet që kjo listë të financohet me buxhetin e Bashkisë 1-vjetor, por ju e dini e keni parë që investimet që realizohen në territorin e Bashkisë, nuk realizohen të gjitha me buxhetin Bashkisë, një pjesë bëhen me bashkëfinancim, kurse një pjesë tjetër bëhen nga donatorë, apo siç është Fondi Shqiptar i Zhvillimit, prandaj ne hartojmë një listë të gjatë dhe pastaj shohim si është mundësia e bashkëfinancimit, apo financimit nga donatorë të tjerë, por nuk e dimë në këtë moment prandaj lista është e gjatë. Lista është zgjedhur në bazë të kërkesave nga banorët gjatë takimet të buxhetimit me pjesëmarrje kryesisht por edhe gjatë takimeve të tjera apo kërkesat që banorët na bëjnë por janë edhe prioritete të zgjedhura në bazë të vizionit që ka Bashkia, prioriteteve të saj zhvillimore, apo kërkesave dhe nevojave që indentifikohen nga ana e Bashkisë. Nuk janë të renditura sipas rëndësisë të tyre, gjatë vitit shohim se cilat janë ato prioritete që duhet të zbatohet, këtu jam i hapur për të marrë edhe opinionin tuaj edhe në rast se duhet të shtojmë edhe prioritete të tjera apo cila është më e rëndësishmja që duhet bërë. Përse i takon financimit të një rruge në një prej zonave informale të qytetit, të gjithë e keni parë që vitet e fundit është bërë një punë e jashtëzakonshme për sistemimin e hapësirave urbane në qytet, me investime të kombinuara me ndërhyrjen në kanalizime më pas në asfaltime dhe sot që flasim prej disa vitesh është mbyllur pjesa urbane e qytetit, mesa di unë nuk kemi rrugë të pa rikonstruktura dhe

gjithashtu është bërë një punë e madhe edhe tek zonat informale, nuk kemi pritur që të mabrojmë zonat urbane pastaj të fillojmë zonat informale por i kemi bërë paralelisht prej disa vitesh kemi një projekt për rehabilitimin e zonave informale, nuk ka mbaruar, prandaj dhe pika 1 është rehabilitim i rrugëve në lagjet e qytetit dhe kjo përfshin kryesisht pjesën informale të qytetit por siç e thashë edhe në fillim nuk pretendoj se çdo rrugë të mbyllet brenda vitit. Nevojat janë më të mëdha në zonat rurale dhe fokusi ynë do jetë më tepër tek njësitë administrative por patjetër do shohim mundësitë edhe në zonat informale të qytetit. Përsa i takon investimeve në arsim, ne kemi realizuar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, e kam shpjeguar edhe në mbledhjet e tjera që kam preferuar që ne të përdorim fondet që alokojmë për arsimin në projekte të bashkëfinancimit pasi për çdo lekë që ne investojmë atje, 2-3 lekë të tjera investohen nga ana e Qeverisë, raporti i bashkëfinancimit është 20 Bashkia, 80 % Qeveria. Këtë vit kemi fituar projektin e rikonstruksionit të shkollës Sotir Gura dhe vitin tjetër kemi gati 2 aplikime që do aplikojmë me tu hapur thirrja dhe shpresoj që të fitojmë minimalisht 1 projekt. Këto shkolla janë përzgjedhur, e kam shpjeguar edhe në diskutimin e buxhetit të vitit të kaluar, në kuadrin e një projekti me UNDP dhe në mbështetje me Usaid ne kemi realizuar hartimin e projekteve për ndërhyrje në disa shkolla edhe në qytet edhe njësitë administrative dhe janë pikërisht këto shkolla që ne po i aplikojmë kur hapen thirrjet e radhës, tani do paraqesim shkollën Naum Veqilharxhin dhe Ismail Qemalin mos gaboj dhe do shohim pastaj në bazë të financimit që do marrim edhe me shkollat e tjera nëse do kemi mundësi të aplikojmë. Përsa i takon pjesës të buqësisë dhe inovacionit janë dy prej sektorëve prioritarë të zhvillimit ekonomik dhe unë do flas pak më gjatë për to kur të prezantoj buxhetin, ka projekte shumë interesante (nuk ka audio), këto mbajta shënim nuk e di në rast se më shpëtoi diçka.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kush e do fjalën për diskutime?

Këshilltar D.Osmeni: Këtë listën për prioritetet ne kemi vite që e shohim dhe pak a shumë është e njëjta ndoshta thejsh rendi i ndryshon dhe kjo ndoshta jo sipas asaj prioritetit që kanë, sipas asaj që na u tha edhe nga kryetari thjesht janë hedhur në një letër dhe meqënëse jemi në fundvit më duket si ajo lista e dëshirave që kanë fëmijët për babagjyshin. Nuk mund të bëhet prioritet dëshira, nuk mund të ketë dëshira të njëjta. Të paktën minimalisht prioritetet e investimeve ne duhet t'i kemi në Këshill të mirëpërcaktuara, cila është zona më emergjente në qytet apo fshat që duhet investuar për problemet e ndryshme. Nëse tani ne kemi një qëndër që ka nevojë për zbulime dhe ndoshta investime shumë pak, pjesa tjetër e qytetit besoj se edhe kryetari por edhe ne e dimë që në pjesën tjetër të qytetit apo fshatrave është shumë e nevojshme të ndërhyet. Dëgjova këtu nga kryetari që tha se ne kemi bërë shumë rikonstrukcione dhe fasadash por me sa di unë e vetmja rrugë është ajo kruarja e asaj rrugës tërthor tek ish- Stacioni i Maliqit, nuk di rrugë tjetër. Gjithsesi në Këshill ne duhet të miratojmë një listë ashtu siç edhe vetë ky relacion ka emër, në momentin që ne kemi thjesht një listë dëshirash i kërkoj këshilltarëve mos votojnë unanimitet, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kryetrai ka diçka?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në fakt të gjitha projektet para se të realizohen dëshira janë, dëshira të mira me impakt në komunitet dhe fjala dëshirë nuk është fjalë e keqe. Përsa i takon investimeve në qytet, thashë në vitet e fundit janë bërë investime shumë të mëdha, pjesa urbane brenda unazës është mbyllur e gjitha, ndërkohë që janë realizuar edhe shumë projekte informale,

nuk thashë ne vitin e fundit, në vitin e fundit janë realizuar dy proejkte në qytet, rruga që ju përmendët dhe rruga Todi Vogli që është rruga tek urgjenca e spitalit. Është realizuar edhe një rrugë tjetër që mbase ka qënë edhe “gangrena” e rrugëve në teritorin rural që është rruga Polenë-Dërsnik, një rrugë me gjatësi 5.5 km e asfaltuar e gjitha, në pjesën rurale. Ju mund të thoni edhe rrugë të veçanta dhe ne t’i mbajmë shënim, çfarë gjykoni ju edhe në pjesën e qytetit edhe zonës rurale. Tek pika 2 ne kemi rikonstruksioni i rrugëve tek njësitë administrative, e cila ka një vlerë shumë të madhe sepse edhe nevojat tek këto njësi janë të mëdha. Aktualisht ne jemi duke punuar edhe me evidentimin e këtyre nevojave edhe nga që kemi mbajtur shënim tek takimet e buxhetimit me pjesëmarrje por edhe nga ato që kemi marrë si informacion nga njësitë administrative. Jemi duke përpiluar një listë të detajuar siç e doni dhe ju, drejtroia e urbanistikës ka filluar punën me hartimin e projekteve dhe prevetiva për këto rrugë, pastaj gjatë vitit në varësi edhe të financimeve sepse Fondi Shqiptar i Zhvillimit do vazhdojë me financimet ne infrastrukturën rrugore. Nuk e dimë në këtë moment sesa do jetë masa e kësaj mbështetje. Në varësi të asaj që do marrim si suport do shohim të alokojmë edhe burimet tona, edhe këtë se çfarë janë mundësitë me buxhetin e Bashkisë, do flas kur të jemi tek pjesa e buxhetit. Përsa i takon listës ju lutem tek kjo mbledhje, ose jashtë mbledhjes mund të na jepni listën me gjëra që ju i konsideroni si prioritet grup ose individualisht sit ë doni.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Fjala për z.Tollkuçi.

Këshilltar P.tollkuçi: Përshëndetje kolegë, duke qënë se po e marr fjalën për herë të parë dua t’ju uroj të gjithëve festa të gëzuara dhe sa më shumë shëndet dhe zemra të gëzuara. Ajo ç’ka dua të them lidhur me këtë pikë do bëj vetëm një shprehje të shkurtër. Kam qënë para disa ditësh bashkë me kryetarin e Bashkisë në promovimin e librit të kantautorit Korçar Mihallaq Andreas 22 ëndrra dhe personat që bënë prezantimin e librit thanë që njeriu duhet të ëndërrojë dhe me këto ëndrra kemi ndërtuar këtë qytet edhe këtë Bashki, thjesht do them diçka që një njeri që nuk ëndërron ai thjesht merr frymë kurse një njeri që ëndërron jeton është e mjaftueshme, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kush e do fjalën?

Këshilltar E.Bregu: Duke pasur parasysh listën e prioriteteve ajo që vemë re që në fillim është se janë paraqitur disa shifra të rumbullakosura 18 milion, 120 milion nuk doli njëra 121 apo 122, që nga pamja e parë duket se kjo është diçka formale, pa pasur parasysh as listën e dëshirave që kanë shprehur baniorët e Bashkisë Korçë. Është e vërtetë se kjo është një listë e përsëritur prej disa vitesh siç u konstatua dhe Bashkia paraqitet vazhdimisht me këtë listë, ndërkohë që lista e prioriteteve duhet të ishte e përcaktuar duke pasur parasysh një strategji zhvillimi të sektorëve dhe Bashkia Korçë ka paraqitur prej kohësh një strategji zhvillimi bazuar në tre sektorë, turizmi, buqësia dhe inovacioni dhe nga kjo listë prioritetesh ne nuk kuptojmë asgjë ose më saktë nuk sjell asgjë të re për turizmin, asnjë investim që të japë 1 shtysë para turizmit apo buqësisë që janë dy nga sektorët më strategjikë për zhvillimin e Bashkisë Korçë edhe qytetarëve dhe banorëve. Për t’i vënë kapak kësaj që është diçka informale do ju them atë që më tha një kryeplak, isahte nga Partia Socialiste ai ma tha më të gjatë histroinë por unë po e shkurtoj për mos e bërë komike, ai tha Sotiraqi sa herë vjen që na sjell investimet na sjell të njëjtat ndryshon vetëm datën, unë kam 7 vjet këtu tha dëgjoj të njëjtat gjëra.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kush e do fjalën tjetër?

Këshilltar L.Petri: Znj.kryetare në përgjigje të ftesës që bëri z.kryetar për propozime duke e parë edhe njëherë listën mendoj se ka vend për tu rikonsideruar pika 12, ku thuhet restaurimi i fasadave, lyerje në Pazari i Korçës. Sigurisht atje ka nevojë për mirëmbajtje por mendoj se ka hapësira me vlerë të jashtëzakonshme në Bashkinë e Korçës, një prej tyre është lagjia e Mitropolisë që ka edhe atje objekte, momente kulture që janë të dashura për qytetarët dhe do meritonin vëmendje dhe ristaurim. Gjithashtu edhe pika 13 ku thuhet shtesë për varrezat publike është për tu vlerësuar kjo sepse është një nevojë për komunitetin por mendoj se është ngritur jo nga pak qytetarë që Varrezat e Dëshmorëve meritojnë vëmendje apo siç i themi ne Shkallkat e Kampit sepse është një Belvedere shumë e bukur dhe mund të meritonte vëmendjen e një investimi të arsyeshme dhe të dilte me dobi komunitare. Tjetra po pyesja edhe kolegët këtu se mos më kishte shpëtuar mua, nuk pashë në asnjë faqe të relacionit, fjalën kyçe gazi dhe dua të di pse kur ka qënë një nga prioritetet strategjike për ngrohjen e qytetit.

Këshilltar K.Pllaha: Kam diçka për procedurë, na është dërguar dy herë ky material me email dhe herën e dytë kur titullohej lista e prioriteteve e ndryshuar mungonte pika 8, dhe sot na është shtua sërish që është ndërtimi i një objekti zyrë informacioni përkrahë sheshit të Katedrales. Dua të di përfshihet edhe ky prioritet sepse na u dërgua edhe njëherë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po.

Këshilltar K.Pllaha: Dhe një replikë të vogël, ju e quajtet detyrim ligjor, z.Tollkuçi e quajti listë ëndrrash mund të qëndrojnë të dyja, por një listë prioritetesh duhet të jetë një mekanizëm llogaridhënie dhe që të kthehet në e tillë duhet të prioritetizohet kjo listë, kush është më prioritar.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Edhe për këto jepet llogari, për investimet. Nëse nuk ka diçka tjetër, e hedhim në votim, kush është dakort?

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 23

Vota KUNDËR 5

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 28 këshilltarë, 23 pro, 5 kundër, 0 abstenim.

Pika 4 e rendit të ditës.

“ PROJEKT BUXHETI I BASHKISË KORÇË I VITIT 2026 DHE PBA 2026-2028.”

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem komisioni, kush do flasë?

Këshilltar A.Habip: Ekzekutivi ka dërguar për miratim projektbuxhetin e Bashkisë Korçë për vitin 2026, ku vlera e tij është 2 miliardë e 614 milion e 473 mijë lekë të cilat janë ndarë sipas burimeve të financimit, transfertës të pakushtëzuar janë 665 milion e 252 milion lekë që përfshin 25.44 % të totalit, transfertat e pa kushtëzuar sektoriale që është në vlerën 500 milion e 332 mijë përfshin 19.14 % të totalit, të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore janë 1 miliardë e 209 milion

e 185 mijë lekë që përfshin 46.25 % të totalit, të ardhurat nga institucionet e varësisë që janë 42 milion e 275 mijë lekë përbëjnë 1.62 % të totalit, transferta e pakushtëzuar sektoriale për rritjen e nivelit të pagave që është 128 milion e 979 mijë lekë që përbën 4.93 % të totalit si dhe transferta e pakushtëzuar sektoriale për menaxhimin e mbetjeve urbane që është 7 milion e 600 mijë lekë dhe ze 0.29 % dhe fondet Ipa me vlerë 600 milion e 700 mijë lekë. Gjithashtu është dërguar edhe planifikimi i shpenzimeve sipas 11 programeve që përbëjnë 26 funksione që menaxhohen nga Bashkia dhe institucionet e saj, shpenzimet e personelit janë 1 miliardë e 284 milion e 545 mijë përbëjnë 49.13 % të totalit, shpenzimet koherente janë 960 milion e 304 mijë lekë që përbëjnë 41.12 % të totalit dhe shpenzimet për investimet 369 milion e 614 mijë. Komisioni i mbledhur në datën 22 dëgjoi dhe paraqitjen e drejtorisë të financës për të gjitha pyetjet ku mori dhe përgjigjen e duhur dhe vendosi t'ja kalojë Këshillit për miratim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Fjala për kryetarin.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Miratimi i buxhetit të vitit 2026 është pika më e rëndësishme pasi miratimi i këtij projekt buxheti që i hap rrugën më pas financimit edhe të investimeve por edhe shërbimeve të rëndësishme që Bashkia ofron për qytetarët dhe komunitetin edhe në qytet edhe nënjësitë administrative. Po e filloj prezantimin e buxhetit duke bërë një paraqitje në dy grupet edhe në grupin e të ardhurave edhe në grupin e shpenzimeve. Përsa i takon pjesës të të ardhurave rreth 50 % e këtij buxheti është e përbërë nga të ardhurat që Bashkia i siguron vetë, duke filluar nga taksat dhe tarifat vendore që janë në masën 46.25 % të buxhetit, të ardhurat nga institucionet e varësisë që janë 42 milion e 275 mijë lekë përbëjnë 1.6 % e buxhetit, dhe fondet Ipa me masë 2.3 % të buxhetit dhe rreth 50 % e buxhetit vjen si mbështetje nga ana e Qeverisë e ndarë në 665 milion lekë transferta e pakushtëzuar, 500 milion lekë transferta e pakushtëzuar sektoriale, 129 milion lekë transferta e pakushtëzuar për rritjen e pagave dhe 7.6 milion lekë, transferta e pakushtëzuar për menaxhimin e mbetjeve urbaneve. Në pjesën e shpenzimeve në 3 grupet kryesore, shpenzimet e personelit për paga janë 1 miliardë përbëjnë 49 % të totalit, shpenzimet koherente janë 960 milion të totalit dhe shpenzimet për investimet 370 milion lekë. Në raport me vitin 2025 shpenzimet operative janë ulur nga 41 % në 37 % ndërkohë që investimet janë rritur nga 12 % në 14 % të buxhetit. Në pjesën e të ardhurave dua të veçoj mbështetjen në rritje të Qeverisë Shqiptare për Bashkinë e Korçës si njësi e pushtetit vendor, transferta e pakushtëzuar është rritur me 36.6 milion lekë, ndërkohë që transferta e pakushtëzuar sektoriale ka një rritje prej 50 milion lekë krahasur me vitin 2025. Ky ishte kompozimi i buxhetit. Besoj se pjesa më e rëndësishme është si do përdorej ky buxhet, nga se do mbështetej por edhe çfarë do jenë projektet apo zhvillimet në Bashkinë e Korçës për vitin 2026. Projektet edhe investimet nuk është se mbështeten gjitha 100 % nga buxhetet e Bashkisë, një pjesë e tyre mbështeten edhe nga institucionet qeveritare siç është Fondi Shqiptar i Zhvillimit, Agjensia Kombëtare e Mbrojtjes Civile apo Siç është Ministria e Arsmimit apo ajo e Shëndetësisë edhe nga fondet e huaja siç janë fondet e Be apo fondet Ipa. Përsa i takon zhvillimit janë 4 drejtime duke filluar me turizmin ku janë duke u zbatuar disa projekte shumë të mëdha, që kanë qënë edhe premtimet tona elektorale,

duke filluar me ndërtimin e Qendrës të Eventeve në afërsi të qytetit tek ish-vaskat e peshkut, projekti po ecën me ritëm të shpejtë dhe do krijojë 1 infrastrukturë turistike për zhvillimin e eventeve outdoor dhe indoor por do ketë edhe një hapësirë për akomodimin e kamprave 1 qëndër që ne nuk e kemi pasur por ka qënë nevojë. Në afërsi të qendrës te eventeve tek ish-reparti ushtarak i Drenovës do fillojë ndërtimi i një but kampi si një hapësirë argëtimi dhe stërvitore për fëmijë edhe të rinj. Kemi parashikuar siç e patë edhe tek lista e prioriteteve ndërtimin e një zyre moderne për informacion turistik që po mendojmë të ndërtohet tek sheshi para Katedrales. Këto projekte së bashku me kalendarin e pasur të eventeve, strategjinë e një marketimi më të mirë të produkteve turistike si dhe me një projekt shumë të rëndësishëm që presim të fillojë gjatë këtij viti, në bashkëpunim me Agjensinë Fraceze për hartimin e strategjisë në pjesën e zhvillimit të turizmit të natyrës, besoj që të krijojë kushtet që sektori i turizmit të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik lokal dhe pse jo dhe të rritë kontributin e tij në ekonominë lokale. Do kemi dhe dy projekte të cilat në fushën e turizmit të cilat janë në drejtim të turizmit të eksperincës dhe konkretisht bëhet fjalë për një projekt në zonën rurale që e kemi në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit që quhet Rrugët e Shijes në 4 fshatra Polenë, Qatrom, Drenovë dhe Boboshticë po ngrihen struktura ku do të prodhohen produkte tipike të zonës duke krijuar mundësi për komunitete të këtyre fshatrave të krijojnë të ardhura nga shitja e produkteve tipike por gjithashtu të 4 qëndrat do jenë pjesë e një turi turistik i cili do jetë turi i rrugëve të shijes ku do ketë shumë kërkesa sidomos nga turistët e huaj. Një projekt të ngjashëm duam ta zhvillojmë tek Pazari i Vjetër ku duam të mbështesim 1 grup artizanësh të vendosen në struktura ku ne do i marrim me qera si Bashki dhe të zhvillojnë aktivitetin etyre të artizanatit dhe të kenë mundësi që këtë aktivitetet t’ja u ekspozojnë turistëve apo vendasve, këto janë dy proejkte jo aq të mëdha në vlera monetare por besoj do ketë një ndikim tek turistët. Në pjesën e buqësisë nëpërmjet buxhetit të vitit 2026 do vazhdojmë mbështetjen për sinfrastrukturën buqësore, për rrugët e parcelave, për kanalet vaditëse ose kulluese dhe 80 milion lekë të reja në buxhetin e vitit 2026 janë lënë për mbështetje në këto drejtime. Kemi dy projekte shumë të rëndësishme ku njëri ka filluar dhe besoj do mbyllet në vitin 2026 në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, ka qënë një prej premtimeve në fushatën elektorale që është ndërtimi i një ferme model të kultivimit të mollëve me teknologjinë moderne dhe së bashku me të dhe ngritja e një qëndre për seleksionimin dhe paketimin e mollëve, ky projekt do krijojë mundësinë për këtë produkt të trajtohet sipas standarteve bashkëkohore, duke u seleksionuar dhe pakeluar sipas standartit dhe duke ju krijuar mundësinë fermerëve që pas trajtimit ky produkt të ketë akses në tregjet të mëdha dhe çmim më të mirë dhe të krijojë mundësi të Ardhurash për fermerët. Projekti i dytë shumë i rëndësishëm i cili do fillojë gjatë vitit 2026 është një projekt i cili bën bashkë disa aktorë ku kryesori është Fondacioni Shqiptaro-Amerikan i cili ka investuar për të sjellë një universitet lider në fushën e buqësisë i cili është Universiteti Hollandez, institucion akademik në fushën e kërkimit të buqësisë që listohet në tre universitet kërkimore buqësore më të mira në botë. Ky universitet do vijë në fillim të vitit 2026 me mbështetje të ADF në Korçë dhe do bashkëpunojë me Ministrinë e Buqësisë me, Fakultetin Fan Noli me qëndrën e transferimit të tekonologjive buqësore dhe me Bashkinë Korçë për të ndërtuar modele të sukseshme akademike

nëpërmjet këtyre aktorëve, unë po e pres me shumë dëshirë ardhjen e këtij universiteti. Projekti tjetër që ndërthur zhvillimin rural dhe turizmin është projekti i rrugëve të shijes që unë e përmenda. Tek pjesa e edukimit e indentifikuar si shumë e rëndësishme për ekonominë lokale dhe të ardhmen e qytetit, kemi dy projekte, gjithashtu shumë të rëndësishme që janë duke ecur, i pari projekti i Polit të Dijes i cili do përmbyllet në fillim të vitit 2026 si infrastrukturë dhe na krijohet mundësia që së bashku me Fondin dhe Universitetin ta shfrytëzojmë këtë infrastrukturë fantastike, një nga infrastrukturat më të mira të ndërtuara në Shqipëri, ta shfrytëzojmë për të tërhequr partnerë, universitete të huaja të kenë mundësi të tërheqin diploma dy-palëshe jo vetëm për studentë të qarkut Korçë por edhe për studentë jashtë Qarkut, kjo do jetë një infrastrukturë miks nëpërmjet pjesës akademike, kërkimit shkencor dhe një inkubatori biznesi, ku idetë që do dalin nga kërkimi shkencor do kenë mundësi të mbështeten pastaj për tu rritur si start tape. Projekti i dytë është rihapja e Liceut Francez të Korçës me standarte shumë të larta dhe besoj gjatë vitit 2026 ne do fillojmë dhe me shpresë të përmbyllim ndërtimin e dy godinave të reja të cilat së bashku me godinën ekzistuese do formojnë kompunsin e Liceut aktual Francez të cilin duam ta hapim në vitin akademik 2027-2028, është një projekt i mbështetur nga dy qeveri nga ajo Shqiptare dhe Franceze dhe në momentin kur ky lice do rikthehet në realitet si një institucion i arsimit të mesëm shumë elitar, mbase më elitar në Shqipëri me një program të pasur, me një diploma të ekuivalentuar dhe me bakaluaereat që është sistemi shtetëror francez me një qasje dhe njohuri në fushën e teknologjisë, ky institucion do jetë një magnet për të mbajtur të rinjtë edhe të reja të rrinë këtu por për të sjellë edhe nga rajoni studentë që të ndjekin shkollën tek ky lice për të përmbyllur ciklet më pas tek institucioni që thashë, tek Poli i Dijes. Korça i ka të gjitha parakushtet të jetë një qytet universitar. Drejtimi i fundit është ai i teknologjisë, kam folur shumë për këtë program që e kemi lançuar para 5 vitesh besoj se është një mundësi e jashtëzakonshme për të rinjtë që të marrin njohuri edhe t'i venë në jetë ato nëpërmjet punësimit qoftë fizik, qoftë online, kemi bërë shumë në këto vite, kemi modelet e para të suksesit nga kjo punë, shumë të rinj që janë vetëpunësuar ose të punësuar në kompani për marketing, do vazhdojmë ta mbështesim këtë program. Në muajin e parë të vitit 2026 do përmbyllet edhe rikonstrukcioni i Biblotekës të Fëmijëve e dhuruar nga filantropulli "Thoma Turtulli", me këtë projekt kemi ruajtur një pjesë të trashëgimisë tonë kulturore por edhe do e vemë në funksion të këtij programi duke transferuar tek kjo godinë trajnimet edhe projektet që kemi në fushën e teknologjisë dhe informacionit për fëmijët nga 8-15 vjeç, ndërkohë që risia e këtij viti është dëshira që ne kemi për të filluar disa projekte 3-palësh, Bashki- Universitet- Biznese lokale, duam të krijojmë disa modele të bashkëpunimit të trajtës ku bizneset na japin disa sfida apo nevoja që ata kanë, Universiteti angazhohen kapacitet e tij akademike qofshin profesorë apo grupe studentësh në adresimin e këtyre nevojë të bizneseve dhe Bashkia është ose në rolin e ndërmjetësit ose në raste të caktuara është vetë institucioni që jep disa nga këto sfida, është projekt shumë interesant i cili i bën mirë këtij projekti social-ekonomik të Bashkisë edhe bizneset gjejnë zgjidhje për nevojat e tyre dhe indentifikojnë kapacitete njerëzore që nesër- pasnesër mund t'i punësojnë dhe studentët kanë mundësi të kryejnë studime duke pasur një praktikë shumë të lidhur me realitetin dhe gjatë këtij projekti të njihen me parakushtet e biznesit dhe të krijojnë mundësi punësimi. Është një projekt

të cilin e kam me shumë qejf dhe do e mbështes dhe shpresoj të sjellë përfitim 3-palësh. Përsa i takon investimeve në infrastrukturë në qytet edhe në fshatra, në këtë buxhet është lënë një fond prej 200 milion lekë të reja, të ndara 130 milion lekë në buxhetin e Bashkisë dhe 70 milion lekë tek buxheti i NSHP, nëpërmjet këtij buxheti do realizojmë një grup ndërhyrje infrastrukturore, rrugë, asfaltim rrugësh, trotuare, e të tjera edhe në qytet edhe në njësitë administrative do bashkëpunojmë me Fondin Shqiptar të Zhvillimit dhe në pjesën e ujësjellës kanalizimeve do bashkëpunojmë përsëri kompaninë e ujësjellës kanalizimeve për të financuar ato nevoja që ka ky sektor në territorin e Bashkisë. Përsa i takon ndërhyrjeve në qytet, ndërhyrja më e madhe do jetë për rikualifiimin e urban të bulevardit “Gjergj Kastrioti” është një ndërhyrje e domosdoshme pas ndërhyrjes të lirimt të hapësirave publike një aksion i madh i cili ka filluar para pak muajve dhe do vazhdojë gjatë në kohën e nevojshme për lirimt e gjithë hapësirave dhe më pas zhvillimin urban të tyre. Meqënëse është një projekt në infrastrukturë po jap një shpjegim edhe për gazifikimin meqënëse edhe u pyeta nuk është në listën e prioriteteve sepse për shkak se është një investim që nuk do realizohet me buxhetin e Bashkisë, ecuria e këtij projekti me kontaktet e fundit para pak ditëve që kam patur me përfaqësues të kompanisë kemi kaluar në fazën e ndërmjetme që ka ndjekur fazën e studimeve të fleksibilitet e kryer deri tani, që i paraprin studimit të detajuar inxhinierik, aktualisht ka filluar kjo fazë, janë angazhuar disa nënkontraktorë nga kompani Shqiptare dhe Greke që janë kontraktuar për të kryer këtë fazë. Ndërkohë gjatë vitit 2026 me propozim të kompanisë Socar do fillojmë një fazë pilot të këtij projekti të gazifikimit që do ndërtohet një rrjet që do përfshijë disa prej objekteve që janë përdorues relativisht të mëdhenj të gazit dhe do furnizohen me gaz natyror të kompresuar, nuk do ketë nevojë të bëjmë lidhjen me gazsjellësin tap në fazën e parë, do ndërtohet ky rrjet dhe një stacion kompresimi, besoj se do fillojë në vitin 2026 dhe kush do jenë përfitimet qoftë nga pjesa industriale nga ky projekt. Në ditët e para të janarit do kemi një video konferencë me kompaninë Socar ku do të njihen hapat konkret që do ndjekë projekti pilot. Me buxhetin e Bashkisë 20206 do vazhdojnë të financojnë shërbime shumë të rëndësishme që Bashkia i ofron edhe në qytet edhe fshat, duke filluar me shërbimin e pastrimit, me ndriçimin publik, me projektin e gjelbërimit, mirëmbajtjen e tyre, me shërbimin funeral. Gjithashtu ky projekt mbështet edhe projektet sociale, mbështetjen e kategorive në nevojë të jemi një qytet që nuk le njerëz mbarpa, ju zgjat dorën, mbështet edhe komunitetet vulnerabël. Në grupin e projekteve sociale, projekt i rëndësishëm do jetë ai i strehimit social, duke filluar me ndërtimin e një pallati të ri, në bashkëpunim me Entin Kombëtar të Banesave, jemi në fazën ku projekti është për leje me të dalë do nisim, do mbështeten projekti për bonusin e strehimit, transporti publik falas për pensionistët, qendrat komunitare për pensionistët dhe fëmijët. Do fillojmë një projekt për ofrimin e shërbimit në familje për fëmijët dhe gratë e dhunuara. Ky buxhet do ofrojë një mbështetje të rëndësishme për artin dhe kulturën dhe ky fond është 149 milion lekë të reja, do mbështeten 60 projekte në kuadrin e Qendrës të Artit dhe Kulturës, të ndara nëpërmjet qendrës, Teatrit dhe Biblotekës, mbështetja e këtyre projekteve synon të mbajë gjallë artin dhe kulturën në një qytet që njihet si qytet historik, të mabjë pasur një calendar eventesh që janë në funksion jo vetëm të gjallërimit të jetës kulturore në qytet por i shohim me impact ekonomik në qytet. Do mbështeten formacionet artistike të

qytetit të Korçës dhe do mbështeten gjithashtu edhe projektet që synojnë të nxitin të rinjtë drejt artit dhe kulturës dhe krahas Rin Showt që është shumë i rëndësishëm për të rinjtë, kemi dy iniciativa të reja, konkursi teatror i të rinjve shumë i sukseshëm dhe kori i të rinjve, sot gjej rastin t'ju ftoj tek Galeria e Artit Dixhital të ndjekim koncertin e këtyre të rinjve. Mbështetje shumë të rëndësishme do ketë edhe sporti, mbështetja do jetë për futbollin, ekipet shumësportëshe që janë brenda Klubit Shumë sportësh por ndërkohë risia që kemi gjatë vitit 2026 është shpallja e qytetit të Korçës Qyteti European i Sportit ne e kemi marrë titullin tashmë së bashku me disa qytete të tjera dhe aktivitetet sportive që do mbështesim do jenë të shumta i keni në buxhetin që do miratojmë sot. Një pjesë tjetër të projekteve do ja u sjellim rishikimin e buxhetit, ose me rishikim e të ardhurave të trashëguara në mbledhjen e janarit në vitin 2026, do ketë një kalendar të pasur të aktiviteteve sportive, kemi ngritur një grup pune për të grupuar aktivitetet e deri tanishme, por edhe për të shtuar një listë me aktivitete të tjera. Kemi një zhvillim shumë pozitiv në infrastrukturën madhore sportive, që është fillimi i projektit për rikonstruksionin e plotë të Pallatit të Sportit është një projekt që do përmbyllet gjatë vitit 2026 dhe me këtë infrastrukturë dhe me infrastrukturën ekzistuese do kemi mundësi të akomodojmë jo vetëm aktivitete sportive të ekipeve sportive të qytetit por të organizojmë edhe aktivitete aprotive ndërkombëtare. Ky buxhet mbështet fuqimisht fëmijët edhe të rinjtë dhe kjo mbështetje është në masën 1285 milion lekë të reja të ndara në mbështetje për arsim, edukim janë parashikuar 74 milion lekë të reja në rikonstruksionin e objekteve shkollore, 30 milion lekë të reja për mirëmbajtjen e godinave arsimore, 54 milion lekë fondi që shkon për mbarëvajtjen e Qytezës të Fëmijëve dhe zonës sportive, 22 milion janë projekte në fushën e teknologjisë, 5 milion lekë të reja projekti për mbështetje në fushën e bursave për gjimnazistë ekselente. Ka filluar punën edhe proekti i Qendrës Rinore që ka qënë një prej premtimeve tona për kërkesat e të rinjve dhe presim që gjatë vitit 2026 të pasurojmë kalendarin e aktiviteteve. Kjo është pak a shumë përmbajtja e buxhetit, e përshkruar shkurtimisht në kompozimin e tij, në pjesën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në mbështetjen që do ketë për zhvillimet në 4 sektorët prioritarë të zhvillimit ekonomik, në zhvillimin e infrastrukturës por edhe në mbështetje në zhvillimin bazë për artin, kulturën, sportin dhe mbështetje për fëmijët dhe të rinjtë. Ju ftoj ta miratoni këtë buxhet me qëllim t'ju hapim rrugën realizimit të këtyre projekteve për ta çuar Korçën në standartin më të lartë, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, kryetar. Kush e do fjalën për pyetje, ka pyetje nga këshilltarët?

Këshilltar L.Petri: Po i listoj pyetjet me rradhë dhe shpresoj që këtë rradhë të marr përgjigje shteruese. Pyetja e parë lidhet me numrin e popullsisë, e dëgjova me vëmendje takimin që u bë me komisionin e finacave dhe atje u theksua nga përfaqësuesit e ekzekutivit që është marrë për bazë gjendja civile dhe nuk ka referenca aspak nga Instati dhe pyetja ime është pse?

Në relacionin e dërguar vetëm 2.3 % e buxhetit sigurohet nga fondet Europiane, posaçërisht nga ato që janë Ipa e konsideroni raport të kënaqshëm?

Pyetja tjetër përmendet në material se shërbimi i pastrimit do na kushtojë rreth 133 milion lekë nga të cilat 85 milion janë për rrugë dhe parqe dhe 47 milion për tërheqjen e mbetjeve urbane, po

e gjej të paspecifikuar do kërkoja nga ekzekutivi sa % është zëri i pastrimit nën umbrellën e shpenzimeve koherente dhe në buxhetin total?

A kemi ndonjë detyrim debitor si Bashki ndaj ndonjë banke apo subjekti tjetër, nëse po sa është vlera dhe cilat janë termat e detyrimit?

Pyetja e radhës lidhet me faqen 11 të materialit, ku përmendet në paragafin fundot, në përfundim struktura e shpenzimeve për periudhën 2024-2028 reflekton një orientim forcimit të kapaciteteve njerëzore dhe rritjes të investimeve duke ruajtur disiplinën fiskale të shpenzimeve koherente dhe duke ofruar stabilitet buxhetor afatmesëm. Pyetja që më lind këtu është, ku e bazoni këtë pra elementin përforcues të kapaciteteve njerëzore e nënkuptoni prej trendit rritës të pagave?

Tek tabela e faqes 12 për reference, pse përveç, transfertave të pakushtëzuara, të ardhurave të trashëguara dhe fondet Ipa për të cilët plani i realizimit të pritshëm është e përafërt me buxhetin fillestar të vitit 2026, më konkretisht për burime të tjera të financimit si të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore dhe të ardhurat e institucioneve, pse ka një shproporsion të madh mes realizimit të 2025 dhe buxhetit të projektuar 2026?

Pyetja tjetër lidhet me faqen 15 dhe 16 të materialit ku përmendet për rritje të moderuar dhe të qëndrueshme, thueht rritja e numrit të subjekteve të reja ekonomike apo përmirësimi i sistemit të komunikimit, dixhitalizimit, rritja e efikasitetit të strukturave dhe asgjentëve mbledhës apo në faqen tjetër thuhet të njëjtat fjalë të rris eficiencën e mbledhjes të të ardhurave, të ul detyrimet e prapambetura por nuk thuhet asnjë analizë shteruese, informimi apo logjike sesi do t'i bëjnë këto kolegët tanë të ekzekutivit dhe çfarë politika të qarta dhe të qëndrueshme paskan për taksa pagesit?

I bie që ose ju jeni trajnaur dhe tashmë keni një mjet të fuqishëm komunikimi dhe politikë të qartë për taksa pagesit ose është një ekip krejt i ri që do merret me këtë punë. Pyetja është edhe retorike edhe e sinqertë, ku do ta kemi garancinë që këto projektojnë kanë bazë reale? E njëjta gjë ndodh edhe me tarifat kam pyetje për materialin në faqen 27 dhe 28, në lidhje me taksat vendore dhe këtu shoh që ka një shproporcion, pse është ky shproporcion krahasur me vitin 2023 deri në vitin 2025 me buxhetin në vitin 2026, e njëjta pyetje për tarifën?

Sa i takon kulturës kam pyetje në lidhje me tabelën në faqen 109, këtu na është paraqitur një material ku janë listuar gjithë titujt e aktiviteteve, me totalin e kostove dhe onoraret dhe shërbimet e tjera dhe nuk sqarohet se kaq kanë kushtuar këto në vitin 2025 apo kaq është parashikimi për 2026?

Kurse për faqen 110, përsëri tek tabela shoh zëra të tipit mbrëmje poetike 200 mijë lekë pra 2 milion lekë të vjetra, pa dhënë asnjë shpjegim, mbase mund të vijë ndonjë poet që do i pagojnë onoraret, nuk e di më duken të dryra deri diku, por nuk po kaloj në komente. Këtu tek tabela më poshtë tek Teatri “Andon Zako Çajupi” është një zë ku thuhet teatër 1 martesë, 1 divorc, 1 funeral ku ne jetojmë këtu dhe e dimë se u shfaq kjo vitin e kaluar, do shfaqet sërish apo është një tabelë me zërat e eventeve që janë bërë?

Në mbledhjen e komisionit kolegja Mirela ka pyetur në lidhje me orkestrën simfonike, sesa është bërë buxhetimi për orkestrën simfonike dhe nga ekzekutivi është dhënë një përgjigje 325 mijë

lekë, me një llogaritje të thjeshtë që bëra me anëtarët më rezulton 8 mijë lekë për gjithë vitin për 1 instrumentist që më duket ose pa vend, ose ka një gabim do doja një sqarim nga kolegët e ekzekutivit, këto kam për moemntin, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, pyetje të tjera?

Këshilltar K.Pllaha: Duke marr shkas nga fjala e z.kryetar më lindën disa pyetje, ju përmendet që keni bashkëfinancime me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, Universitetin e të tjerat, më vjen mirë që janë këto bashkëpunime por duke qënë se ne sot do miratojmë ose jo buxhetin do ju lutesha për pyetjet që do bëjmë t'ju referohemi vetëm vlerave që janë në buxhet. Në sektroin prioritar të buqësisë ju thatë janë 18 milion që vihen në dispozicion të tyre pjesa më e madhe vjen nga transfertat e pakushtëzuara për sistemin e kullimit dhe ujitjes dhe pjesa më e madhe shkon për paga dhe sigurime shoqërore, mos duhej një fond më i madh që shkon për investime në këtë sektor që të stimulonte fermerët?

E dyta ju përmendët një fermë model që do e zhvillojë Bashkia, në tokat e Bashkisë besoj, me punojësit e Bashkisë sepse nuk e saktësuar këtë pjesë, mos është kjo një konkurrencë e pandershme ndaj fermerëve privatë që me mundin e tyre mundohen të zhvillojnë ekonominë dhe a mos ishte e nevojshme që Bashkia të merrte një rol të agjentit kombëtar për këta fermerë, për t'ju siguruar një treg të qëndrueshëm?

Përsa i përket turizmit përveç pjesës të eventeve, sa është fondi i dedikuar turizmit, vetëm nga buxheti i Bashkisë pa përmendur investime të dikujt tjetër dhe sa ndikon kjo në zhvillimin ekonomik dhe kur flasim për zhvillim ekonomik e kam fjalën për një lloj incentive që Bashkia mund t'ju jape bizneseve apo sipërmarrësve të rinj për të krijuar punësim sepse besoj se kjo është një nga nevojat kryesore të Bashkisë. Së treti ka qënë prioriteti juaj që prej marrjes të pushtetit dhe vetëm tani po uleni për të bërë një strategji turistike, deri tani keni punuar pa strategji?

Sa është fondi që Bashkia vë në dispozicion për mbështetjen e familjeve të reja, me gjitha programet e saj dhe a është ky fond në rritje, në ulje apo njësoj si vitet e kaluara?

Investimet në arsim përmendët Polin e Dijes dhe Liceun Franzes, cili është roli i Bashkisë këtu, ka rol në dhënien e tokës, në menaxhim, ku do bëhen këto ndryshime dhe zhvillime, përshebull Poli i Dijes do kalojë në pronësi të Universitetit do zhvillojë atje mësim, nëse po çfarë ndodh me godinat e tjera të universitetit, kush i merr në pronësi ato, e njëjta pyetje për Liceun Francez, ku do ngrihen godinat që ju përmendët? Këto janë pyetjet për moemntin.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, pyetje të tjera?

Këshilltar I.Bode: Kma vetëm një pyetje të thjeshtë duke qënë se dhe formimi im nuk është i fushës të financës apo ekonomisë, dua të bëj një pyetje edhe nga pozicioni i publikut, i masës së gjërë. Nga I gjithë buxheti ne shohim se 1.2 miliardë prej tyre janë paga, po ashtu shohim se transfertat e pakushtëzuar është pak a shumë në këto shifra, tani pyetja ime është dhe mundësisht do doja një përgjigje të thjeshtë, duke qënë se të ardhurat i realizojmë në masën 65 % apo pak më tepër këtë mangësi që do ketë nga ky realizim kush do e ndjejë më shumë, shpenzimet koherrente apo investimet?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, pyetje të tjera?

Z.Bregu ka kërkuar fjalën.

Këshilltar E.Bregu: Duke pasur parasysh shifrat tek buxheti shikojmë se janë parashikuar rritje e të ardhurave nga bizneset dhe ka një shpejgim atje që thotë është bazuar në rritjen e numrit të bizneseve të reja. Duke patur parasysh që popullata është në rënie vërtet e besoni se bizneset e reja po shtohen, e keni seriozisht apo është ndonjë lapsus?

E dyta tek zërat e të ardhurave nga Ndërmarrjet në varësi të Bashkisë nuk shoh të ketë të ardhura nga Ujësjiellësi tek e cila Bashkia është aksionere me 28-29 % të askioneve, gjithashtu Bashkia realisht është aksioner tek Klubi i Futbollit Skënderbeu edhe pse kryetari prej 1 viti e gjysëm pret konfirmimin nga aksioneri maxhoritar për disa informacione që i ka kërkuar. Nuk shoh asnjë zë atje që të ketë parashikim të ardhurash apo shpenzimesh në lidhje me këtë ndërmarrje ku Bashkia është aksionere, mund të na ndodhë të ardhmen që Klubi të ketë një borxh të madh për shkak të lëvizjeve, transfertave të futbollistëve të tjera dhe mund të përballemi nesër me faturë 20 milion euro përshembull, për shkak të transaksioneve me futbollistët dhe Bashkia Korçë nuk është në dijeni as të veprimtarisë dhe nuk ka asnjë parashikim në buxhet lidhur me këtë veprimtari. Në lidhje me ndihmën e shtresave në nevojë kemi diskutuar disa herë që ndihma që ju jepet këtyre shtresave 1 mijë e 500 lekë apo 2 mijë lekë sepse është kundështuar disa herë nga këshilltarët socialistë se nuk e kemi shprehur qartë shifrat, nuk është 1 mijë e 500 por 2 mijë e 100, pra janë shifra të nivelit qesharak dhe nga ekzekutivi është marrë angazhimi t'i drejtrohen institucioneve të tjera të pushteti vendor dhe të ketë mundësi të bëhen ndryshime dhe ligji është i tillë që e detyron Bashkinë të japë kontribute qesharake për shtresat në nevojë dhe na është thënë që është bërë komunikim me këto institucione dhe nuk e di nëse në vitin në vazhdim do ketë ndonjë parashikim lidhur me këto shtresa të trajtohen në mënyrë dinjitoze siç ju takon apo do vazhdojnë të trajtohen në mënyrë qesharake. Keni parasysh se pagat zenë pjesën më të madhe ndoshta kjo mund të jetë normale edhe në vendet e tjera të botës nuk e di, por duke pasur parasysh se pjesa më e madhe mbështeten nga Qeveria a mos nënkupton kjo se Bashkia Korçë e ka humbur autoritetin e saj dhe varet plotësisht nga Qeveria dhe autoriteti vendor e ka humbur pushtetin e tij është thjesht formal dhe nuk bën asgjë pa miratimin e pushtetit qëndror. Kjo është një pyetje që do doja që kryetari i Bashkisë ta merrte seriozisht në konsideratë dhe të na jepte përgjigje shteruese. Në lidhje me prioritetet që na ka paraqitur që janë gjithmonë 4, ne kemi parasysh se Bashkia Korçë nuk ka strategji zhvillimi thjesht bën investime kuturu.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Më fal që po ju ndërpres z.Bregu mos bëni komente mbi pyetje, bëni si fillim pyetje, pastaj kur të jetë fjala për diskutime bëni komentet,

Këshilltar E.Bregu: Unë pyetje po bëj, por po e parashtroj. Në lidhje me zhvillimin e turizmit ne kemi bërë propozime prej 3 vitesh që kemi këtu në Këshill të cilat asnjëherë nuk janë marrë parasysh, unë kam bërë disa propozime në lidhje me strategjinë e turizmit dhe strategjinë e buqësisë duke pasur parasysh ato pika që këto sektorë kanë nevojë. Në lidhje me turizmin kisha bërë propozim rehabilitimin e banesave të figurave patriotike të zonës të Korçës dhe nuk e di nëse kryetari e ka marrë në konsideratë këtë propozim, i është dukur me interes dhe a ja u ka drejtru drejtorive përkatëse për ta trajtuar, nëse ky propozim është i vlefshëm apo jo se mbase ky propozim mund të mos përputhet me nevojat dhe kriteret, ose mund të mos jetë i plotë ka nevojë për shtesa apo jo. Doja një përgjigje nga ana e kryetarit lidhur me këtë propozim, propozimi tjetër ka të bëjë me buqësinë, blegtorinë dhe zhvillimin rural duke pasur parasysh se kjo është një

nga shtyllat më të rëndësishme të Bashkisë dhe në shqetësimet që kanë fermerët pa pasur parasysh pastrimin e kanalizimeve, e të tjera, çështja kryesore që ata kanë ka të bëjë me orientimet që duhet të kultivojnë të jenë të orientueshme në treg, kanë nevojë për informacion ku të orientohen në zhvillimin e pronësisë të tyre, tokave dhe ndoshta Bashkia mund të bashkashkëpunonte edhe me institucione të tjera ndoshta edhe të huaja për të orientuar fermerët.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Këto janë sygjerime dhe komente mbi këtë, ju lutem pyetja.

Këshilltar E.Bregu: Pyetja është a e ka marrë parasysh kryetari këtë propozim?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem mos bëni komente tani, kur të merrni fjalën për diskutime.

Këshilltar E.Bregu: Po shpjegoj propozimin që kam bërë, a e kanë marrë parasysh?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ndërtoni pyetjen nëse nuk jeni të qartë në shpjegime bëheni në diskutim.

Këshilltar E.Bregu: Duhet ta kuptojnë edhe ata të tjerët që nuk e dinë propozimin.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Diskutoni dhe mbi bazën e propozimit që ju keni bërë, por kur të diskutoni, nuk jemi ne diskutime.

Këshilltar E.Bregu: Kam porpozuar ngritjen e një strukture e cila do të jetë në funksion të buqësisë dhe blegtorisë, që ka lidhje me mbështetjen e fermerëve, për tregëtimin e produkteve, për të gjetur tregjet dhe në rastet më të fundit të ofrojë ndihmë apo subvencion për të përballuar që fermerët të mbijetojnë, Diskutimet e tjera do i bëj kur të marr fjalën për diskutime.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Znj.Dinellari ka kërkuar fjalën për pyetje.

Këshilltare S.Dinellari: Ashtu siç e tha dhe kryetari të ardhurat që i vijnë Bashkisë në masën 49.6% vijnë nga taksat dhe tarifat vendore, ajo që vura re tek projekt buxheti i vitit që vjen është fakti se është rritur numri i përfituesve që ka lehtësi dhe përjashtohen nga tarifat vendore dhe është me vend të përmendim këtu edhe iniciativën që mori drejtoria përkatëse në hartimin e buxhetit gjinor ku parashikohej edhe parashikimi mosha e grave 19-30 vjeç të cilat mund të ndërmarrin një iniciativë për të hapur një subjekt përfitues apo gratë e dhunuara. Megjithatë problematika qëndron tek fakti që a mos kthehet ky në një efekt domino nëse ne përjashtojmë shumë njerëz nga tarifat ne do kemi më pak të ardhura dhe kjo përkthehet në më pak investime?

Së dyti a kemi ne të dhëna në lidhje me emigrimin potencial në QArkun e Korçës sepse kjo do na ndihmonte më shumë për të mbledhur të ardhurat?

A janë parashikuar në këtë projekt buxhet përjashtimet e OJF-ve të cilat kanë në fokus mjedisin, të përjashtohen nga tarifa e gjelbërimit, si e gjykoni?

A gjykoni se taksa për token buqësore, në rastet e emergjencave siç janë përmbytjet si ato që kaluam, mund të bëjë që të përjashtohen këta njerëz nga pagesa për tokat buqësore sepse produkti që mund të marrin nuk ishte ai që pritej?

Në idejimin e projekt buxhetit unë do mendoja se ka nevojë për t'i dhënë përgjigje disa pyetjeve që ju referohem. Së pari numri i punojësve sepse sipas programeve që zhvillohet në Bashkinë

Korçë vihet re se numri i punojësve nga viti 2025 deri ne 2026 dhe parashikohet edhe për 2028 mos ketë luhatje deri diku të ketë një luhatje 2-3 punojës, por duke evidentuar faktin që rajoni i Korçës karakterizohet nga plakja e popullsisë a do të kishte një vëmendje të duhur rritja e numrit të punojësve për projektet sociale, pra një ndryshim i numrit të punojësve?

Së dyti në lidhje me pakicat kombëtare vura se përjashtimet nga tarifat apo lehtësimet apo përkrahje e mbështetja e komuniteteve fetare është evidente edhe në këtë prjektbuxhet, por duke parë se ligji 96 2017 për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Shqipëri evidenton nevojën edhe të planeve vendore në lidhje me mbrojtjen e tyre duke qënë se qyteti i Korçës karakterizohet nga pakicat greke, maqedonase, rumune, egjyptiane dhe bullgare duhet të ketë vëmendje dhe a parashikohet diçka në këtë projekt buxhet? Sepse nuk pash Sepse nuk pashë diçka të parashikuar. Duke qënë se ju e qartësuar që në pjesën më të madhe në infrastrukturë, në pjesën e arsimit bëhen me 20 % të fondit të Bashkisë ne duhet të kemi një plan më të detajuar lidhur me mbështetjen për pajisje. Ajo që unë ngrita pyetje në rastin e prioriteteve pse u përzgjedhën disa shkolla dhe disa të tjera kishte të bënte me numrin e përfituesve, ne duhet të kemi një plan të detajuar nga Drejtoria e Arsimit por edhe nga zyrat vendore për numrin e nxënësve në këto shkolla sepse kemi shkolla që kanë numrin e nxënësve të mbipopulluar që ndoshta kanë nevojë më shumë për investime në pjesën e infrastrukturës dhe pajisjeve sesa shkollat që mund të zgjidhen si prioritete, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ka pyetje të tjera?

Këshilltare M.Qeleshi: Përhëndetja ndjesë për ngjyrën e zërit sepse është efekti i dimrit. Në bazë të ligjit 68, 2017 parashikimeve, neni 12/4 të ardhurat nga taksat e reja një pjesë e tyre duhet të përdoren për fianancimin e investimeve, nuk sqarohemi në material sesa % e këtij zëri është përdorur në investime. Numrin e popullsisë e bëri pyetje Lazjoni që është diferencë e madhe nga shifrat që merr Bashkia nga gjendja civile me censusin. Pse planifikohen gjoba përveç detyrimeve të prapambetura? E kemi bërë edhe në komision këtë pyetje. Nuk kemi në material, një strukturë të lejave të ndërtimit kur dihet që në pjesën e taksave dhe tarifave, peshën më të madhe e ka taksa e ndërtimeve të reja, pse nuk kemi një strukturë të lejave të ndërtimit ku të krijojmë idenë e planifikimit dhe të prognozës si do jetë kjo?

Realizimi i pritshëm i investimeve shkon 46%, u konsumua dhe në komision kjo gjithsesi edhe një sqarim nga kryetari. I pritshmi 11 mujor është 90 milion lekë dhe realizimi 2-mujor është 190 milion lekë të reja, si ka mundësi të realizohen për 1 muaj 100 milion lekë?

E fundit, ndoshta ka të bëjë më shumë me paketën fiskale, por buxheti ka të bëjë me të ardhurat që do vilen nga ajo paketë. Vjelja e të ardhurave, keni zgjedhur si agent Ndërmarrjen e Ujësjiellësit, kjo është një mënyrë mbase për të marrë maksimumin e taksave dhe tarifave, por nëse një qytetar nuk mund të paguajë taksat dhe tarifat por mund të paguajë vetëm shërbimin e ujit në një periudhë të caktuar të vitit nga taksat dhe tarifat ndërkohë që këto merren në një periudhë të caktuar të vitit, pse duhet të privohen nga shërbimi i ujit, mund të gjetët një mënyrë tjetër?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju e thatë dhe vetë disa nga këto ishin pyetje teknike dhe u ezauruan edhe në komision në dijeninë time dhe do ishte mirë mos ndaleshim sot tek këto pyetje,

të diskutonim më gjërë dhe politikisht, megjithatë nëse ka dikush nga ekzekutivi për të dhënë përgjigje. Z.Osmani nëse keni diçka?

Këshilltar D.Osmani: Kam një pyetje me realizimin e të ardhurave dhe pritshmëritë e tyre për vitin 2025-2026. Këto shifra nuk ka nevojë të jesh specialist t'i lexosh, por vë re një problematikë të madhe që ka vite që e diskutojmë dhe vazhdon prap e njëjta situatë. Të ardhurat nga taksat vendore në pritshmërinë e realizimit të vitit 2025 është diku në 50 % plus- minus me atë të planit 2025 por çuditërisht edhe me atë të planit 2026 vazhdon akoma të jetë në nivelin e planit të 2025 dhe nuk me rezulton të realizohet sepse këtu ka një zë shumë i lartë dhe nuk e di si e kanë menduar ta realizojnë dhe ku e bazojnë që taksën për ndërtimet e reja, vazhdojmë ta kemi akoma 280 milion, në një kohë ku ajo nuk është realizuar më shumë 80-83 milion dhe mesa dhe të gjithë ne kemi informacion nuk ka ndonjë pritshmëri për të vazhduar të lartë për ndërtimet e reja dhe ne realizimin e 2023 ajo është përsëri 114 milion po themi që 2023 ka qënë një vit i mirë për ndërtimet e reja dhe ka patur boom. Të ardhurat jo tatimore teknikisht dhe çuditërisht shoh që kanë një specifikim që i përafrohet dhe nuk është dëshirë, po ndajmë midis nesh një buxhet dhe ky buxhet nuk e di pse ka këtë diferencë, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, nëse nuk ka diçka tjetër fjala për ekzekutivin për përgjigje.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në lidhje me numrin e popullsisë të Bashkisë Korçë kemi dy referenca, 1 numri i banorëve në gjendjen civile dhe tjetra numri i popullsisë nga census. Me rregjistrin e gjendjes civile jemi diku në 130 mijë banorë sipas censusit jemi 60 mijë e 72 banorët por lidhjen e buxhetit tek kjo pyetje nuk e kuptova por do na i shpjegoni më vonë. Në lidhje me fondet Ipa nuk jam fare i kënaqur edhe 60 milion po të ishte nuk do isha i kënaqur sepse sa më shumë aq më mirë financime nga projektet nga burime jo të buxhetit të kemi aq më mirë është, me rrugën e Shqipërisë drejt BE besoj se do kemi sa më shumë financime dhe është detyra jonë të përthithim sa më shumë fonde në zbatimin e projekteve tona. % e pastrimit ndaj shpenzimeve operative të përgjigjet Valbona në fund. Detyrimet ndaj bankave edhe këtë Valbona. Përsa i takon i takon trajnimit të kapaciteteve njerëzore kemi bërë një diskutim para disa muajsh që i paraprinte dokumentacionit të Akademisë të Trajnimit të Pushtetit Vendor, kjo tashmë është finalizuar si projekt kam firmosur si titullari i institucionit pjesëmarrjen e Bashkisë Korçë në këtë akademi e cila së bashku me institucione të huaja do kryejë trajnimin e gjithë stafeve të Bashkive në përputhje me detyrat aktuale që kanë por edhe me të ardhmen dhe sfidat që duhen për tu integruar dhe me këtë buxhet është edhe bashkëfinancimi midis Bashkisë të Korçës në kuadrin e funksionimit të kësaj akademie. Të ardhurat, u bënë disa pyetje që lidheshin me realizimin e të ardhurave faktike të 2025 me planifikimin e të ardhurave të vitit 2026. Një paraqitje më të detajuar mund ta bëjë Soni por ajo që dua të them e kam thënë e më parë, ne bëjmë një planifikim bazuar mbi pritshmëritë tona të cilat në rastet kur nuk kemi një informacion të detajuar sepse përsëmbull si do ecin lejat e ndërtimit nuk e ke 100% të sigurt, jemi të prirur ta planifikojmë por nga ana tjetër ajo që duhet të kujdesimi është moszhbalancimi i buxhetit në pjesën e realizimit dhe këtë gjë ne e kemi bërë çdo vit dhe po që se ne planifikojmë në mënyrë të ekzagjeruar dhe pastaj shpenzimet i bëjmë bazuar tek ky projeksion i ekzagjeruar të të ardhurave mund ta bësh diçka të tillë do kesh një listë të gjatë të detyrimeve dhe ne këtë listë nuk e kemi. Ishte një pyetje për pjesën e Artit dhe Kulturës, si ishte pyetja?

Këshilltar L.Petri: Njëra pyetje ishte për orkestrën simfonike dhe tjetra për tabelën sepse nuk paraqitej qartë nëse ishte listim aktiviteteve të këtij viti apo viti që vjen dhe mora shembull një shfaqje që është dhënë së fundmi, mbase do jepen prapë?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Do e filloj nga kjo e fundit duke u tërhequr vëmendje drejtuesve që nuk kanë erdhur.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kryetar erdhi Blerta.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Përgjigju pak Blerta, të lutem.

Ekzekutivi B.Belliu: Përsa i përket shfaqes një martesë, një divorc, një funeral është sjellë një ftesë për të qënë pjesë e festivalit në Bursa, në Turqi, do rikthehet në 2026 për qytetin e Korçës sepse ju e dini se teatri i Korçës është një teatër repertori nuk vdesin shfaqet kur jepen njëherë por mbahen në repertor. Përsa i përket orkestres simfonike, edhe njëherë pyetja?

Këshilltar L.Petri: Për orkestrën simfonike gjatë mbledhjes të komisionit është pyetur sesa është fondi i buxhetuar për orkestrën simfonike dhe nga ekzekutivi është dhënë përgjigjia 325 mijë lekë dhe është pyetur sa persona janë anëtarë të kësaj orkestre dhe kanë thënë 40 anëtarë dhe me një llogartije të thjeshtë i bie 8 mijë lekë për person gjatë gjithë vitit, kaq marrin?

Ekzekutivi B.Belliu: Po kaq marrin në muaj sepse ju e dini se orchestra ka kaluar në një ringritje të sajën, është akoma një orkestër mund ta quaj e brishte pavarësisht se bëri një premierë shumë të mirë, mendoj se kjo pagesë është normale tek kjo fazë që jemi duke e parë në 2-3 premierat e ardhshme se ku do shkojë niveli i saj dhe në bazë të performancës do sygjerojmë rritje të pagesës.

Këshilltar L.Petri: Më fal por kjo shifër i bie në nivel vjetor.

Ekzekutivi B.Belliu: Jo është 8 mijë lekë të reja për instrumentist në muaj mos është bërë gabim në tabelë.

Ekzekutivi: Kjo është njëra nga grupet që funksionojnë nga 3 grupet me 325 mijë lekë në muaj, nga të cilët 12 mijë lekë derigjenti dhe 8 mijë lekë pagesa e orkestrantëve, për vitin 2026 është planifikuar 42 persona me një buxhet prej 341 mijë lekë, 8 mijë lekë për orkestrantët dhe 12 mijë për derigjentin. Përmendet dhe mbrëmjen poetike e cila zhvillohet tek biblioteka dhe biblioteka krahasim me vitin 2025 nuk ka ndryshim, 5 projekte kishte, 5 ka dhe në buxhete nuk ka ndryshim, marrin pjesë poetë të njohur. Për vitin 2026 është planifikuar të ketë edhe autorë të rinj. Edhe projekti një martesë, një divorc, një funeral është shfaqur dhe do shfaqet disa herë, jo vetëm kjo por edhe projekte të sukseshme të tjera, janë shfaqur dhe do shfaqen disa herë, në periudha të ndryshme.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, mund të vazhdoni kryetar.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Sa i takon fermës të mollëve, mbase duhet ta sqaroj pak më të detajuar. Ky është një projekt shumë i madh, ku në një territor mes fshatit Qatro, dhe Dvoran të ndërtohet një fermë e madhe mollësh, ku të zbatohen të gjitha teknologjitë më të fundit për rritjen e mollëve duke ja u demonstruar dhe fermerëve dhe të ngrihet një strukturë pastaj për seleksionimin dhe paketimin e mollëve. Ky investim do jetë në funksion jo vetëm të mollës të

fermës por edhe mollëve të zonës, të cilët do kenë mundësi që mollët e prodhuara tek fermat e tyre t'i sjellin tek kjo qëndër t'i paketojnë sipas standarteve bashkëkohore dhe do kenë dy opsione, ose t'i marrin dhe t'i shesin personalisht ose t'i lenë tek qëndra të bashkohen me mollët e tjera të arrijnë masat kritike më të mëdha ku mund të kapin klientë më të rëndësishme, si rrjet supermarketesh por me një standart më të madh. Ky produkt do e ngjitet zonën tonë të prodhimit në një nivel të ri, ka qënë një prej premtimeve tona. Projektet për të cilat flasim ju do i gjeni tek programi i fushatës elektorale për vitin 2023, do gjeni polin e jugut që ka qëndrën e madhe të eventeve tek vaskat e peshkut, fermën e mollëve dhe ky projekt po ndodh tashmë, projekti i polit të dijes e cila po ndodh, projekti i gazifikimit po ndodh, projekti i pallatit të sportit po ndodh, të tjerat janë në vazhdim, pra Bashkia ka 1 program dhe strategji, të projekteve madhore që tregojnë drejtimin që do marr Bashkia edhe projektet e tjera. Përsa i takon fondit për turizmin. A do ketë konkurrencë ndaj fermerëve, konkurrencën nuk e ndalon njeri dhe ky nuk është qëllimi im as i ndonjë institucioni vendor.

Këshilltar D.Osmeni: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Dëgjoni ju lutem mos ndërhyri sepse po ndërhytë tek çdo fjali zgjatemi kot, dëgjoni pastaj bëni diskutimin tuaj.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Konkurenca nuk është fjalë e huaj, është një nga shtyllat e ekonomisë të tregut, konkurenca e pandershme është tjetër gjë. Ky projekt po implementohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, nuk po implementohet nga ana e Bashkisë.

Këshilltar D.Osmeni: Është projekti juaj.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Tani do më ndërprisni tek çdo fjali, mbaj shënim edhe unë mbajta shënim 30 pyetje më kalonin shumë gjëra në mendje por prandaj ka dale lapsi, letra dhe edukata 3 elementë që ndjekin procesin. Po ideja ka qënë e Bashkisë dhe i jemi qasur Fondit të krijojmë një model të kësaj kulture kaq të rëndësishme siç është kultura e mollës, duke paraqitur edhe disa prej sfidave që ne kishim siç ishte pjesa e mungesës të seleksionimit, paketimit dhe sfida që kanë fermerët sepse duke qënë tek e tek në momentin e shitjes, fuqinë e negociatës e kanë tregëtarët e shumicës që vendosin çmimin e mollëve dhe kemi dalë me këtë projekt i cili do zbatohet nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, nuk do zbatohet si një projekt i cili nuk ka logjikë ekonomike, do funksionojë si strukturë ekonomike me stafin e saj, me fermën e saj dhe me kostot e saj të llogaritura hde me një produkt final. Qëllimi i këtij projekti nuk është fitimi në sensin të nxjerrë nga tregu fermerët e vegjël.

Këshilltar D.Osmeni: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem mos ndërhyri tek çdo fjali, lëreni të mbarojë dhe më pas diskutoni dhe thoni mendimin tuaj, nuk mund t'ja impononi mendimin tuaj tani. Keni 10 minuta kohë në diskutim.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Unë kam nevojë për ndihmë, që mbledhja të jetë me standart ligjor, qytetar në kuptimin mos ndërpritemi sepse nuk ka ndonjë gjë.

Këshilltar D.Osmeni: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mbaj shënim me laps dhe letër, ta them unë të gjithën sepse mund të sqarohesh rrugës, Tani do funksionojë si një njësi ekonomike, me logjike ekonomike. Qëllimi final është të demonstrojë në praktikë standartet më të mira, të rritjes të kësaj kulture buqësore në drejtim të infrastrukturës fillestare, të përfshirjes të teknologjisë e të tjera që janë pjesë e rritjes dhe pastaj në pjesën e proceseve shtesë seleksionimi dhe paketimi, kjo linjë së bashku me laboratorin e analizave do jetë ndo jetë në funksion të vetë fermës dhe fermerëve të zonës, të kultivojnë mollët sipas standarteve dhe pastaj ose t'i marrin ose t'i bashkojnë, nëse ky nuk do ishte ky projekt do shisnin individualisht siç ka ndodhur dhe qahen pastaj pse fuqinë e negociatës e kanë tregëtarët. Ne po ju krijojmë një mundësi me këtë projekt të kultivojnë në mënyrën e duhur dhe të krijojnë një ekonomi të shkallës. Kaq për këtë projekt nëse nuk do ta kuptosh është mendimi jot.

Këshilltar D.Osmari: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem lëre të mbarojë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mbaj shënim në fund, sepse ka edhe pika të tjera, respektojmë rradhën.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Do ta jap fjalën të parit për diskutime.

Këshilltar D.Osmari: Replika nuk është e ndaluar në mbledhje Këshilli.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Do bëjmë zhurmë tani?

Këshilltar D.Osmari: Ku e shikoni ju zhurmën jeni dy me mikrofon hapur që po bëni zhurmë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Lëreni të mbarojë mendimin, kur ta kërkon fjalën për replikë do ja u jap, ne nuk ju kemi ndërprerë kur keni folur.

Këshilltar D.Osmari: Zonja kryetare replikat bëhen për çdo çështje që ngrihet.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem të mbarojë kryetari mendimin dhe pastaj do ja u jap fjalën, nuk e ka mbaruar fjalën. Ti nuk po e le të flasë.

Këshilltar D.Osmari: Kryetari nuk është as zoti, as i plotëfuqishmi nuk na komandon kryetari ne do bëjmë replikë për çështjen që po bën kryetari.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem të mbarojë, do ta jap fjalën.

Këshilltar D.Osmari: Kur do ma japësh fjalën?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem të mbarojë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në lidhje me këtë pikë për aq sa e bëtë pyetjen ja u dhashë përgjigjen, të vazhdoj edhe me të tjerat, në rast se do keni diçka tjetër këtu jemi nuk ikëm. Më fal kush e bën këtë përcaktimin e procedurës të mbledhjes ju?

Unë nuk jam, unë mbajta shënim pyetjet, po vazhdoj. Doni të merrni edhe komandën e mbledhjes, të caktoni rradhën e përgjigjeve? Ok.

Përsa i takon sektorit të turizmit bashkia ka pasur vazhdimisht strategji edhe plane veprime, të cilat nuk janë të përjetshme por ndryshohen edhe përpunohen edhe shtohen edhe plotësohen në kohë. Ajo që unë fola është se do bëhet një projekt me Agjensinë Franzeze për Zhvillim si pjesë e marrëveshjes ndërmjet dy Qeverive që synon të mbështesë Bashkitë e Qarkut Korçë për zhvillimin e turizmit, strategjisë të zhvillimit, turizmit rajonal me fokus në turizmin e natyrës, kjo është projekti për të cilin fola. Në 2024 kishim një projekt tjetër bashkëfinancim me fondet e BE që ndihmoi 4 Bashki në krijim të brandit turistik dhe zhvillimit të disa produkteve turistike, ka vazhdimisht projekte dhe iniciativa dhe në pjesën soft që ne si institucion përfitues përpiqemi t'i kordinojmë 1ë do projekte me dy donatorë të ndryshëm të bëjnë të njëjtën gjë, këtë përpiqemi ta shmangim. Ndërkohë që në buxhet është planifikuar mbështetja për paketën e eventeve, ndërkohë që në varësi të detajimit dhe bashkëfinancimeve të tjera që mund të sigurojmë mendoj që do të bashkëfinancojmë edhe ndërtimin e një zyre moderne të informacionit turistik në qendër të qytetit. Pastaj projekte të tjera në shkallë më të vogël, në pjesën e markimit të shtigjeve turistike për hiking ato i akomodojmë brenda buxhetit. Për familjet e reja përfitimet nga buxheti janë të shumta dhe një familje e re mund ta gjejë vendin në shumë nga këto projekte të Bashkisë, një familje e re përfiton nga projektet e strehimit social, sidomos projektet e kredisë me interes të subvencionuar, nga mbështetja që jep Bashkia për çerdhet, kopshtet, shkollat. Nga projektet e Bashkisë për Qytezën e Fëmijëve, nga projekti i Liceut Franzec në pjesën e edukimit, nga projektet në infrastrukturë, hapësira të përbashkëta, një familje e re mund ta gjejë veten tek këto projekte. Investimet tek hapësirat e gjelbra si ta ndash sesa % përfiton mosha e re, apo mosha e tretë. Përsa i takon numrit të bizneseve dua të ndalem sepse u tentua të bëhej edhe ironi në rast se e kemi seriozisht që numri i bizneseve është rritur, kur numri i popullsisë është në ulje, Shifra zyrtare që kemi nga Qkb për vitin 2025 janë hapur 349 biznese të reja dhe janë mbyllur 165 biznese, në total janë 184 biznese të reja, pra + ose -.

Këshilltar E.Bregu: Bizneset e pezulluara janë përfshirë tek këto të mbyllurat?

Sepse ato të pezulluarat (nuk ka audio, flet pa mikrofon.) Nuk dua të të ndërpres.

Drejtorja e Taksave dhe Tarifave Vednore S.Prifti: Quhen gjendje dhe numri i tyre shkon diku në 46.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Po t'i heq edhe këto 46 që nuk mund t'i heq ligjërisht sepse të mbyllura quhen kur shpëputen plotësisht, po t'i heq bëhen 138. Në 5 vitet e fundit në 2021 janë rregjistruar 470 janë mbyllur 384, 86 biznese të reja neto. Në 2022 janë rregjistruar 418 janë mbyllur 258, 160. Në 2023 janë rregjistruar 379 janë mbyllur 240, 139 biznese të reja neto. Në 2024 janë rregjistruar 365 dhe janë mbyllur 224, 141 biznese neto dhe në 2025 ajo që thashë janë rregjistruar 349 biznese, janë mbyllur 165, 184. Në total janë rregjistruar 1981 të reja, janë mbyllur 1271 dhe shtesa neto është 710 biznese të reja. Përsa i takon ndihmës ekonomike, Bashkia është në pozicionin e structures që bën shpërndarjen e ndihmës pra, plotësimin e dokumentacionit, evidentimin e përfituesve nëpërmjet sistemit dhe shpërndarjen pastaj, kurse masa e ndihmës është e përcaktuar me vendimin e Qeverisë.

Këshilltar E.Bregu: Këtë që the ti e thashë me parashtesë, pyetja ishte ekzekutivi na ka informuar që i jemi drejtuar institucioneve qëndrore.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem këto ndërhyrje, e para duhet të kërkosht fjalën, të mbarojë fjalën dhe pastaj çfarë të është thënë nga ekzekutivi dhe çdo shtesë tjetër që mund ta paraqitësh thuaje në diskutime.

Këshilltar E.Bregu: Kryetari ra dakort ta korrigjoja. Çfarë problem ka?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Mbledhjen e drejton kryetaria e Këshillit, mua më paska shpëtuar për hir të së vërtetës se këtë mbajta.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Shtoheni kur të diskutoni.

Këshilltar E.Bregu: Po e ribëj pyetjen më vonë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kur është pyetja e gjatë, na humbet edhe ajo që kemi mbajtur shënim. Për pjesën e rehabilitimit të banesave të personaliteteve e pashë emailin që kishe dërguar me propozimin, nuk është i keq si propozim, nuk kemi parashikuar diçka në buxhet por mund të shihet sesi mund të integrehoet. Në lidhje me atë çka po bën Bashkia për ndihmë në daljen e produkteve në treg, një projekt shumë i madh në fushën buqësore sapo e shpjegova, projekti me Fondin Shqiptar të Zhvillimit me kulturën e mollëve. Ndërkohë një mundësi për ta dhe që diskutuar këtë çështje që realisht është shumë e rëndësishme për fermerët, besoj se do e bëjmë gjatë vitit edhe me prezencë të universitetit Vangeningen, ajo që unë do ju kërkoj edhe në pozicionin e Bashkisë është që konsulenca, ndihma të fokusohet edhe tek ky drejtim sidomos ato që janë kultura masive që angazhojnë sipërfaqe më të mëdha të tokës dhe burime të shumta dhe që kanë edhe problematika në daljen në treg. Jo çdo kulturë buqësore ka problem dhe pjesa më e madhe nuk kanë pasur problem daljen në treg edhe të shiturën me çmime të mira në vitet e fundit, problem ka patur gruri që nuk ka pasur çmim. Vitin e fundit edhe kultura të tjera, pjesa e patates në mos gabo, diçka edhe qepa. Për këto që mbillen vazhdimisht do kërkojmë ekspertizë, pjesa tjetër do shohim si do jetë realiteti dhe çfarë kuahte mund të ofrojë Bashkia gjithnjë në një ekonomi tregu ku fermerin ta këshillosh por nuk e detyron dot të mbjellë çfarë.

Këshilltar E.Bregu: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Na delegojnë ndonjë të ardhura, në rast se kanë fitim dhe ne jemi aksionerë në pjesën.

Drejtorja e Financës V.Ziko: Në rast se kanë fitim po, por këtë vit nuk është parashikuar. Për dividendin e ke fjalën apo të ardhurat që menaxhon Ujësjellësi?

Këshilltar E.Bregu: Kopetencat që të takojnë si aksioner, mund të jetë dividendi dhe të tjera.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Epo dividendi është që mund të jetë e ardhur, në momentin kur kompania një pjesë të fitimit e kalon dividend ai shpërndahet sipas aksionerëve sipas % që kanë, nuk është parashikuar sepse nuk kemi pasur ndonjë informacion nga ana e tyre që do kemi dividend x, por në rast se do kemi do bëjmë një material shtesë e do e sjellim në Këshill.

Këshilltar E.Bregu: Për asnjërën apo t'i ribëj pyetjet?

As për Ujësjellsin as për Klubin Skënderbeu?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Për asnjërën nuk kemi informacion sepse me shumë dëshirë po të kishim informacion do i futim sepse na rritin të ardhurat.

Këshilltar E.Bregu: Nuk po diskutoj dëshirat.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Edhe unë përgjigjen dhashë, tani ishte një pyetje e Suelës që në rast se e kuptova drejt e mbështeste Bashkinë për disa incentive lokale që i janë ofruar disa shtresave në nevojë, por u pyet nëse këto lehtësi mos krijojnë gropë në buxhetin e Bashkisë. Patjetër që po e thashë edhe në materialin e paketës, gjithë ajo ishte në masën 30 milion lekë të reja që po të mos i kishim bërë si incentive do ishin të ardhura në buxhet por gjykoj që vlen që ne ta japim mbështetjen në mënyrë të drejtpërdrejtë duke i përjashtuar nga taksat edhe nga tarifat kryesisht. Propozim për të përjashtuar nga taksa e tokës buqësore ata fermerë që janë prekur nga fatkeqësitë natyrore, përjashtimi nga taksa në përgjithësi është e përcaktuar në ligj dhe nuk është kompetencë e bashkisë apo Këshillit për të bërë përjashtim. Në rast se plakja e popullsisë kërkon nevoja për shërbime shtesë po është e vërtetë me ndryshime demografike kemi numër më të madh të moshës së tretë dhe brenda saj edhe ata që i kanë familjarët larg dhe kanë nevojë për shërbime shtesë sociale, prandaj kemi edhe një projekt me Këshillin e Qarkut i cili synon t'i evidentojnë këta individë dhe pastaj t'ju qaset me një paketë shërbimesh, qoftë nga Bashkia apo donatorë. Ne këtë lloj shërbimi e kemi kthyer në kryefjalë edhe me kontaktet që kemi me donatorë të ndryshme, një prej prioriteteve tona që ja u kërkojmë mbështetjen edhe është pikërisht mbështetja ndaj moshës së tretë. A është pasur parasysh numri i përfituesve në shkollat e përzgjedhur për investime, patjetër ka qënë një prej kriterëve të cilat ne i kemi patur parasysh kur kemi bërë listën e shkollave dhe projektet e detajuara. Prandaj dhe kur bëra detajimin për shkollën Sotir Gura thashë është një nga shkollat më të mbipopulluara dhe me investimin që po bëjmë besoj se me zgjerimin e kapaciteteve do zgjidhim edhe faktin që mësimi bëhet mbasdite, është një nga kriteret që kemi zgjedhur edhe për përzgjedhjen e personave për vitin 2026. Disa pyetje që u bënë edhe nga Mirela në bazë të ligjit përdorimi i taksës mbi infrastrukturë duhet të përdoret për investime, po taksa e ndikimit mbi infrastrukturë së bashku me të ardhurat edhe nga burime të tjera përdoren për të realizuar paketën e investimeve në infrastrukturë dhe po ta shohësh buxheti që ne kemi parashikuar për investime është.

Këshilltare M.Qelesi: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Ta kthejë Valbona bashkë me pikat e tjera që ka për të kthyer. Struktura e lejes të ndërtimit nuk jam përgatitur t'ju jap përgjigje sepse nuk e kam menduar se do bëhej kjo pyetje por lejet e ndërtimit ka disa kategori për banesa individuale në qytet dhe fshat, për investime rezidenciale që bëhen nga investitorë private për tu shitur, për investime në fushën ekonomike, industri, ka disa kategori të lejavë. Për çfarë ju duhet struktura?

Këshilltare M.Qelesi: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Për çfarë ju duhet struktura?

Tani nuk mund ta jap, mund t'ja u jap në mbledhjen e janarit sesi ka qënë struktura gjatë vitit 2025. U bë një sygjërim kërkesë që pse mbledhja e taksave tarifave të familjarëve bëhet nga kompania e Ujësjellës Kanalizimeve, në fakt Bashkia Korçë ka qënë e para që e ka filluar këtë praktikë që në vitin 2008 kur ne e kemi filluar në kuadrin e reformës të decentralizimit të

funksioneve, kemi marrë 100 % menaxhimin e kompanisë të Ujësjetllësit dhe ka qënë një instrument që ne e kemi gjykuar të nevojshëm për të bërë një mbledhje më të mirë të taksave dhe tarifave nga familjarët.

Këshilltare M.Qeleshi: Në rast se një qytetar nuk e paguan dot taksën dhe tarifën sepse në një moment nuk ka.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Doja pak fjalën për procedurë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Për mbarëvajtje sa më të mirë të mbledhjes.

Këshilltar D.Osmeni: More leje?

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Po e mora lejen tek kryetaria. Ajo është kryesuesja e mbledhjes dhe këtë dua të saktësoj. Në seksionin 3 të rregullores në zhvillimi i mbledhjes të Këshillit, neni 72 dhe në vijim përcakton gjithë procedurën që ka në lidhje me diskutimin, replikat.

Këshilltare M.Qeleshi: Jemi në fazën e pyetjeve jo diskutimeve.

Këshilltar D.Osmeni: Ti je sekretare e Këshillit, nuk je as kryetare.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Kam për detyrë zbatimin e rregullores, nuk e kuptoj gjithë këtë arrogancë dhe dhunë verbale që përdorni kur marr fjalën. Nuk ju pëlqen t'ju citoj zbatimin e rregullores për zhvillimin e mbledhjes? E kam për detyrë në ligjin për vetëqeverisjen vendore, një nga detyrat e mia është zbatimi i rregullores dhe etikës në mbledhje.

Këshilltare M.Qeleshi: I takon ligjit 2020, 2019 dhe 2023 nuk i takon 2023-2027 rregullorja.

Këshilltar D.Osmeni: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltare M.Qeleshi: E keni gabim periudhën që keni vënë, e dyta nuk u përgjigj kryetari pyetjes.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Të lutem të mbarojë.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Lejen duhet t'ja u japë kryetaria.

Këshilltare M.Qeleshi: Po sqaroj kryetarin në lidhje me pyetjen që bëra, më vjen keq sepse përgjigjia që po më jep e dhashë vetë, (nuk ka audio, flet pa mikrofon).

Këshilltar D.Osmeni: (Flasin në një kohë dhe bëhet zhurmë.)

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Z.Osmeni pse bërtisni, ju lutem të mbaroj, më dëgjo vendimin deri në fund. E para të mbarojë kryetari fjalën për pyetjet e bëra nga ju.

Këshilltare M.Qeleshi: Fol me emër dhe mbiemër jo me përemra vetorë.

Këshilltar D.Osmeni: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nuk kam thënë mbyllja këtij apo atij gojën, do ta jap fjalën për diskutim.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Të lutem pak me etikë Devi, etikën e keni shumë për të dëshiruar.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Diçka të fundit që po them, të mbarojë kryetari ju pëlqen apo jo përgjigjia kur të diskutoni thoni mendimin tuaj, lëreni kryetarin të mbarojë shpjegimin e pyetjeve tuaja dhe nëse nuk e shpjegon nuk ka nevojë të ndërpritet, ju që jeni teknike dhe më të mençur e thoni më pas. Të vazhdojë kryetari.

Këshilltare M.Qeleshi: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Më korrigjove në mes të përgjigjes unë nuk kisha mbaruar.

Këshilltar D.Osmani: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Kryetari i Këshillit A.Verushi: E thatë 5 herë, lëreni të mbarojë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Për pjesën e procedurës, me kryesuesen e seancën, ajo që p[ro]thoja isha në mes të përgjigjes, por e fillova pak më gjatë mbledhjen e taksave dhe tarifave nga ujësjellësi, e kemi filluar këtë gjë me idenë për ta përdorur Ujësjellësin për të bërë një mbledhje më të mirë të taksave dhe tarifave nga familjarët, nga ana tjetër ligji ja njeh Ujësjellësit të drejtën për të funksionuar si agjent tatimor, në rastin konkret ai po vepron si agjent tatimor, po të binte ndesh me ndonjë ligj do përjashtohet, si kundër mund të punojnë si agjent tatimor edhe kompani të tjera që ofrojnë shërbime për utilitete të tjera. Përshembull është diskutuar që taksa e pasurisë të vilet nga OSHE si e ka emrin tani me këto ndarjet, të jetë pjesë e faturës të energjisë elektrike, nuk ka hyrë në zbatim por është në process diskutimi, Janë mekanizma që nuk bihen ndesh me ligjin dhe i mundësojnë Bashkisë të mbledhin të ardhurat e saj që janë përsëri ligjore. Kategoritë sociale, janë përjashtuar nga pjesa e tarifave, çdo gjë që na thotë ligji dhe nga furnizimi me ujë marrin subvencion nga shteti, 5 m³ në muaj i marrin pa pagesë. Kurse një qytetar tjetër që thotë dua të paguaj vetëm ujin por jo taksat e Bashkisë, jo duhet të paguhen se për ndryshe me çfarë do i bëjmë shërbimet dhe investimet, kjo ishte pyetja që bëre ti por e filluam pak më gjatë dhe harxhuam 15 minuta kot.

Këshilltare M.Qeleshi: Për pjesën si mund të ndihmohen, kur ka 1 moment që nuk mund të paguhen?

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Taksat dhe tarifat.

Këshilltare M.Qeleshi: E di unë që është ligjore kjo.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Shumë faleminderit për argumentin sepse më doli nga mendja kjo, 1 nga arsyet që i kemi çuar është e para të kemi një mekanizëm për t'i mbledhur dhe e dyta kemi një mekanizëm për t'i mbledhur të ndara në kohë sepse në rast se do përdornim mënyrën që kemi gjetur kur i kapnin vetëm kur vinin për të marrë çertifikatë dhe i theshin nuk merrni dot çertifikatë po nuk paguat detyrimet e 3 viteve, tani kanë mundësi ta paguajnë të ndarë në 12 muaj e mos rëndohen. Për pjesën e planifikimit të të ardhruave është 1 shpjegim që mund ta bëjë drejtoria e të ardhurave bashkë me 1 pikë më lart, kishte dhe Valbona dy pyetje.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit kryetar, fjala për drejtorin e taksave dhe tarifave.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vednore S.Prifti: Ishin dy pyetje që u bënë nga Këshilltari Petri dhe Osmani. Planifikimi bëhet mbi kapacitetet reale jemi të detyruar të përfshijmë edhe debitorët

të cilët janë për dy vitet paraardhëse. Çfarë ndodh gjatë vitit nga faktorë të jashtëm nuk mund ta parashikojmë, ai disproporcioni planifikim-realizim vjen vetëm nga ato çfarë ndodhin gjatë vitit, nuk ka ndonjë problematikë në planifikim.

Drejtorja e Financës V.Ziko: Po e nis nga pyetja e Mirelës, sa % nga taksa e ndikimit në infrastrukturë janë përdorur për investimet në 2025 këtë informacion do e marrim kur të mbyllet viti në raportin e monitorimit dhe në raportin e konsoliduar që është në maj, informacionin më të freskët do e marrim tani në shkurt. Ndërsa si ka mundësi që investimet nga realizimi 11- muor në vlerën 90 mijë e 551 mijë lekë në 190 mijë që është i pritshmi, arsyeja është se pjesa më e madhe e investimeve janë shlyer në muajin dhjetor dhe maj dhe në datat 29, 30, 31 do vazhdojë shlyerja edhe në fillim të muajit janar sepse në bazë të udhëzimit për mbylljet vjetore të vitit 2025 gjatë muajit janar lejohet të kryhen pagesa për vitin 2025. Në lidhje me pyetjen e Petrit për shërbimin e pastrimit sa është vlera, po e citoj që vlera është në faqen 95 dhe në të gjitha tabelat e buxhetit, si në tabela ju janë burimet e financimit edhe shpenzimet edhe në matrica e shpenzimeve korrente, në faqen 95 tek programi i mbrojtës të mjedisit vlera është 152 milion e 979 mijë lekë dhe në raport me shpenzimet korrente të cilat janë në vlerën 977 milion zënë 15.5 % ndërsa në raport me totalin e buxhetit zënë deri në 5.7 %. Ndërsa me detyrimet e prapambetura edhe materiali për detyrimet e prapambetura është trajtuar në faqen 81 për arsye se është një nga dokumentat kryesore për tu raportuar gjatë vitit 2026, pjesa e dokumentacioneve shoqëruese dhe në tabelë thuhet se detyrimet e prapambetura janë në vlerën 49 milion e 286 mijë i takojnë periudhës janar- tetor por theksoj se këto detyrime pavarësisht se raportohen tek Bashkia nuk janë detyrime të Bashkisë, 9 milion e 571 mijë janë pagesa e TVSh që i takon inistrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës në bazë të kontratës shfrytëzim inteligjent i energjisë elektrike ku pagesën e TVSH-së e ka Ministria, ndërsa 39 milion e 714 mijë janë detyrime të Ministrisë të Shëndetësisë për pagesat e personave me aftësi të kufizuar që janë paguar gjatë muajit dhjetor. Duke hu referuar planit të pritshëm të burimeve të financimit dua të theksoj jo vetëm që kur të bëhet analiza e këtyre të ardhurave që trashëgohen gjatë vitit 2025 në buxhetin e 2026 burimet do jenë më të larta sepse tani në muajin dhjetor sipas aktit normative të Qeverisë për disa ndryshime në ligjin e buxhetit të vitit 2025 Bashkisë Korçë dhe gjitha Bashkive i është akorduar një fond nga transferta e pakushtëzuar në vlerën 16 milion e 103 mijë lekë e cila sipas aktit normative do përdoret për shlyqerjen e detyrimeve të prapambetura, duke ditur që Bashkia nuk do ketë asnjë detyrim të prapambetur kur të bëhet analiza e të ardhurave të trashëguara do përdoret me vendim Këshilli Bashkiak. Ka përfutur edhe një fond nga Agjencia e Mbështetjes për vetëqeverisjen vendore 2 milion lekë grand i performancës dhe do përdoret me vendim Këshilli. Përsa i përket pyetjes disnivele të të ardhurave me burimet e financimit të pritshëm me buxhetin e vitit 2026 nuk mund të bëhet krahasimi sepse me realizimin e pritshëm janë përfshirë edhe të ardhurat e trashëguara. Në lidhje me pyetjen kush do e ndjejë më shumë zbatimin e buxhetit, faktet e viteve të fundit e kanë treguar se Bashkia tregon një kujdes shumë të veçantë në lidhje me menaxhimin e të ardhurave dhe shpenzimeve, në lidhje me fondin e pagave sepse atje është dhe pjesa më e madhe e shpenzimeve dua të theksoj se rreth 35 % e buxhetit të pagave është nga transferta e pakushtëzuar sektoriale që ka të bëjë me 441 punojës pjesa tjetër 65% që llogaritet nga 788 punojës. Burimet e financimit janë nga transferta e pakushtëzuar për rritjen e pagave, grandit dhe të ardhurat e Bashkisë që zënë një % fare të vogël 22 % në krahasim me totalin e shpenzimeve. Bashkia ju kushton një kujdes të veçantë shpenzimeve utilitare të cilat janë energjia elektrike, shpenzimet e pastrimit. Dhe faktet që Bashkia nuk trashëgon asnjë detyrim gjatë viteve dhe nga

reagimet e Ministrisë tve dhe nga reagimet e Ministrisë të Financave Bashkia Korçë është në vend të parë, tregon se si të ardhurat dhe shpenzimet menaxhohen me kujdes.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Salla është e hapur për diskutime.

Këshilltar I.Bode: Ndoshta nuk isha i qartë me pyetjen time, po e perfrazoj më thjeshtë, nga thesi i madh i parave që kemi në çantë gjysma shkon për rroga dhe kjo gjysëm është e njëjta vlerë që na dërgon para buxheti i shtetit. Tani me pjesën tjetër do përballojmë shpenzimet korrente dhe investimet që janë pak a shumë e njëjta vlerë, meqëse ne më të ardhurat tona realizojmë 65-68 % të tyre, kush do e ndjejë ngarkesën që i kemi caktuar shpenzimeve dhe investimeve, meqënëse nuk i përballojmë dot me të ardhurat që kemi? Unë e di që Bashkia ka bërë një punë shumë të mirë për të mbajtur të balancuar, të kujdeshëm buxhetin, dua të di këtë pyetje.

Këshilltar E.Bregu: Kam disa pyetje që nuk mora përgjigje, e lamë do i bëja më vonë mos ja ndërprisja fjalën kryetarit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Fjala është e hapur për diskutime, ndoshta nuk ka përgjigje për pyetjet tuaja ose keni qënë jashtë kur ju është dhënë përgjigjia. Kush e do fjalën për diskutime?

Këshilltar L.Petri: Ne presim përgjigje nga kolegët e ekzekutivit mund të thonë nuk e dimë, por jo nuk ishit këtu apo ishit jashtë nuk mund të na hidhni hi syve, ju lutem.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Z.Petri kishit ndonjë gje në lidhje me pyetjet tuaja, i morët përgjigjet për pyetjet që dretjuat. Nëse nuk keni marrë përgjigjet për pyetjet tuaja, vazhdojmë.

Këshilltar L.Petri: Kam, kanë edhe kolegët.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Përsëritini edhe njëherë pyetjet, t'ja u jap ekzekutivi.

Këshilltar I.Bode: Meqënëse pyetja ishte e imja.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nuk po flas unë, drejtoresha e financës tha se ju është dhënë përgjigjia.

Këshilltar I.Bode: Ju thatë nuk ka përgjigje dhe e mbyllët.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Drejtoresha tha se ju është dhënë përgjigjia.

Këshilltar I.Bode: Kjo ishte përgjigja? Se unë nuk mora përgjigje.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëse nuk ju pëlqen është tjetër gjë.

Këshilltar I.Bode: Nuk është puna nuk më pëlqen. Si e kuptuat ju përgjigjen që më dha drejtoresha?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po më kërkoni llogari mua, si e kuptova unë atë që nuk kuptuat ju?

Këshilltar I.Bode: Meqënëse unë nuk e kuptova përgjigjen ose jam i paaftë për të kuptuar.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po bëjmë lojëra fjalësh, e kuptova po i them drejtoreshës t'ja u thotë edhe njëherë.

Këshilltar I.Bode: Ta shpjegojë në nivelin e kuptueshmërisë që kam unë ose publiku.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Në rast se e kuptova korrekt, nëse ka mos realzim të buxhetit, kush preken pagat, shpenzimet operative?

Këshilltar I.Bode: Meqënëse kryetari nuk ishte mund ta përsëris edhe njëherë pyetjen?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Po.

Këshilltar I.Bode: Gjysma e buxhetit shkon për paga, këtë vlerë e marrim nga shteti pak a shumë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Jo plotësisht e saktë.

Këshilltar I.Bode: Me diferenca jo shumë të mëdha, gjysma tjetër që pretendojmë ta realizojmë realizojmë nga të ardhurat dhe do ja u çojmë shpenzimeve koerrente dhe investimeve, në momentin që të ardhurat realizohen 65 %, kush do e ndjejë peshën e mos realizimit? Muua më thanë se Bashkia e ka mirëmbajtur buxhetin, mirë e ka mbajtur këtë e pranojmë.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Kështu e kuptova edhe unë, atëherë përgjigjia që fillova t'ja u jepja është që preken të 3 grupet e zërave, nuk ka thënë njeri që pagat planifikohen kaq edhe harxhohen fiks, do e shihni tek realizimi i pagave kur të vijë materiali i analizës të buxhetit të vitit 2025, pra ne përpiqemi të kursejmë në 3 grupet fillojmë me pjesën e pagave, shpenzimeve operative që përpiqemi t'i kemi në kontroll se këto janë planifikime 1 pjesë e shërbimeve prokurohen kursehen, një pjesë e njerëzve që janë me leje apo raport nuk e marrin pagën. Ajo që nuk arrijmë të realizojmë shpërndahet në tre grupe, kujdesemi të ruajmë pjesën e investimeve por reket edhe ajo, këtë përgjigje dhashë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Z.Pllaha knuk morët përgjigje?

Këshilltar K.Pllaha: Pata disa pyetje që nuk mora përgjigje por njëkohësisht do bëj edhe replica për përgjigjet që mora. Pyetja që nuk mora përgjigje ishte roli i Bashkisë tek Poli i dijes dhe tek Liceu, do verë pronë në dispozicion, do investojë në godinat. Investimi e Fondit Shqiptar të Zhvillimit tek ferma e mollëve, është i ngjashëm me investimi që bëri tek ish-marteniteti, me investimin që bëri tek Rruga e Shijes, duke marrë pronën e shkollës të Polenës?

Ky Fond merr pronë publike, investon me para publike nga fondi shtetit dhe hyn në treg si tregëtar dhe normalisht që kryen konkurrencen konkurrencë të pandershme për sa kohë që 0rdo gjë e përfiton publike dhe hyn në treg me konkurrence. Doja të thoja se duhet pasur kujdes nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit sepse është një skemë abuzive dhe shumë shpejt do i dalë tymit dhe kësaj. Dhe dyta qëndra e informacionit që do bëhet para Katedrales, keni ndonjë sqarim për të na dhënë sepse për mendimin tim sheshi boll është prekur e mira është mos preket më, duhen pyetur qytetarët.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Roli i Bashkisë tek Poli i Dijas jemi dhe Liceu e para jemi institucioni që menaxhon qytetin dhe jemi përfituesit kryesorë të këtyre projekteve dhe nuk e kuptoj fare këtë të zbojmë këta që financojnë se po na marrin pronën dhe po e përdorin për projekte me përfitim

të komunitetit. Në rastin e Polit të Dijes nga ato që kemi diskutuar Bashkia do jetë pjesë e entitetit që do menaxhojë Polin e Dijes do ketë një entitet në trajtën e një fondacioni, enti nuk e kemi caktuar emrin do ketë disa aktorë brenda dhe njëri prej tyre do jetë Bashkia. Në pjesën e investimeve nuk na është kërkuar të bashkëfinancojmë. Në pjesën e projekteve zhvillimore që do ndodhin atje ne do jemi të hapur të përfshihemi aq sa ana kërkohej sepse është një nga projektet më të rëndësishme jo vetëm të zhvillimit por edhe të të ardhmes të qytetit, sepse lidhet me edukim cilësor, mbajtjen e të rinjëve këtu. Në lidhje me Liceun janë disa aktorë është Qeveria Shqipëria e cila nëpërmjet Fondit Shqiptar të Zhvillimit do bëjë investimin në infrastrukturë, do jetë përsëri Qeveria Shqipëria nëpërmjet Ministrisë të Arsimit mendoj unë që do bëjë edhe mbështetjen për të funksionuar si institucion arsimor sepse do ketë shumë kosto dhe angazhimet do i ketë shteti meqenëse është shkollë publike. Çfarë do jetë pjesa e Bashkisë do ju propozoj ta mbështetim me të dyja duart, janë dy projektet më të rëndësishme. Përsa i takon Fondit Shqiptar të Zhvillimit ai nuk është një entitet privat që na mori pronat edhe burimet edhe iku dhe po fiton për llogaritë e tij, është një institucion publik që ka detyrë të investojë në projekte në funksion të zhvillimit të komuniteteve, rajoneve, Bashkive, sektorëve të caktuar duke pasur parasysh edhe kostot ekonomike. Ai është fond publik, tani se çfarë mund t'i dalë tymi ok do flasim, tymi ju doli edhe këtyre partive të reja, hajde rrimë tek këto që na ka votur populli, po të hymë në tymi do na zerë viti I ri. Për zyrën e informacionit turistik, kemi bërë një projekt ndërtimi për zyrën tek sheshi, në pjesën ekstreme djathtas kur je përballë Katedrales, ai projekt do ndërtojë edhe infrastrukturën politike që është e nevojshme besoj por edhe do përmbyllë edhe projektin e sheshit sepse ka elementë të ngjashëm edhe me godinën e Bibliotekës të Re edhe do krijojë një Ansambël shumë interesant tek sheshi.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Fjala për diskutime.

Këshilltar E.Bregu: Nuk mora përgjigje për disa pyetje.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Pastaj ta jap edhe vazhdoni.

Këshilltar E.Bregu: Po bëhesh e bezdishme, është e 7 herë që po kërkoj fjalën për pyetje dhe kështu u dakortësuam.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Me rradhë se ka kërkuar z.Bode fjalën.

Sekretare e Këshillit E.Naçi: Të them diçka për procedure, kryetari i pakicës flet i parafundit dhe mbyll debatin kurse kryetari i grupit politik të shumicës flet i fundit dhe duhet të mbyllë debatin politik për atë forcë politike.

Këshilltar D.Osmani: Meqenëse jemi në kuadrin e diskutimeve.

Këshilltar E.Bregu: Jo se kemi pyetje.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Keni pyetje të tjera?

Këshilltar E.Bregu: Ne u dakortësuam që do bëja pyetje kur të mbaronte kryetari fjalinë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Dakort.

Këshilltar E.Bregu: Pyetja ime është duke qënë se pagat zënë pjesën më të madhe të shpenzimeve dhe pjesa më e madhe vjen nga Qeveria, a mos ndoshta Bashkia Korçë ka humbur

autonominë sepse është e varur nga shumë vendime të Qeverisë dhe për këtë pyetje nuk mora asnjë përgjigje. Për shtresat në nevojë ne kemi diskutuar dhe an është thënë që kështu është ligji por i jemi drejtuar institucioneve përkatëse me kërkesa për ndryshime. A kemi ndonjë ndryshim për këtë?

Sepse unë e di si është ligji nuk dua shpjegime për ligjin.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Këtë pyetje e diskutuam edhe herën e parë, prapë do i rikthehemi?

Këshilltar E.Bregu: Të lutem mos më ndërprit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ne nuk mund të dëgjojmë gjëra të përsëritura.

Këshilltar E.Bregu: Të lutem mos më ndërprit, kush je ti që më ndërpret fjalën?

Je bërë si pronare e Këshillit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Jo nuk jam pronare, jam një nga ju por nuk mund të dëgjojmë të njëjtat gjëra.

Këshilltar E.Bregu: Mos e ngri zërin, e lamë do bënim pyetjet, pse acarohesh?

Më ler të flas dhe respekto procedurat, kur flet tjetri mos e ndërprit.

E treta në lidhje me masat që Bashkia ka marrë duke pasur parasysh që ka hyrë në kultivimin e mollës për orgaznimin e disa linjave paketim dhe orientim drejt tregut, në këtë pike është një ide që më pëlqen por duke pasur parasysh që do bëjë edhe prodhim nuk mund të bëj komente në lidhje me konkurrencën. Meqënëse Bashkia do kontribuojë për paketim dhe organizimin e tregut a do jenë pjesëmarrës në vendim bashkë me fermerët e zonës, kush do i marrë vendimet me orgaznimin dhe tregëtimin e produkteve të përbashkëta?

Pres 3 përgjigje.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: Buxheti siç e thashë ka dy burime financimi, të ardhurat që i krijojmë vetë dhe të ardhurat që vijnë nga Qeveria qëndrore, por kjo nuk e bën marrëdhënien tonë marrëdhënie varësie, kjo është marrëdhënie ligjore. Qeveria e ka detyrim të mbështesë institucionet vendore dhe këtë detyrim e ka të parashikuar edhe në buxhetin e saj afatmesëm, nuk jemi në kushtet i pëlqejmë ne na i jep, nuk i pëlqeen nuk na i jep, e ka detyrim ligjor edhe në transfertën e pakushtëzuar duke u bazuar tek parametrat e popullsisë, edhe në transfertën e pa kushtëzuar sektoriale shërbimi zjarrfikës, rrugët rurale, arsimi parashkollor, kjo mbështetje vetë mund të rritet nga viti në vit, nuk mund të ulet dhe nuk besoj që duhet të bëhemi me forcat e veta sipas asaj parullës, Qeveria e ka detyrim dhe po e zbaton më mirë seç duhet madje sepse po të krahasosh buxhetin që na është alokuar me transfertën e pakushtëzuar krahasuar me buxhetin afat mesëm që Qeveria ka pasur është më i lartë buxheti që na ka dhënë. Në lidhje me ndihmën ekonomike, nuk është roli i Bashkisë të caktojë masën e ndihmës ekonomike, patjetër që sa herë ne jemi në vende që mund ta themi këtë fjalë i ngremë shqetësimet apo japim një pasqyrë të gjendjes në Bashki. Përsa i takon orgaznimit të fermës të mollëve, nuk kemi një vendimarrje finale si do organizohet, do jetë një Sha, apo formë tjetër dhe kush do jenë % e pjesëmarrjes të palëve, ne jemi të hapur ndaj çdo propozimi që do jape Fondi dhe besoj se Bashkia do jetë përfaqësues i këtij komuniteti, nuk është caktuar ende.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, fjala për z.Osmani.

Këshilltar D.Osmani: Faleminderit, tek ky bxuhet shoh një material copy-paste si çdo vit tjetër të paktën këto vite që jam këshilltar dhe ndryshojnë vetëm shifrat, por edhe shifrat e reja nuk ka diçka të mirë për qytetin, ka vetëm për adminsitratën sepse do vazhdojë të shtojë lekët pas dy dekadash të menaxhimit të kësaj Bashkie. Po marr shembull strukturën dhe po bëj analizën e strukturës dhe ne na rezulton se Bashkia Korçë nuk e orienton atë në mënyrë të balancuar në përdorimin e fondeve publike me nevojat e qytetarëve. Nevojat reale janë më shumë se ato për punësime në administratë dhe aktivitetet me ndikim të kufizuar zënë pjesën më të madhe, po të shohim investimet e drejt për drejta në këtë planifikim janë vetëm 14 %, në një kohë ku mesa mbaj mend nga buxheti i vitit 2025 ishin 17 %, vazhdojnë ulen. Nëse shikon analizën me shifra është akoma më pak shkon tek 10 %, në realizmin e 11 mujorit ku shpenzimet e personelit shkojnë në vlera 953 milion lekë, në një kohë kur investimet janë kryer 90 milion lekë dhe kjo qasje tregon një shkëputje midis buxhetit dhe interesit publik, në këto kushte qytetarët nuk marrin shërbimin e duhur nga taksat dhe tarifat që paguajnë dhe në këto kushte unë i sygjeroj ekzekutivit të ulë shpenzimet të cilat nuk janë për investime por për shërbime jo productive por të merret me qytetinn, të zhvillojë atë sepse e pranojnë dhe vetë ka një rënie drastike të numrit të popullsisë sepse të kesh 1300 punojës dhe sipas instat 60 mijë qytetarë që jetojnë dhe kjo 60 duhet parë dhe ju mund ta gjeni sepse Bashkia Korçë ka një ujësjellës që ka gjithë databazën që paguajnë ujin dhe nuk besoj se janë më shumë se 17 mijë e 500 familje që paguajnë në qytet mesa informacion kam. Nga këndvështrimi im fiannciar publik ky model shpenzimi është jo efikas dhe i paqëndrueshëm, Bashkia na sillet si konsumator fondesh dhe jo si menaxher për të bërë këto investime dhe ne po vazhdojmë nga viti në vit të kryejmë të njëjtin shpenzim, të mbajmë veten dhe të harrojmë qytetarët, këtë shoh edhe tek ky buxhet. Përsa i përket bashkëpunimit me Fondin Shqiptar të Zhvillimit në lidhje me fermën e mollës, nga fjala e kryetarit kishte diçka që i shkau apo nuk e di por e tha që kjo fermë po ngrihet për mos krijuar fitime, që në momentin që ne themi do krijojmë një biznes konkurent me biznesin aktual por nuk do krijojmë fitim do të thotë që ju do të kini një biznes shtetëror i cili do shesë në kosto dhe që një biznes mund të shesë në kosto këtë mund ta bëjë vetëm bashkia me fonde që nuk i ka të sajat por i merr nga taksat, bëjmë një bilanc dhe nëse ne nuk shesim me efektiv.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar D.Osmani: Ti e the dhe ndoshta ne tani nuk kemi kohë ta kthejmë mbrapsht por ti e the dhe nuk është spekulim ta siguroj, e kishe lapsus apo jo por nuk dua të krijojë fitim dhe në këtë moment o do rritësh shpenzimet o do shesësh me kosto, unë do isha shumë dakort ne e kemi diskutuar dhe më parë për ndihmën e fermerëve por nuk e di me çfarë fermerë dhe specialistësh këshillohesh në fushën e prodhimit të mollës por të prodhosh sot me 30 hektarë në një treg i cili sa vjen dhe ulet dhe konkurenca është e madhe, ne kemi Italinë, Maqedonin, Greqinë që i kemi vende afër të cilat prodhojnë si ne dhe ato kanë mbështetje nga Bashkitë me grande, subvencionim, por të shtosh kapacitetin e prodhimit pa provuar njëherë me ato që ke, të mendosh për ta magazinua, paketuar për t'i kryer gjitha shërbimet e duhura për ta bërë të denjë dhe për ta çuar për eksport deri këtu do e mbështesja nismën që keni marrë por ju po e ndërtoni edhe fermën kjo nuk e di se ku do ju çojë, por 1 gjë është e sigurt nga përvoja ime nuk ka për të funksionuar jo se nuk dua të funksionojë, por tek një fermë mole të gjithë e dimë se do përkushtim çdo ditë dhe kjo nuk bëhet as nga Bashkia apo punojësit e saj dhe e funit ju thatë se

ne po e bëjmë këtë investim por nuk kemi menduar si do e menaxhojmë dhe kjo duhet të ishte gjëja kryesore në projektin e kësaj ferme duhet të mendonit si do menaxhohej një investim kaq I madh sepse mesa di unë investimi aktual është 2.5 milion euro dhe do shkojë deri në 5 milion euro në total , mund ta kem edhe gabim, të bësh një plan biznesi me këto fonde dhe mos kesh menduar si do e menaxhosh dhe nga kush do menaxhohet, nuk më duket e drejtë. Meqënëse jemi në këto faza do sygjeroja të gjendet si do menaxhohet sepse për të ndërtuar ok, janë gjetur fondet, siç e tha dhe këshilltari Pllaha do i shohim edhe ato fonde do ju dalë tymi. Por pyetja është si do e menaxhoni, apo ta bëjmë njëherë të shohim si do shkojë, çdo bëjmë me ato fondet dhe pastaj shishe vere ka, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit dhe që respektuat dhe orarin e diskutimit. Kush e do fjalën përsëri?

Këshilltari M.Qelesi: Sipas hyrjes të materialit të buxhetit, shkruar nga kryetari i Bashkisë, përmendeshe prioritete, zhvillimi ekonomik, infrastruktura, shërbime, arti, kultura dhe gjitha këto drejtime po citoj sërish kryetarin ndërthuren në një buxhet të hartuar me përgjegjshmëri dhe vizion të qartë. Në fakt buxheti kryetar është një akt politik që reflekton politikën e një Bashkie si instrument kryesor ekonomik të kësaj Bashkie. Në përgjigje të hyrjes të bukur do thoja, kemi para një buxhet shumë të diskutuar i ngritur mbi bazën e një pakete fiskale të shtrenjtë për xhepat e qytetarëve dhe nuk mund të flasësh për efikasitet duke parë trendin kryesor të menaxhimit të buxhetit të kësaj Bashkie i cili nuk është veçse shpopullim në nivele të frikshme, % e lartë e shpenzimeve të personelit në buxhet sepse gjysma e buxhetit shkon për shpenzime për paga, buxheti i varur nga transferta për shpenzimet, të ardhurat e veta të përcaktuar në trend historik 10-vjeçar , 65 % , të ardhurat e veta të varura nga lejet e ndërtimit, përdorimi i të ardhurave të veta vetëm për paga dhe sigurime në vlera absolute dhe investime të përcaktuar, një realizim 35 % duke futur edhe të ardhurat e trashëguara në një trend historik 10-vjeçar. Që të bësh një hyrje kaq të bukur se Korça do jetë Qytet Europian i Sportit më mirë të nënshkruhej atje se Korça është zyrtarisht qytet i plakur, mbyllen shkolla dhe hapen azile dhe ky është një nga premtimet tuaja elektorale të pa mbajtura dhe keni bërë disheqë numrit të popullsisë në këto vite. Në këtë material nuk përmendet numri i popullsisë që është një nga elementët bazë për planifikim. Bashkia është në top listën e Republikës për uljen e numrit të familjeve të cilat kanë ndikuar edhe në planifikimin e të ardhurave për tarifën, në shtresën negative të popullsisë, janë statistikën në Instat ku është numri i vdekjeve më i madh se i lindjeve dhe emigracioni masiv. Korça së bashku me doktor Bashkia dhe 7 njësitë Administrative nga 1300 mijë që thotë ju se është numri i gjendjes civile ose statistika e marrë në institutin e Bashkisë, me këto shifra ka hyrë në kategori tjetër rëndësie, shpopullimi masiv i juglindjes është pasojë e stacioni ekonomik dhe varfërisë ekonomike. Ndërsa buxheti progresiv nga 2016 ka qënë 1.6 milion lekë, sot ka shkuar 2.6 do të thotë nëse buxheti është rritur 1 miliardë lekë për 10 vite, shpopullimi ka krahun e kundërt dhe nuk korrespondon rritja e buxhetit me kaq shumë lekë me numrin e popullsisë në shifrat që dhamë. Gjithashtu ky buxhet nuk realizohet 100 %, nuk merret shërbimi investime + shpenzime korrente kundrejt pagesave të qytetarëve por realizohen vetëm shpenzimet e personelit. Nga të ardhurat mesa shohim nga shifrat shohim se Bashkia në trend 10-vjeçari i realizon mesatarisht 65 %. Si ka mundësi të bësh planifikime qoftë edhe për 2026 kur me këtë realizim ke dështuar mbledhjen e të ardhurave, ke dhënë thjesht për të barazuar të ardhurat me shpenzimet apo ke planifikuar gabim? Ajo që shihet është se janë pikërisht taksat vendore që

përballojnë peshën specifike më të madhe por janë edhe ato që kanë mos realizimet më të mëdha. Vlera e të ardhurave nga taksa dhe tarifat është barazim me 1.2 miliardë lekë ndërkohë shpenzimet e personelit po flas në vlerë absolute gjithmonë nuk kanë rëndësi burimet e financimit edhe ato janë taksat e qytetarëve të tjerë të qarqeve, shpenzimet e personelit janë 1.28 miliardë lekë, të ardhurat nga taksat dhe tarifat janë 1.2 miliardë lekë. Gjithë fondin që mbledh Bashkia të planifikuar po flas duhen edhe disa lekë të tjera 0.008 miliardë lekë i përdor vetëm për shpenzime personeli. T'i marrësh kësaj parasysh edhe koeficientin 65 % që realizohet në trend historik, i bie që të realizohet kjo paga dhe sigurime duhet të shtosh edhe një 500 milion lekë që të përballosh shpenzimet e personelit. Me këto shifra mbetesh e varur nga transferat për të realizuar shpenzimet. Nga struktura e të ardhurave, taksa e ndërtimit të reja rritet me 190.5 milion lekë pra 66 % të rritjes të taksave e përballon vetëm kjo lloj takse, kemi një rritje të volumit të ndërtimit dhe Bashkia e varur nga lejet e ndërtimit dhe që të kesh një rritje kaq të madhe të volumit të ndërtimit i bie të kesh një rritje ekonomike, simund të jetë kjo rritje ekonomike në bazë të shifrave që planifikoni dhe ky është trend 10-vjeçar kur euro ka zënë kufijtë minimale, ku çmimet janë rritur, kur inflacioni ka vlera shumë të konsiderueshme sepse duhen shumë para për të blerë diçka tani, ekonomia është e ulët, bilanci negativ të subjekteve, mbyllje biznesesh, kredi që jepet gjithmonë e më pak, qarkullim para cash më shumë sesa në banka dhe shpopullim të frikshëm të të rinjve që janë në fuqi punëtore. Si mund të planifikosh këtë rritje të ndërtimit të reja që rrjedhojë ka zhvillimin ekonomik kur tik e këtë rënie ekonomike, me logjike ekonomike i bie pastrim parash nuk po aludoj por me logjike ekonomike sepse ku gjenden gjithë këto kushte ekonomike. Apo formalisht duhen barazuar të ardhurat dhe shpenzimet dhe hajde vemë një shifër aty. Një trend i kësaj Bashkie planifikimi i gjobave nuk e di, nuk mund ta gjykoj dot, përjashtoj detyrimet e prapambetura dhe nga sqarimet në komision, planifikohen gjoba. Nuk e di kjo drejtoria e shfrytëzimit të territorit ose institucionet vartëse, si mund të planifikosh gjoba për mua ke dështuar si Bashkia nëse planifikon gjoba, vjelja e këtyre të ardhurave është masë repressive për qytetarët siç e shpejguam edhe në pyetjet që morëm përgjigje që mora. Nuk ka një plan për zënie e hapësirës publike që do ishte shumë e rëndësishme sepse është 1 e ardhurur e rëndësishme në buxhet, sipas shpjegimit në komision kjo bëhet me ditë është rekomandim i lënë nga KLSH. Ndërkohë që Korça shpopullohet shpenzimet e personelit rriten dhe për 2026 këto zënë 49 % të totalit dhe siç thamë përballohet nga të ardhurat e veta, nëse shohim një trend historik shpenzimet e personelit kanë filluar me 357 milion lekë dhe sot janë 1.285 miliardë lekë, nuk është vetëm indeksimi i pagave por edhe rritja e numrit të punojësve dhe po të vesh re rritjen e shpenzimeve të personelit në vitet elektorale kemi vlerën më të lartë. Rritja e numrit të punojësve po të bësh një statistikë sipas Bashkisë dhe institucioneve të varësisë ka rritje në periudhën elektorale, Efekti i reformës teritoriale sepse prandaj e mora në një situatë dhe trend 10-vjeçar për të parë efektin e reformës teritoriale ku ju presupozuat se do ulet numri i punojësve, është rritja e numrit të punojësve të paktën me një diferencë 331 deri tani. Nuk sqarohemi gjithashtu në buxhet për raportin sesa një punojës Bashkie i shërben numrit të banorëve nëse marrim numrin e Censurit 60,724 dhe e pjestojmë me numrin 1342 që është plani i punojësve i bie se një punojës ju shërben 45 banorëve, ku para reformës teritoriale një punojës ju shërbente 300 banorëve, nëse këtij numri i shtojmë edhe numrin e punojësve të ujësjellësit, ky numër shkon 1 mw 30, nëse i shtojmë edhe koeficientin e dixhitalizimit ku prezupozohet të ulet numri, i bie një punojës ju përgjigjet 15 banorëve, ky ka qënë trendi 10-vjeçar, shpopullimi dhe rritja e numrit të punojësve. Në lidhje me shpenzimet

korrente dhe këto zenë % të konsiderueshme të totalit të buxhetit, ku vend të konsiderueshëm zë programi i mbrojtjes të mjedisit më i madh se 207 milion lekë, brenda shpenzimeve korrente një vlerë e konsiderueshme me TVSH është 153 milion, shpenzimet e pastrimit, në kontartën e subjektit që bën pastrimin futet edhe evadimi i bores në stinën e dimrit gjë që nuk bëhet në kalldrëme sepse kalldrëmët janë bërë me një lloj materiali që shkrihet. Domethënë merre 153 milion lekë dhe këto minimalisht nuk pastrojnë kalldrëmet ku thyjnë kokën njerëzit, nuk sqarohemi për koston për ton, nga materialet që kam lexuar sepse ka një metodologji unë nuk kam informacion, kam hulumtuar në internet, kostoja në ditë 80 ton në ditë dhe në vit i bie 29 mijë e 200 ton, me këtë fonde pastrimi i bie që kosto për ton të shkojë 5 mijë e 200 39 lekë më e lartë sesa Tirana, domethënë ne për rekorde o për shpopullim o për shpenzime mbajmë kampion. Ta kesh koston e pastrimit për ton kur distancat i ke më të shkurtra, kur sasia e evaduar është më e vogël, kur popullsia është zvogëluar, atëherë unë nuk e di, nuk ka shpjegim ekonomik. Të ardhurat nga taksa sidomos e pastrim, gjelbërimit, paguhen për familje dhe nga subjektet ekonomike sipas kulturës të vlerës të xhiros që bëjnë. Ta marrësh barazim tarifën sin e periferi dhe shërbimin ta japësh pothuajse në qendër, sa del në Unazë minimalisht lumi e shumë të tjera, domethënë të ardhurat i vini në mënyrë të barabartë nga subjektet dhe familjet dhe shërbimin nuk e jepni njësoj në qendër dhe periferi. Përsa i përket ndotjes të ajrit ishalla bëjmë gazifikimin dhe të evidentojmë ndotjen meqënëse e kemi edhe të freskët nga java e kaluar. Shërbimet e karburantit zenë vlerën 53 milion lekë, ku vlera e konsiderueshme është Bashkia dhe NSHP sipas specifikës të punës. Nuk kemi një normative konsumi për karburantin unë e kërkoja në komision më thanë do e sjellin, nuk mund ta gjykoj. Te kemi një normative të dimë konsumin e makinave, karburantin sepse është zë i rëndësishëm në buxhet.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Kaloj koha.

Këshilltare M.Qeleshi: Ta mbaroj. Investimet do mbahen mend si mos realizim shpenzimesh, në vitet 35 %, % e ulët në total buxheti. Ka ulje të 2025 për investime me 2026, 46.4 milion lekë, realizimi i pritshëm është vetëm 46 % dhe ato që planifikohen nuk përkthehen në shërbime për njerëzit. Sa i takon buxhetit duhet të jetë kapital dhe jo operativ por këtu janë shifrat e përmbysura. Nëse marrim investimet 14% që zë plani i 2026 i bie në 100 lekë që paguan një qytetar apo subjekt 14 lekë të të kthehen ty në investime dhe 86 lekë shkojnë për paga sigurime, vetëm 14 lekë merr ti si qytetar që paguan, t'i futësh këtij 14 lekshit dhe koeficientin e korupsionit ai nuk merr as 10 %, nuk del sinergjia e investimeve apo projektet kapitale, nuk sqarohen si identifikohen, kriteret, burimet financiare, cilat janë disa nga zgjedhjet e propozuara, pse është i nevojshëm ky investim, a adresohen nevojat e grupeve vulnerabël. Tek kriteret e përgjedhjes nuk sqarohemi për numrin e përfituesve apo zona që përfiton, ndikimi në ekonominë vendore, shkalla e emergjencës të projektit dhe të ardhurat që do rigjenerojë ky projekt, nuk kemi të paktën një analizë projekti. Emërtimet e projektit dihet që vihen me emra inteligjente edhe kjo është thjesht propagandë. Sa i takon festave, dihet se struktura e festave kalon në favor të Festës të Birrës ku e keni filluar me 1 milion lekë, e përfundoni me 15 milion lekë vjet dhe 12 këtë vit. Nuk është inflacioni i birrës, nuk e di çfarë vlera të konsiderueshme do paguajnë qytetarët për këtë festë kur mund të bëheshin festa për autizmin, jetimët, grate në nevojë, emergjencat. Turizmi në Korçë ka rënë duke filluar që nga Pazari dhe turizmi matet jo me numrin e turistëve por me të ardhurat që arkëtohen, nuk kemi saktistikë publike sa janë të ardhurat e turizmit, nuk dimë auticitetin e turizmit, sa janë angazhuar fermerët e fshatit me produktet e tyre në funksion

të turizmit, duke ditur që sektori buqësor është në depression total, duke ditur se përdoren mallrat ë importuara dhe një turist kërkon auticitetin e pjatës. Nuk mund të flasim për turizëm efikas, ka rënë vetëm me këto dy elementë kryesorë buqësia dhe mallrat e importit që përdoren për të shitur pjatat. Numri i bujtinave problem shumë i madh.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem përfundoni.

Këshilltare M.Qeleshi: E fundit, numri i bujtinave është fenomen shumë i rëndësishëm që e kanë dhe subjektet ekonomike, u stimuluan lejat e ndërtimit vetëm për bujtinat, aq numër bujtinash u rritën sa gjithë ata që kanë marrë edhe kredinë edhe qira, i kanë mbyllur ose kanë lidhur kokën me shami sepse dhënia e lejave për turizëm të zhvilluar dhe mbylljen e tyre sepse nuk kanë leje qëndrore nga turistët, kanë shumë pak, për ata që kanë marrë kredi ose me qera për mua janë piramidat e 97-tës. Lekun që kishin marrë e vunë për të ndërtuar bujtina dhe sot nuk përkthehet në vlerë ekonomike. Uroj që ato rekomandimet e KLSH-së sipas komisionit janë marrë parasysh në material, uroj që ky buxhet mos zbatohet me tendera, me flamur të kuq ku Korça është në top-listë, viti 2021-2023 pa baraza tenderash, keni tenderuar 598 milion, kurse si teze mujore janë prokuruar 970 milion lekë me këtë procedurë, kjo është shkelje barazish të tenderave, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Z.Bode keni kërkuar fjalën për diskutim më parë dhe ja latë fjalën z.Osmani, fjala për ju.

Këshilltar I.Bode: Atëherë ky projekt tbuxhet paraqitet me gjuhë ineteresante dhe plot vizione për zhvillime ekonomike, turizëm, inovacion, arsim elitar apo edhe mirëqënie sociale. Pas kësaj retorike optimiste qëndron një e vërtetë që mua më duket krejt tjetër, ky është një buxhet që mban gjallë administratën por jo buxhetin, 2.6 miliardë lekë si viti I kaluar, gjysmat shkojnë për paga, 37 % për shpenzime dhe 14 % për investime, ka një rritje nga vjet por shuma totale e kësaj mbetet simbolike. Përsëri këtë vit prioriteti i Bashkisë nuk është zhvillimi por status kuoja. Rritja e shpenzimeve të personelit justifikohet me rritjen e pagës minimale, por nga ana tjetër ju nuk keni bërë një reformë strukturore sepse askush nuk është kundër rritjes të pagave, por nuk mund të mbahet një aparat administrativ pa u thelluar fare në një analizë mbi ekskluzivitetin që ka kjo administratë, mbi popullimin e saj apo qoftë edhe eficiencën e shërbimit ndaj qytetarëve, ne kemi vite që ja u kemi vënë në dukje që kemi një administratë jo eficiente dhe kjo nuk ka shqetësuar njeri, arsyet i kam të kuptueshme sepse duhet një administratë që do përdoret në vitet elektorale, buxheti na ofon një administratë më të shtrenjtë dhe jo një administratë me cilësi më të mirë, kjo nuk është interpretim politik por fakt numerik. Në programin e zhvillimit ekonomik, ku janë paratë për këtë zhvillim, me vetëm 14 % të buxhetit do bëjmë zhvillim, do përmirsojmë infrastrukturën, zhvillimi ekonomik kërkon investime të forta, jo festa me lakror e birra. U projektua Korça si një qytet tavernash dhe festash por festa mbyllet në orën 12, përveç ndonjë lokali të privilegjuar dhe kjo bëhet me shfaqje të shëmtuara me makina policie që shkojnë në derën e çdo lokali dhe atëherë kur festa ndizet ajo mbyllet. Atëherë çdo bëjë një turist në një qytet ku nuk mund të festojë, e thjeshtë nuk vjen fare. Të gjitha projektet janë me ndikim të përkohshëm evente, aktivitete promovuese dhe nuk ka një analizë sa ka qënë përfitimi real, pak a shumë e marr parasysh përgjigje. Shtyllat e zhvillimit ekonomik në këtë program për mua janë hamë një lakros, pimë një birrë hedhim valle deri në 12 dhe pastaj shkojmë flemë. Të ardhurat janë të bazuara në dy shtylla, në transferta e pakushtëzuar nga buxheti i shtetit që ju e përdorni të

gjithin për paga dhe nga të ardhurat tona është ajo që ndikon më shumë është taksa e ndërtimit në infrastrukturë për ndërtimet e reja dhe sipas meje do të thotë që Bashkia nuk ka një autonomi reale financiare por buxhet varet nga një sektor i paqëndrueshëm siç është ndërtimi, dhe nëse nesër Kryeministri merr masa dhe ndalon ndërtimet ose dhe nëse ky sektor ngadalësohet i gjithë buxheti është në rrezik dhe ky nuk është planifikim i përgjithshëm. Të planifikosh me optimizëm dhe të mbështetesh tek këto dy shtylla, realizimi 11- muor i 2025 është më i ulët sesa plani dhe prandaj thashë më sipër këto janë zëra ciklike dhe të varaura shumë nga një treg i vetëm, ju e merrni të mirëqënë se ka një dinamikë konstante sektori i ndërtimit por kjo për mua është e rrezikshme. Nga ana tjetër paqaja e famshme fiskale pranohet në document por ul potencialin e të ardhurave dhe megjithatë nuk mund të shoh tek ky dokument sesa do jetë humbja dhe sesi do kompesohet. Në programet për arsimin bazë dhe parashkollor që në letër paraqitet si dokument strategjik dhe investim për të ardhmen. Ajo që unë shikoj është se vlera totale 540 milion lekë nga të cilat pjesa dërmuese patjetër do shkojë për paga dhe shpenzime korente dhe funksionim administrative. Ajo që mbetet për investime janë vetëm 46 milion lekë, me këto planifikime arsimit trajtohet si kosto. Me 46 milion lekë investime nuk mund të rinovosh seriozisht shkolla apo të modernizosh çerdhe, kopështe. Në një Bashki që flet për qytet univeristar, arsim bashkëkohor ky nivel investimesh është hendek i thellë mes këtyre që themi dhe ajo që shohim tek buxheti. Arsimit parashikollor financohen vetëm për mbijetesë, mungojnë investimet për ambiente, siguri qoftë edhe lodra educative, fëmijët e vegjël trajtohen si zë shpenzimi jo prioritet. Meqë po flasim për investime në shkolla si ka mundësi që gjithmonë që keni bërë një rikonstruksion e keni bërë gjithmonë në zhvillimin e mësimi duke shkaktuar kaos edhe në 3 shkolla për shpërndarjen e fëmijëve. Me që kaloj gjithmonë tek shkolla Sotir Gura të mbulosh një mur të ndërtuar me gurë me një suva të trashë e të shpifur nuk e di kujt i ka shkuar ndërmend. Ky program nuk ofron arsim cilësor por administron një buxhet minimal dhe nuk e trajton as si prioritet por si barrë. Në lidhje me buqësinë nuk ka asnjë program megjithëse Korça konsiderohet vend me potencial buqësor, nuk konsiderohet fare si bosht zhvillimi dhe kjo tregon qartë se nuk ka ndonjë vizon të qartë ka vetëm mirëmbajtje rrugësh rurale që jo domosdoshmërisht janë të lidhura direkt me buqësinë, shërbime teritoriale, shërbime bazë, nuk shoh asnjë linjë direkte që këto para të kthehen tek fermerët në formë mbështetje, shihet vetëm si burim të ardhurash. Të nderuar këshilltar tek të gjitha programet vura re të njëjtin fenomen shpenzime për rroga, shpenzime korrente dhe u përqëndrova tek ato që shoh si më të rëndësishmet edhe sipas këtij dokumenti. Ky buxhet është konceptuar si një buxhet që vetëm sa mbijeton jo si një buxhet që transformon. Korça nuk ka nevojë për një Bashki që vetëfinancohet sa për të marrë rrogat e veta por për një Bashki që investon në ekonomi dhe qytetarët. Ky buxhet siguron qetësinë e administratës, një status kuo sepse është hartuar me mentalitet dembeli dhe pa ide. Konstatoj me keqardhje se të njëjtat fjalë kam përdorur edhe vjet për buxhetin dhe përsëri janë të vlefshme. Ky mekanizëm mirëmbajtje që na serviret si buxhet. Mban të pajisur thjesht ingranazhet e një bashkie që tashmë po vyshket dhe nuk garanton performance.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem përfundoni.

Këshilltar I.Bode: Fjalja e fundit. Ky buxhet duhet rishikuar rrënjësisht prrënjësisht për mua ose nuk meriton të miratohet.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Z.Bregu, më pas znj.Dinellari.

Këshilltar E.Bregu: Nuk dua të bien ë përsëritje, ajo që shihet shumë qartë është se tabelat janë përgatitur bukur por kjo nuk është e mjaftueshme, buxheti duhet të jetë real dhe ne këtu e diskutuam dhe ramë dakort se ky buxhet nuk ka asgjë reale është i gjithi fiktiv, duke nisur që nga realizimet që arrijnë 60 % dhe ne këtë lloj diskutimi kemi 3 vjet rresht që e bëjmë që realizimi nuk kryhet dhe shpjegimet e dhëna janë se ky buxhet është përgatitur në bazë të këtij ligji, duke pasur parasysh këtë apo atë bazë, por asnjëherë mbi bazën reale. Për këtë arsye megjithë këtë fiktivizëm që ka ky buxhet asnjë këshilltar nuk duhet ta pranojë dhe ta marrë parasysh për ta miratuar. Nuk e kam fjalën vetëm për këshilltarët e opozitës por edhe ata të pozitës t'i thëresin mendjes dhe të thonë pse na sjellin çdo vit të njëjtën gjë, skarcitet. Kjo duhet të shqetësojë gjithë këshilltarët sepse qartësisht duket se buxheti hartohet për mbajtjen e pushtetit jo në shërbim të qytetarëve dhe kryetari i Bashkisë gjithmonë me administratën e ti duket shumë qartë që prej vitesh i shërben vetëm mbajtjes të pushtetit me çdo kusht, duke trajtuar veten si pronar dhe jo si menaxher në funksion të qytetarëve, ndaj gjithë këto vite është e turpeshme t'ju kërkohej këshilltarëve të miratojnë këtë buxhet. Nëse ky buxhet nuk ndryshohet rrënjësisht nuk duhet të kalojë. Së pari do i bëja thirrje kryetarit të Bashkisë ta tërheqë buxhetin, ta ribëjë dhe ta sjellë përsëri, mbi bazën reale, jo mbi bazën e gënjeshtreve të verifikuara deri tani, nuk mund të përgatitet ky buxhet me këto shifra të falsifikuara.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Fjala për znj.Dinellari, pregatitet z.Pllaha.

Këshilltare S.Dinellari: Kuptohet që domosdoshmëria e miratimit të buxhetit ju shërben jo vetëm institucionit të Bashkisë por edhe qytetarëve dhe ne bihem dakort si përfaqësues të tyre. Qëllimi i hartimit të një projekt buxheti është të kuptohet si ne kemi realizuar ato që kemi parashikuar vitin e shkuar. Projekt buxheti duhet të shoqërohet me raporte specifike për realizimin e gjitha programeve të Bashkisë gjë që mungon çdo viti. I mëshoj këtij fakti sepse më vjen shumë mirë që njëra nga objektivat e Bashkisë është rritja e përgjegjshmërisë dhe transparencës të Bashkisë në përmbushjen e angazhimeve për barazinë gjinore dhe ky fakt nuk duhet mohur por duhet vlerësuar nga ana e Bashkisë realizimin e faktit për barazinë gjinore dhe rritja e pjesëmarrjes për vendimmarrje në nivelin vendor për gratë në diversitetin e tyre. Këtë vit kemi rritje të investimeve sepse kjo evidentohet edhe në rritejn e shpenzimeve të cilat i adresohen këtyre programeve. Do ndalesha në disa programe për shkak të rëndësisë dhe zbatimit të tyre në objektivat që i janë vendosur Bashkisë në realizimin e tyre. Programi për zhvillimin ekonomik është testuar vitet e kaluara 1 aktivitet, kopshtet komunitare tek Parku Japonez dhe nuk ka patur rezultat pozitiv dhe nuk e di pse rikthehet sërish. Ka aspekte pozitive në trajtimin e aktiviteteve në këndvështrimin e Bashkisë siç është Festivali i Serenatës dhe ai mbetet po i njëjtë. Unë gjykoj si qytet që identifikohemi me këtë aktivitetet të ketë tjetër buxhet dhe jo të jetë i dyfishuar buxheti për aktivitetin tjetër Fly Korça. Në lidhje me programin e mbrotjes të mjedisit vihet re se kemi përgjysmim të investimeve nga viti i kaluar duhet të jemi në përmbushje të direktivave të mjedisit të kërkuar nga BE dhe ato që na kërkohen nga plani i zhvillimit për Bashkinë të parashikuar për strategjinë 2017-2031, mungon një plan i detajuar vperimi që të meret në konsideratë mbrojtja e mjedisit edhe pse shkuhet për të, nuk kemi qartësim të politikave mjedisore në këtë këndvështrim. Ju bëj me dije se është duke u shqyrtuar ligji për ndryshimet klimatike që do ndikojë tek pjesa e mjedisit dhe duke pasur parasysh që kemi zgjedhur përfaqësuese skiatore për turizmin në qytetin e Korçës, skiatoren italiane, e cila do jetë model i turizmit nuk e di çfarë do ndodhë, si do e bëjmë ne promovimin kur në fakt nuk e kemi realizuar

me kujdes atë pistëne skive dhe nga ana tjetër ndoshta ndryshimi i klimës nuk do na sjellë ta realizojmë me sukses pistën. Tjetër program i rëndësishëm është ai për arsimin bazë parashkollor edhe i mesëm edhe këtu vlen se kemi një rritje të investimeve 34 % të buxhetit dhe kjo është për tu vlerësuar. Por jemi pak skeptikë sepse nuk mora një përgjigje me migrimin potencial, çfarë ndodh me numrin e shkollave, me numrin e nxënësve në klasat përkatëse dhe cilat janë pritshmëritë. Në lidhje me programin e perkujdesjes sociale, ka një rritje me masën e këtij programi në masën 70 % një rritje nga vjwjt sepse ishte në masën 4 %, kjo ndodhta sepse popullata ishte në plakje dhe vëmendja është fokusuar moshën e tretë. Ajo që vura re janë hequr disa programe të cilat vendsoin në focus gruan, ato që kanë qënë në vitin 2025, si përshebull dita e gruas, është karakterizuar mbështetja e grave në një fushatë ndërgjegjësimi, ndërkohë ne aktivitetet duhet t'i kemi si fillim për parandalim, më pas për rehabilitim të gjendjes të tyre dhe nuk kemi një fokus në lidhje me gratë sipërmarrëse, drejtuese për të vlerësuar rolin e gruas në vendimmarrje. Këto janë ato që unë kisha kritikë por edhe vlerësim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, fjala për z.Pllaha, përgatitet z. Habip, më pas z. Petri.

Këshilltar K.Pllaha: Diskutimet ishin të gjata, u thane anët e forta nga kryetari, kritikën nga nga e opozitës dhe nuk po merrem me detaje sesa me esencën. Kur merren vendimmarrje të kësaj natyre është momenti të shohim njëri-tjetrin në sy dhe qytetarët dhe të pranojmë problemin e vetëm që ka Korça që është tkurrja në numrin e popullsisë, plakja në moshë. Prandaj ju pyeta si e adresoni ju mbrjotjen tek familjet e reja, suportin për buqësinë dhe zhvillimi ekonomik sepse për mendimin tim kështu mund të ndalet tkurrja dhe nuk pashë ndonjë reagim për këtë problem, nuk pashë asnjë ndryshim nga buxheti i vjetshëm, apo i parvjetshëm që të adresonte me seriozitet plakjen e qytetit. Me këtë buxhet duhet ta kujtoj se do jetë i fundit që do zbatohet i plotë nga ju si kryetar Bashkie dhe i fundit mbahet mend. Si do ju lerë në memorien kolektive ky buxhet?

Faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, fjala për z. Habip.

Këshilltar A.Habip: Ekzekutivi ka dërguar për miratim një buxhet prej 2 miliardë e 614 mijë e 473 mijë lekë. Ky buxhet është me një rritje 5.8 % krahasuar me planin e buxhetit të vitit 2025 dhe tregon një buxhet realist dhe të planifikuar mbi bazën e performancës aktuale dhe vitit 2023-2024. Është e vërtetë që burimet nuk realizohen në masën 68 % por kjo është shpjeguar nga drejtuesit e drejtorisë të të ardhurave se bëhet fjalë për planifikim mbi kapacitete maksimale. Shifrat e të ardhurave nga taksave janë 10.2 % më të larta se ato të realizimit të 2024. Gjithashtu dhe të ardhurat jo tatimore priten të jenë 7.7 % në raport me vitin 2024, që tregon që Bashkia ka përmirësuar kapacitetet e saj administruese dhe ka rritur kontrollin mbi agjentët e saj tatimore. Në lidhje me shpenzimet ato të personelit janë 11 % më shumë se viti 2025 por ndërkohë shpenzimet korrente janë 5 % më të ulta kjo tregon kontrollin e brendshëm. Inestetimet janë 25 % më shumë krahasuar me vitin 2025, kjo tregon një vëmendje të shtuar ndaj nevojave të qytetit dhe njësive administrative. Në konushtimet me buxhetin, banorët e njësive administrative kishin nevoja të shumta disa prej të cilave urgjente, rrugë, asfalt, ujësjellëz kanalizime, ndërhyrje në varreza. Gjithë këto kërkesa komisioni i financës dhe kryesia e Këshillit bënë një relacion dhe ja paraqitën Kryetarit të Bashkisë dhe kanë nevojë për vëmendje të veçantë. Disa prej tyre ne i paraqitem edhe në listën për investime 2026-2028. Këto investime duhet t'i nënshtrohen auditit

dhe kontrollit të brendshëm, atje ku nuk zbatohen siç duhen, mund të na shfaqet lagështia, del asflati, investimin ta merr lumi ose përroi. Në lidhje me termoizolimin e banesave me bashkpronësi, ka disa vite i planifikuar në buxhet deri në 10 milion lekë. Për vitin 2026 është reduktuar në 5 milion për shkak se nuk është përdorur, unë dyshoj se pjesë e këtij fondi do përdoret edhe vitin e ardhshëm për shkak të procedurës të bashkëfinancimit dhe ata nuk pranojnë. Unë do sygjeroja që ky fondit të emergjencave ose NSHP-së dhe të përdorej në rastet si ato që na janë shfaqur gjatë takimeve publike, si në rastin e e një banori i cili kishte lagështi dhe Bashkia nuk mund të ndërhyrjë sot në banesa të pa banueshme, do sygjeroja që Bashkia të përfshijë edhe Këshillin, duke ngritur komision me kryetarin e njësisë, me inspektorin e zonës, duke bërë edhe një relacion mund të marrësh edhe lejë në gjykatë, duhet parë edhe nga ana ligjore. Përsa i përket projekteve, promovimi I Lara Kuturit si imazh i turizmit për mua është investim që duhet të vazhdojë. Kjo skiatore ka fituar një garë në kupën e botës dhe është ngjitur dy herë të tjera në podium. Falë rezultateve të saj Shqipëria do përfaqësohet edhe me dy lojëra përfituese në lojërat dimërore, Gjithashtu për programe të tjera janë projektuar edhe disa programe që nuk kanë qënë në vitin 2025 si Panairi i Vjeshtës që është 2 milion lekë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Ju lutem më shpejt.

Këshilltar A.Habip: Bashkia do financojë aktivitetet të cilat janë brand, si festivali i komedisë Koko DFest, Festa e Birrës do zhvillohen tek Qendra e Eventeve. Në fushën e inovacionit ekzekutivi ka parashikuar një fond prej 21 milion lekë që përfshin 11 aktivitete për të rinjtë, kjo tregon një kujdes të shtuar për këtë kategori, edhe shumë projekte të tjera që janë në projekt buxhet apo edhe ato që kryetari prezantoi në fjalën e tij si Poli i Dijes, gazifikimi, Liceu Francez, apo rikosntruksioni i Pallatit të Sportit. Unë mendoj se ky buxhet duhet të votohet dhe ftoj dhe këshilltarët e tjerë.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Z.Petri, më pas z.Tollkuçi.

Këshilltar L.Petri: Dua të paraqes disa referenca nisur edhe nga diskutimi që u bë me shpresën se është si ajo puna e butit me verë që kur provon një kupë ke thënë gjithë cilësinë e butit dhe le të shohim se nëse kemi para një projekt buxhet që është me frymë ose pa frymë sepse kështu është i qëndisur dhe ju përgëzoj dhe të shohim nëse është buxhet me apo pa kreativitet. Ju ftoj së pari, për bxuhetimin gjinor unë jam kundër kësaj sepse fjala vjen si me mua konkuron një vajzë që është shumë më e përparuar apo e kundërta, nuk duhet të futemi tek axhendat botërore që thjesht duke u nisur nga seksi t'i avantazhojmë ose disavantazhojmë dikë. Në faqen 27 tek tarifat vendore si ta vemë re se është një rritje thuajse ekponenciale të zënies të hapësirave publike ku një anë i terrorizojmë sipërmarrësit pikërisht sepse ata kishin zënë me lejë hapësirat publike dhe nga ana tjetër zotohemi se do vjelim thuajse këtë rritje eksponenciale. Si mundet ta shohim këtë buxhet nëse është inovativ apo i qullët kur i bihem gjoksit qdo vjelim gjobat e dynjasë, si nga policia bashkiake, si vonesë në pagesë e të tjerë. Në faqen 42 si mundet sepse shifrat janë ato që janë kokëforta, si mundet të pretendojmë të kemi të bëjmë me buxhet kreativ ku të ardhurat që do vijnë nga taksat e ndara të tatimit të shitjes të pasurive të palujtshme janë planifikuar për tu vjelur thuajse në dyfishin e tyre. Do bëhet boom shitjesh në territorin tonë?

Në faqen 87 një shifër tjetër që doja të përmendja ka të bëjë me atë që u përmend nga z.Habip Lara Kuturin me gjithë respuktin uroj të na shkojë mirë por është thikë me dy presa sepse në njërin anë jemi pa borë, në anën tjetër në një klimë aspak të favroshme për zhvillimin ekonomik

dhe social, jemi pa lekë dhe në ana tjetër po japim para dhe mendojmë se do na kthehn në boom turistësh, para një jave kam qënë në Slloveni qytet shumë i ngjashëm me Korçën, ishin një tranzicion të zhvillimit të tyre dhe sip una jonë mendonin të zhvillonin sportin e skive, e kanë patur të zhvilluar në periudhën e ish- Jugo Skllavisë por sot me ndryshimin e klimës, nuk ka më dëborë dhe ata nuk po bëjnë gabim si punë jonë por e kishin transferuar në sporte të aventurës biçikletave, hiking dhe jo se nuk lëviznin nga instikti vetëm ski. Ju ftoj që në faqen 104, kur është përmendur event për shkopin e bardhë jam vënë në dijeni nga drejtuesi i Shoqatës të të verbërve, buxhetimi që na është paraqitur në material të ketë edhe një shumë tjetër që sipas tyre duhet të shkojë për t'i ndihmuar për një eksursion në Volorekë dhe është bërë një parashikim 1500 lekë për ushqimin dhe 500 lekë vajtje- ardhje për rrugë. Ju lutem nëse ka mundësi me 60 mijë lekë të tjera ku përveç shkopit të bardhë të ndihmohen nga buxheti publik edhe për këtë veprimtari. Doja të përmendja tek lista e veprimtarisë të kulturës faqja 109, jo për hir të të krahësuarit të njëjtin veprimtari me tjetrën sepse secila ka dobinë e vetë por nuk mund të rrimë pa thënë, për shembull “Gjon Mili Internacion Video Art Festival” buxhetohet me 1 milion e 500 mijë që është një event i cili më parë mbaron sesa fillon dhe një event që në gjykimin e njerëzve që kam pyetur ka më shumë vlerë, siç është Festivali i Filmit me metrazh të shkurtër ka më pak se gjysmën e këtij buxheti, angazhon shumë njerëz, të rinj, fton rregjisorë që mund të mbajnë kujtesa, pra nxit kulturën e vërtetë dhe jo kulturën e spektaklit. Festivali Mik dhe Karnavale që në gjykimin tim janë të fryra megjithatë është në të drejtën tuaj ta propozoni kështu. Kam një propozim për Qendrën e Mbështetjes të Fëmijëve sepse jemi në kushtet që popullsia ka rënë shumë, duam apo nuk duam ta pranojmë dhe shtëpitë po kthehen me dy anëtarë dhe shumica janë pensionistë dhe propozimi im është këtë qendër ta kthejmë në qendër mirëfilli, mission shërbimi të moshuarit. Unë e di që ka iniciativa për të moshuarit janë qendrat midis lagjeve dhe zakonisht shkon seksi mashkull që pi një çaj, apo kafe po për grate?

Besoj se duhet të ketë njerëz me zell për t'i mbështetur dhe kujdesur për mbarëvatjen e tyre shëndetësore, fizike, emocionale. Dua ta mbyll me fjalën e z.Kryetar sepse më kërkoi ndihmë edhe më that ë lutem pse e përmend faktin e popullsisë që ka dy referenca një nga gjendja civile dhe një nga Instat dhe ku ndikon kjo tek buxhet?

I dashur z.Filo besoj se duhet marrë në vëmendje kjo gjë sepse jemi duke gënjyer edhe mbase sot jemi duke gënjyer ata të Ministrisë në favorin tone dhe jemi duke ju dhënë shifrën e fryrë të popullsisë. Për momentin mund të na dukem me leverdi sepse dhe transfertat e pakushtëzuara mund të duken më të mëdha por herët apo vonë kjo flluskë mund të 0rahët dhe të qartësohemi njëherë e mirë kë do marrim për reference dhe kjo ndikon në buxhet sigurisht.

Kryetari i Bashkisë S.Filo: (Nuk ka audio, flet pa mikrofon.)

Këshilltar L.Petri: Nuk po e krahasoj me qytetet e tjera po flas për Korçën dhe mungesa e qartësisë për numrin e popullsisë e deformon projekt-buxhetin e Bashkisë, sepse kur një institucion flet për 100 30 mijë banorë dhe një tjetër për 60 mijë banorë, jemi në kushte se dhe ata të Ministrisë jemi duke i gënjyer dhe këto diferencime bëjnë që shpenzimet dhe investimet jemi duke i planifikuar larg nevojave reale. Për mos thënë që të ardhurat vendor nga taksat dhe tarifat mund të bihen në ulla e të projektuarit pa baza reale apo shërbimet publike të lenë për të dëshiruar, të cënohet edhe marrëdhënia me donatorë dhe me qytetarët, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, z.Tollkuçi.

Këshilltar P.Tollkuçi: Përshëndetje të nderuar kolegë, e para që doja të thoja në takimin që u bë për komisionin e financave vërtetuaam përsëri se jemi të parët që bëmë live mbledhjen e komisionit të financave duhet përmendur ky fakt pasi ishte hera e parë dhe ajo që u diskutua ishte live dhe ka qënë mbledhje brenda korrnizave ligjore dhe çdo kush që ka bërë pyetjet ka marrë përgjigjet e duhura ndoshta me difekt por i ka marr. Dua të përmend faktin se gjithë këshilltarët kush do në gjitha komisionet mund të marrë pjesë dhe fakti tjetër është që komision i financave është i vetmi që mbledhet rregullisht pa asnjë mungesë. Dua ta nisa fjalën time lidhur me numrin e popullsisë sipas të cilit duhet të hartohet edhe buxheti sipas kolegëve. Në dijeninë time Korça është qyteti më pak i tkurur në Shqipëri nga informacionet që kam, përveç sa duhet të kemi parasysh se sot jetojmë në një vend demokratik ku lëvizja e lirë është tashmë parim, këto janë fenomene që ndodhin kudo. Nëse ne e prekim këtë fenomen ne qenkemi bërë Europeanë jo vetëm si pjesë gjeografike por edhe si pasojë e fenomeneve. Nuk jemi jemi vetëm ne të plakur gjithë Europa po e vuan këtë fenomen. Prandaj në lidhje me këtë pjesë do e lidhje me arsimin, buxheti i adresohet edhe arsimit dhe mendoj se qasja është e duhura do e lidh edhe me universitetin sepse gjithmonë e shohim gotën gjysëm bosh dhe pse mos e shohim gjysëm plot, nga kontaktet që kam me profesorët e universitetit dhe kam informacion se numri i kuotave ishte më lart se viti i kaluar, shifrat janë atje dhe mund të shkoni dhe të verifikoni sepse po e bëjmë sikur jetojnë vetëm mace e qen kur po jetojmë ne të gjithë, kjo është një pike shumë e forte. Në lidhje me moshën e tretë që themi lind kjo problematikë por është fenomen European, tek ky buxhet unë e shoh shumë qartë adresimin nga kësaj moshe sipas meje është në nivelin e duhur, gjithmonë ka nevojë për përmirësim. Në lidhje me universitetin, qasja me Polin e Dijes dhe përfshirja e universitetit Hollandez i cili është i orientuar ndaj buqësisë do jetë një shtysë më shumë për forcimin e fakultetit të buqësisë, pasi është universiteti i specializuar jo vetëm në pjesën e mesimdhënies por edhe në inovacionin e buqësisë dhe orientimin e buqve ndaj të resë. Gjithashtu sa i përket turizmit, duhet të kemi parasysh që kemi qënë ne ata që nisëm turizmin dhe jemi mësuar ta shohim Korçën plot e për plot dhe ajo u mbush falë politikave që kjo Bashki ka bërë prej vitit 2007, gjithë të tjerë flinin kur bënim turizëm, tani u zgjuan dhe ka konkurrencë. Shqipëria ka bukuri natyrore, duan të punojnë për Bashkitë dhe qarqet e tyre dhe jemi në konkurrencë dhe nuk mund të pretendojmë të kemi të njëjtin numër turistësh. Gjithë këto ndërtime dhe hapësira akomoduese nuk u ndërtuan rastësisht por njerëzit e panë si përfituese. Politikat e çmimeve nuk i rregullon Bashkia por kërkesa dhe oferta, kjo është e vërteta dhe çdo kush do marrë atë që i takon. Gjithmonë duhet të shohim se si ajo që ka shkruar Sami Frashëri, “Çkemi qënë, Ç’jemi dhe Çdo të bëhemi”, dimë ç’kemi qënë çfarë jemi por duhet të dijmë ku do shkojmë dhe pa një buxhet nuk shkojmë në asnjë vend, e kundërta e buxhetit për mendimin tim është kaosi, nëse ne vijmë këtu por mos e votuar i ofrojmë komunitetit kaos dhe jemi këtu për të shprehur mendimin tonë, nëse nuk do ishim buxhet bërëse nuk do ishim këtu ku jemi sot por sepse denim të ndërtonim buxhete dhe denim të bënim shtet bazuar në thënien e fatos Nanos kemi lënë buxhet për të bërë shtet. Prandaj lidhur me këtë pjesë jam i përgjegjshëm dhe nuk mund të mohojmë progresin që ka bërë kjo Bashki bazuar në këto buxhete të hartuar ndër vite që nga 2007 deri më sot. Në lidhje me kulturën nuk besoj se ka Bashki tjetër në Shqipëri mbase veç Tiranës që të ketë kaq aktivitete artistike- kulturore që gjallërojnë jetën e qytetit dhe jo vetëm. Të gjithë e kemi parë programin e Bashkisë vetëm në muajin dhjetor, këtu ose është keqdashje ose injorancë që ne mos paraqitim atë çfarë ndodh me qytetin kur janë ditët plot por vetëm kur ka ditë bosh, por do ketë edhe ditë bosh, patjetër. Në kuadrin e këtij kompetiviteti brenda

Shqipërisë, Bashkia duhet të jetë kreative dhe innovative dhe unë e shoh këtë buxhet edhe kreativ edhe inovativ dhe në këto kushte duhet të kemi një buxhet të tillë fleksibël, i cili t'i përgjigjet kushteve të konkurrencës të brendshme dhe asaj rajonale. Prandaj unë ju falenderoj të gjithëve që patët durimin më dëgjuat dhe ju ftoj të gjithëve ta votojmë, faleminderit.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit, meqënëse të gjithëve këshilltarët që kërkuar fjalën për të diskutuar, kanë diskutuar unë vlerësoj faktin që pati angazhimin tuaj me pyetje sqaruese për ekzekutivin dhe sigurisht me diskutime të vlefshme që ekzekutivi do i ketë në konsideratë gjatë punës së vet. Është momenti ta hedhim në votim.

Këshilltar L.Petri: Për procedurë znj.kryetare propozoj mos hidhet në votim elektronik sepse është një nga vendimmarrjet më të rëndësishme, të votojmë hapur si në mënyrën klasike.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Do vazhdojmë ta mbyllim me votim elektronik siç e kemi filluar.

Këshilltar L.Petri: Pse?

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Nëse do jashtë këtij konteksti të votojnë edhe me dorë dhe të shohësh nëse ka dibalancë midis tyre. Hap procesin e votimit.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 5

Vota ABSTENIM 1

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 28 këshilltarë, 22 pro, 5 kundër, 1 abstenim.

Kryetari i Këshillit A.Verushi: Faleminderit të gjithëve. Gëzuar festat shëndet edhe mbarësi!

Shihemi mbledhjen e radhës!

SEKRETARE E KËSHILLIT

EVA NAÇI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

ANA VERUSHI



Arbërie
2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
DREJTORIA E KUJDESIT SOCIAL

RELACION

BASHKIA KORÇË
NR 446 PROT
DAT 15/01/2026

**MBI DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE NGA 6% E FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR
BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DHE NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR
PËR PERIUDHËN 1 – 31 DHJETOR 2025**

Për muajin **Dhjetor**, janë **60** familje përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar. Fondi 6% i bllok ndihmës ekonomike është një fond i cili i shtohet çeljes faktike nga lista e përfituesve të ndihmës ekonomike, të përzgjedhur nga sistemi i pikëzimit. Këto familje përzgjidhen nga ana e Administratorit Shoqëror sipas Njësive Administrative, nga familjet e pakualifikuara nga sistemi i pikëzimit me cilësimin, "**Nuk ka marrë pikët e mjaftueshme**". Përzgjedhja bëhet bazuar kryesisht të miratuara me VKB, nëpërmjet vizitave në familje në terren dhe duke verifikuar gjendjen social-ekonomike të familjeve aplikante, bazuar VKM Nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" i ndryshuar, në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës, të neneve 12, pikat 1,4,5,16, pika 2 dhe 21 të ligjit nr 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë dhe vendimit nr. 4 dhe 5, datë 30.01.2025 të Këshillit Bashkiak Korçë "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike" dhe nga fondi i buxhetit vendor i Bashkisë Korçë, ligjit Nr.87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026". VKB Nr.139, datë 26.12.2025 "Mbi miratimin e Buxhetit vjetor të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028 të Bashkisë Korçë.

Nga të gjitha familjet e pakualifikuara nga sistemi për mos marrjen e pikëve të mjaftueshme, përfitojnë, familjet me nivel më të ulët ekonomik, me probleme sociale dhe shëndetësore, personat mbi moshë pune, personat e vetmuar, familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë, familjet rome dhe egjiptiane.

Për të gjitha këto arsye, i propozon Këshillit të Bashkisë:

- 1- Të miratojë për muajin **Dhjetor 60 familje** përfituese të ndihmës ekonomike nga 6% i fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, nga sistemi i pikëzimit, në vlerën **217.023 lekë**.
- 2- Të miratojë familjet përfituese, të kompensimit të energjisë elektrike **20 familje**, në shumën **25.112 lekë**.

- 3- Të miratojë ndihmën ekonomike nga **fondi i buxhetit vendor**, sipas kriterëve specifike të miratuara **12 familje** me fond prej **61.818 lekë**.

Nga të cilët:

Persona të vetmuar	<u>5</u>
Persona në pamundësi fizike për të punuar	<u>1</u>
Kryefamiljare femra me fëmijë të mitur në ngarkim	<u>4</u>
Familje të komunitetit rom-egjiptian, me probleme social-ekonomike	<u>2</u>

Emrat e kryefamiljarëve të familjeve që dalin nga skema e ndihmës ekonomike dhe arsyet përkatëse

Nr	EMËR	ATËSI	MBIEMËR	ARSYEJA E DALJES NGA SKEMA	RAJONI/NJËSIA
1.					
2.					
3.					

Emrat e kryefamiljarëve të familjeve që rifuten në skemën e ndihmës ekonomike dhe arsyet përkatëse

Nr	EMËR	ATËSI	MBIEMËR	ARSYEJA E RIFUTJES NË SKEMË	RAJONI/NJËSIA
1.	Migena	Servet	Pajo	Nënë kryefamiljare me fëmijë në ngarkim	Rajoni.2
2.	Melsi	Hasim	Mustafa	Familje në nevojë, me probleme social-ekonomike	Voskop
3.	Majlinda	Çoban	Mali	K/familjare e vetmuar	Rajoni.1
4.					
5.					

**Emrat e kryefamiljarëve të familjeve që futen për herë të parë në skemën e ndihmës
ekonomike dhe arsyet përkatëse**

Nr	EMËR	ATËSI	MBIEMËR	ARSYEJA E FUTJES NË SKEMË	RAJONI/NJËSIA
1.					
2.					
3.					
4.					

*Drejtores e Përgjithshme e Drejtorisë
Juridike dhe Burimeve Njerëzore*

Anxhela Qeramixhi (Dishnica)



Drejtores e Kujdesit Social

Mariana Jorgji



*Drejtores e Financës,
Buxhetit dhe MFK*

Valbona Ziko



**KRYETARI I BASHKISË
Sotiraq FILO**



Fondi & pörsgind

© 2003 Blackwell Publishing Ltd

[illegible]

[illegible]

DREJTORE

Mariana Jorgji

Mariana Jorgji

LISTA E FAMILJEVE PËRITUTËSE TË NDHIMËS EKONOMIKE PËR PËRIUDHËN DHJETOR 2023
NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR.

Nr	EMER	ATËSI	MBIEMËR	Pagesa Mujore	Njësia Administrative	Arsyet e Trajtimit	ID
1	MAJLINDA	C	MALI	2178	RAJONI.1	K/Familjar i vetmuar	G75216045Q
2	VASFLEJE	P	NAZIFI	3703	RAJONI.2	K/Familjare grua, me femije ne ngarkim	G16229058Q
3	MIGENA	S	PAJO	5940	RAJONI.2	K/Familjare grua, me femije ne ngarkim	I26017063M
4	MANJOLA	B	RUSHAN	17424	RAJONI.3	K/Familjare grua, me shumë femije ne ngarkim	I55304106O
5	SPARTAK	A	LLOSHI	2178	RAJONI.3	K/Familjar i vetmuar	I10210108U
6	SOTIR	GJ	GROZDANI	5228	VITHKUQ	Familje ne kushte te veshitira ekonomike	G20412093G
7	MIGENA	Y	SHKËMBI	5228	MOLLAJ	Familje ne kushte te veshitira ekonomike	I55929095W
8	MONDA	Q	ALLISHA	3703	DRENOVË	Familje ne kushte te veshitira ekonomike	H55511033W
9	BRUNILDA	B	NAMETI	7920	DRENOVË	Nënë kryefamiljare me fëmijë në ngarkim	I86026056L
10	SKËNDER	S	KAROLLARI	2178	DRENOVË	K/Familjar i vetmuar	H61103013S
11	SHKËLQIM	M	SULOLLARI	2178	BULGAREC	K/Familjar i vetmuar	G50612029O
12	EMANUELA	V	KAREJMAN	3960	VOSKOP	K/Familjare grua, me femije ne ngarkim	J75415025G
TOTALI				61,818			

DREJTORI

Mariana Jorgji



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

P/V E N D I M

Nr. _____ datë _____ 2026

**Për miratimin e dhënien e Ndhmës Ekonomike nga 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-
Ndhmën Ekonomike
dhe Ndhmën Ekonomike nga fondi i buxhetit vendor, për periudhën 1-31 /12/2025.**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Kujdesit Social, duke u mbështetur në ligjin nr.139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin Nr.9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronjat "a" dhe "b", nenit 24, nenit 55, pikat 2 dhe 6, ligjit nr.87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", VKB Nr.139, datë 26.12.2025, "Mbi Miratimin e Buxhetit vjetor të vitit 2026" dhe PBA 2026-2028 të Bashkisë Korçë", VKM Nr.597, datë 04.09.2019, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" i ndryshuar, në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës, të neneve 12, pikat 1,4,5,16, pika 2 dhe 21 të ligjit nr 57/2019 "Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimeve nr. 3, 4, 5, pika 2, datë 17.02.2017 të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, vendimit nr. 4 dhe nr. 5, datë 30.01.2025 të Këshillit Bashkiak Korçë, "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike" dhe nga fondi i buxhetit vendor të Bashkisë, mbështetur në kompetencat që ka, si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve :

VENDOSI:

- 1- Të miratojë për muajin **Dhjetor 60 familje** përfituese të ndihmës ekonomike nga 6% i fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, nga sistemi i pikëzimit, në vlerën **217.023 lekë**.
- 2- Të miratojë familjet përfituese, të kompensimit të energjisë elektrike **20 familje**, në shumën **25.112 lekë**.
- 3- Të miratojë ndihmën ekonomike nga **fondi i buxhetit vendor**, sipas kriterëve specifike të miratuara **12 familje** me fond prej **61.818 lekë**.
- 4- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet **Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK**

5-Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

KRYETARE
Ana Verushi

Miratuar me _____ vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. _____ datë _____ 2026

**Mbi dhënien e Ndhmës Ekonomike nga 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike.
Dhe Ndhmën Ekonomike nga fondi i buxhetit vendor, për periudhën 1-31.12.2025.**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Kujdesit Social, duke u mbështetur në ligjin nr.139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin Nr.9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1, nënpika 1.1, shkronjat "a" dhe "b", nenit 24, nenit 55, pikat 2 dhe 6, ligjin nr.87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", VKB Nr.139, datë 26.12.2025, "Mbi Miratimin e Buxhetit vjetor të vitit 2026" dhe PBA 2026-2028 të Bashkisë Korçë", VKM Nr.597, datë 04.09.2019, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" i ndryshuar, në mbështetje të nenit 100 të kushtetutës, të neneve 12, pikat 1,4,5,16, pika 2 dhe 21 të ligjit nr 57/2019 "Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimeve nr. 3, 4, 5, pika 2, datë 17.02.2017 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, vendimit nr. 4 dhe nr. 5, datë 30.01.2025 të Këshillit Bashkiak Korçë, "Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike" dhe nga fondi i buxhetit vendor të Bashkisë, mbështetur në kompetencat që ka, si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve :

VENDOSI:

- 1- Të miratojë për muajin **Dhjetor 60 familje** përfituese të ndihmës ekonomike nga 6% i fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, nga sistemi i pikëzimit, në vlerën **217.023 lekë**.
- 2- Të miratojë familjet përfituese, të kompensimit të energjisë elektrike **20 familje**, në shumën **25.112 lekë**.
- 3- Të miratojë ndihmën ekonomike nga **fondi i buxhetit vendor**, sipas kriterëve specifike të miratuara **12 familje** me fond prej **61.818 lekë**.
- 4- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet **Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK**

5-Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

KRYETARE
Ana Verushi

Miratuar me _____ vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____

Subject	Kurtis
Interview	Kurtis
Transcription	Tr. 01/04/04

[illegible]

LISTA E FAMILJEVE PËRITUESË TË NDIHMËS EKONOMIKE PËR PERIUHËN DHJETOR 2025
NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR.

Nr	EMER	ATËSI	MBIEMËR	Pagesa Mujore	Njësia Administrative	Arsyet e Trajtimit	ID
1	MAJLINDA	Ç	MALI	2178	RAJONI.1	K/Familjar i vetmuar	G75216045Q
2	VASFILJE	P	NAZIFI	3703	RAJONI.2	K/Familjare grua, me femije ne ngarkim	G16229058Q
3	MIGENA	S	PAJO	5940	RAJONI.2	K/Familjare grua, me femije ne ngarkim	I26017063M
4	MANJOLA	B	RUSHAN	17424	RAJONI.3	K/Familjare grua, me shumë femije ne ngarkim	I55304106O
5	SPARTAK	A	LLOSHI	2178	RAJONI.3	K/Familjar i vetmuar	I10210108U
6	SOTIR	GJ	GROZDANI	5228	VITHKUQ	Familje ne kushte te veshitira ekonomike	G20412093G
7	MIGENA	Y	SHKËMBI	5228	MOLLAJ	Familje ne kushte te veshitira ekonomike	I55929095W
8	MONDA	Q	ALLISHA	3703	DRENOVË	Familje ne kushte te veshitira ekonomike	H55511033W
9	BRUNILDA	B	NAMETI	7920	DRENOVË	Nënë kryefamiljare me fëmijë në ngarkim	I86026056L
10	SKËNDER	S	KAROLLARI	2178	DRENOVË	K/Familjar i vetmuar	H61103013S
11	SHKËLQIM	M	SULOLLARI	2178	BULGAREC	K/Familjar i vetmuar	G50612029O
12	EMANUELA	V	KAREJMAN	3960	VOSKOP	K/Familjare grua, me femije ne ngarkim	J75415025G
TOTALI				61,818			

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

Ana Verushi



Arta
emil



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E KUJDESIT SOCIAL

BASHKIA KORÇË

NR 447 PROT
DAT 15/01/2026

RELACION

Mbi dhënien e Mbështetjes Financiare, sipas VKM Nr. 835, datë 30.12.2025 "Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për vitin 2025", për 12 familje të ndihmes ekonomike.

Në zbatim të VKM Nr. 835, datë 30.12.2025 "Për Mbështetjen Financiare të disa kategorive të veçanta për vitin 2025", ligjin nr.57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr.597, datë 04.09.2019, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" i ndryshuar, ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjin nr.87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", VKB 139, datë 26.12.2025, "Mbi miratimin e Buxhetit vjetor të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028" të Bashkisë Korçë, kërkojmë të miratohet fondi për mbështetjen financiare për 12 familje të ndihmes ekonomike, të cilat trajtohen nga fondi i buxhetit vendor, në masën 15.000 lekë për secilën familje, me një fond prej 180.000 lekë.

Familjet perfituese janë familjet e trajtuara me pagesë me borderonë e muajit Dhjetor 2025. Fondi prej 180.000 lekë do të përballohet nga fondi i buxhetit vendor i planifikuar në buxhetin e vitit 2026 të Bashkisë.

**Drejtores e Përgjithshme e Drejtorisë
Juridike dhe Burimeve Njerëzore**

Anxhela Qeramixhi (Dishnica)

Drejtores e Kujdesit Social

Mariana Jorgji

**Drejtores e Financës
Buxhetit dhe MFK**

Valbona Ziko

**KRYETARI I BASHKISË
Sotiraq FILO**

LISTA E FAMILJEVE PËRFTUJESË TË NDIHMËS EKONOMIKE PËR PERIUDHËN DHJETOR 2025
NGA FONDI I BUNËTIT VENDOR, MBËSHETETJE FINANCIARE

Nr	EMER	ATËSI	MBIEMËR	Pagesa Mujore	Njësia Administrative	Arsyet e Trajtimit	ID
1	MAJLINDA	Ç	MALI	15000	RAJONI.1	K/Familjar i vetmuar	G75216045Q
2	VASFIJE	P	NAZIFI	15000	RAJONI.2	K/Familjare grua, me fëmijë në ngarkim	G16229058Q
3	MIGENA	S	PAJO	15000	RAJONI.2	K/Familjare grua, me fëmijë në ngarkim	I26017063M
4	MANJOLA	B	RUSHAN	15000	RAJONI.3	K/Familjare grua, me shumë fëmijë në ngarkim	I55304106O
5	SPARTAK	A	LLOSHI	15000	RAJONI.3	K/Familjar i vetmuar	I10210108U
6	SOTIR	GJ	GROZDANI	15000	VITHKUQ	Familje në kushte të vështira ekonomike	G20412093G
7	MIGENA	Y	SHKËMBI	15000	MOLLAJ	Familje në kushte të vështira ekonomike	I55929095W
8	MONDA	Q	ALLISHA	15000	DRENOVË	Familje në kushte të vështira ekonomike	H55511033W
9	BRUNILDA	B	NAMETI	15000	DRENOVË	Nënë kryefamiljare me fëmijë në ngarkim	I86026056L
10	SKËNDER	S	KAROLLARI	15000	DRENOVË	K/Familjar i vetmuar	H61103013S
11	SHKËLQIM	M	SULOLLARI	15000	BULGAREC	K/Familjar i vetmuar	G50612029O
12	EMANUELA	V	KAREJMAN	15000	VOSKOP	K/Familjare grua, me fëmijë në ngarkim	J75415025G
TOTALI				180,000			

DREKTORI

Martina Jorgji





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KESHILLI BASHKIAK

P/VENDIM

Nr. _____ datë _____ 2026

Mbi dhënien e Mbështetjes Financiare, sipas VKM Nr. 835, datë 30.12.2025 "Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për vitin 2025", për 12 familje të ndihmes ekonomike.

Në zbatim të VKM Nr. 835, datë 30.12.2025 "Për Mbështetjen Financiare të disa kategorive të veçanta për vitin 2025", ligjin nr.57/2019 "*Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë*", VKM Nr.597, datë 04.09.2019, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" i ndryshuar, ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjin nr.87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", VKB 139, datë 26.12.2025, "Mbi miratimin e Buxhetit vjetor të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028" të Bashkisë Korçë, mbështetur në kompetencat që ka, si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI:

1-Të miratojë fondin për mbështetjen financiare për 12 familje të ndihmes ekonomike, në masën 15.000 lekë me një fond prej 180.000 lekë.

2- Fondi prej 180.000 lekë do të përballohet nga fondi i buxhetit vendor i planifikuar në buxhetin e vitit 2026 të Bashkisë. Familjet perfituese janë familjet e trajtuara me pagesë me borderonë e muajit Dhjetor 2025.

**3- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kujdesit Social dhe
Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK**

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

KRYETARE
Ana Verushi

Miratuar me _____ vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
BASHKIA KORÇË
KESHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. _____ datë _____ 2026

Mbi dhënien e Mbështetjes Financiare, sipas VKM Nr. 835, datë 30.12.2025 "Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për vitin 2025", për 12 familje të ndihmes ekonomike.

Në zbatim të VKM Nr. 835, datë 30.12.2025 "Për Mbështetjen Financiare të disa kategorive të veçanta për vitin 2025", ligjin nr.57/2019 "*Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë*", VKM Nr.597, datë 04.09.2019, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" i ndryshuar, ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjin nr.87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026", VKB 139, datë 26.12.2025, "Mbi miratimin e Buxhetit vjetor të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028" të Bashkisë Korçë, mbështetur në kompetencat që ka, si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI:

1-Të miratojë fondin për mbështetjen financiare për 12 familje të ndihmës ekonomike, në masën 15.000 lekë me një fond prej 180.000 lekë.

2- Fondi prej 180.000 lekë do të përballohet nga fondi i buxhetit vendor i planifikuar në buxhetin e vitit 2026 të Bashkisë. Familjet perfituese janë familjet e trajtuara me pagesë me borderonë e muajit Dhjetor 2025.

**3- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kujdesit Social dhe
Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK**

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

KRYETARE
Ana Verushi

Miratuar me _____ vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____

LISTA E FAMILJEVE PËRFTUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE PËR PERIUDHËN DHJETOR 2025
NGA FONDI I BUXHETIT VENDOR, MBËSHTETJE FINANCIARE

Nr	EMER	ATËSI	MBIEMËR	Pagesa Mujore	Njësia Administrative	Arsyet e Trajtimimit	ID
1	MAJLINDA	Ç	MALI	15000	RAJONI.1	K/Familjar i vetmuar	G75216045Q
2	VASFIJE	P	NAZIFI	15000	RAJONI.2	K/Familjare grua, me fëmijë në ngarkim	G16229058Q
3	MIGENA	S	PAJO	15000	RAJONI.2	K/Familjare grua, me fëmijë në ngarkim	I26017063M
4	MANJOLA	B	RUSHAN	15000	RAJONI.3	K/Familjare grua, me shumë fëmijë në ngarkim	I55304106O
5	SPARTAK	A	LLOSHI	15000	RAJONI.3	K/Familjar i vetmuar	I10210108U
6	SOTIR	GJ	GROZDANI	15000	VITHKUQ	Familje në kushte të vështira ekonomike	G20412093G
7	MIGENA	Y	SHKËMBI	15000	MOLLAJ	Familje në kushte të vështira ekonomike	I55929095W
8	MONDA	Q	ALLISHA	15000	DRENOVË	Familje në kushte të vështira ekonomike	H55511033W
9	BRUNILDA	B	NAMETI	15000	DRENOVË	Nënë kryefamiljare me fëmijë në ngarkim	I86026056L
10	SKËNDER	S	KAROLLARI	15000	DRENOVË	K/Familjar i vetmuar	H61103013S
11	SHKËLQIM	M	SULOLLARI	15000	BULGAREC	K/Familjar i vetmuar	G50612029O
12	EMANUELA	V	KAREJMAN	15000	VOSKOP	K/Familjare grua, me fëmijë në ngarkim	J75415025G
TOTALI				180,000			

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK
Ana Verushi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
DREJTORIA E KUJDESIT SOCIAL

BASHKIA KORÇË
NR 419 PROT
DATA 15/04/2020

RELACION

Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, me 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok – ndihmën ekonomike, për vitin 2026.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, Ligjit nr.57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimit nr. 5, datë 17.02.2017, udhëzimit nr.8 datë 8.5.2017, Ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026. V.K.M Nr.597, datë 04.09.2019, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" i ndryshuar.

Është e drejta e Drejtorisë së Kujdesit Social, të përzgjedhë , një numër familjesh nga kategoritë më në nevojë dhe të trajtojë ato me një fond deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike.

Këto familje përzgjidhen nga aplikantët e listës së familjeve jo përfituese.

Për këto familje , duhet të kryhet detyruesisht kontrolli në familje dhe të shoqërohet me një vlerësim social-ekonomik prej administratorëve shoqërorë të Drejtorisë së Kujdesit Social.

Lista e familjeve do të miratohen me vendim të Këshillit Bashkiak në bazë të kriterëve specifike që propozohen në Projekt-Vendim dhe që janë përcaktuar duke marrë parasysh situatën konkrete social-ekonomike të disa nën/kategorive.

*Drejtoresh e Përgjithshme e Drejtorisë
Juridike dhe Burimeve Njerëzore*

Anxhela Qeramixhi (Dishnica)

Drejtor i Kujdesit Social

Mariana Jorgji

**Kryetari i Bashkisë
Sotiraq Filo**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KESHILLI BASHKIAK

P/VENDIM

Nr. _____ datë _____ 2026

Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, me 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për Vitin 2026.

Duke u mbështetur në Ligjin nr.139, datë 17.12.2015, "Për vetë qeverisjen vendore", Ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026, Ligji nr.57/2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimeve nr. 3, 4, 5,8 datë 17.02.2017 të Ministrisë të Mirëqënies Sociale, V.K.M Nr.597, datë 04.09.2019, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike"i ndryshuar. Administratorët Shoqërorë të Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë, i propozojnë Këshillit të Bashkisë.

VENDOSI:

KËSHILLI BASHKIAK

1-Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike ku:

Përfitues të fondit 6% do të jenë:

1. Familjet të cilat kanë aplikuar për Ndhmë Ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit për pamjaftueshmëri pikësh.
2. Familja para se të përzgjidhet për tu trajtuar me këtë fond, duhet të jetë verifikuar paraprakisht dhe do të vlerësohen nga Administratorët Shoqërorë.
3. Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jetë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
4. Familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë ose të lartë.
5. Familje Rome dhe Egjiptiane.

6. Vajza-Nëna në nevojë.

7. Familje të cilat kanë, probleme të ndryshme sociale.

2-Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet **Drejtoria e Kujdesit Social dhe
Drejtoria e Financës, buxhetit dhe MFK**

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

KRYETAR

Ana Verushi

Miraturar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KESHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. _____ datë _____ 2026

Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, me 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për vitin 2026.

Duke u mbështetur në Ligjin nr.139, datë 17.12.2015, "Për vetë qeverisjen vendore", Ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026, Ligji nr.57/2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", të Udhëzimeve nr. 3, 4, 5,8 datë 17.02.2017 të Ministrit të Mirëqënies Sociale, V.K.M Nr.597, datë 04.09.2019, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike"i ndryshuar. Administratorët Shoqërorë të Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë, i propozojnë Këshillit të Bashkisë.

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1-Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike.

Përfitues të fondit 6% do të jenë:

1. Familjet të cilat kanë aplikuar për Ndihmë Ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit për pamjaftueshmëri pikësh.
2. Familja para se të përzgjidhet për tu trajtuar me këtë fond, duhet të jetë verifikuar paraprakisht dhe do të vlerësohen nga Administratorët Shoqërorë
3. Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jetë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
4. Familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë ose të lartë.
5. Familje Rome dhe Egjiptiane.

6. Vajza-Nëna në nevojë.
7. Familje të cilat kanë, probleme të ndryshme sociale (dhunë në familje, divorci, probleme shëndetësore, fatkeqësi natyrore, probleme me dokumentacionin në përmbushje të kriterëve që përcakton ligji Nr.57 /2022 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”)

2-Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet **Drejtoria e Kujdesit Social** dhe
Drejtoria e Financës, buxhetit dhe MFK

3-Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

KRYETAR

Ana Verushi

Miraturar me _____ vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
DREJTORIA E KUJDESIT SOCIAL

BASHKIA KORÇË
NR 420 PROT
DAT 15/01/2026

RELACION

Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i buxhetit vendor, për vitin 2026.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, Ligjit nr.57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", Neni 21, Udhëzimit nr. 5, datë 17.02.2017, pika 2, udhëzimit nr.8 datë 08.05.2017, V.K.M Nr.597, datë 04.09.2019, "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" i ndryshuar, Ligjit nr. 9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026".

Është e drejta e Drejtorisë së Kujdesit Social, të përzgjedhë, një numër familjesh nga kategoritë më në nevojë dhe të trajtojë ato me ndihmë ekonomike, nga buxheti i Bashkisë. Këto familje përzgjidhen nga aplikantët e listës së familjeve jo përfituese. Për këto familje, duhet të kryhet detyruesisht kontrolli në banesë dhe të shoqërohet me një vlerësim social-ekonomik prej administratorëve shoqërorë të Drejtorisë së Kujdesit Social. Përfitues të fondit nga Buxheti i Pushtetit Vendor do të jenë, familjet të cilat nuk kanë përfituar nga sistemi i pikëzimit dhe nga 6% i fondit të kushtëzuar. Por kualifikohen si përfitues për shkak të kushteve shumë të vështira social-ekonomike dhe vështirësive të veçanta sociale. Lista e familjeve do të miratohen me vendim të Këshillit Bashkiak në bazë të kriterëve specifike që propozohen në Projekt-Vendim dhe që janë përcaktuar duke marrë parasysh situatën konkrete social-ekonomike të disa nën/kategorive.

*Drejtoresh e Përgjithshme e Drejtorisë
Juridike dhe Burimeve Njerëzore*

Anxhela Qeramixhi (Dishnica)

Drejtore e Kujdesit Social

Mariana Jorgji

**Kryetari i Bashkisë
Sotiraq Filo**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KESHILLI BASHKIAK

P/VENDIM

Nr. _____ datë _____ 2026

Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i buxhetit vendor për vitin 2026.

Duke u mbështetur në Ligjin nr.139, datë 17.12.2015, "Për vetë qeverisjen vendore", Ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026, Ligji nr.57/2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", neni 21, të Udhëzimeve nr. 3, 4, 5,8 datë 17.02.2017, pika 2, të Ministrit të Mirëqënies Sociale, V.K.M Nr.597, datë 04.09.2019, dhe Vendimit Nr.868, datë 29.12.2021 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" i ndryshuar, Administratorët Shoqërorë të Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë, i propozojnë Këshillit të Bashkisë.

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:

I-Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor si më poshtë vijon:

Përfitues të fondit nga buxheti i Pushtetit Vendor do të jenë:

1. Familjet të cilat kanë aplikuar për Ndihmë Ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit.
2. Familja para se të përzgjidhet për tu trajtuar me këtë fond, duhet të jetë verifikuar paraprakisht dhe do të vlerësohet nga Administratorët Shoqërorë.
3. Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jetë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.

4. Familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë ose të lartë.
5. Familje të cilat kanë fëmijë në moshë madhore, me probleme të ndryshme sociale (përdorues të lëndëve narkotike, probleme me ligjin etj.) të cilët kanë vështirësi punësimi.
6. Familje rome-egjiptiane të cilat kanë probleme me transferimin dhe regjistrimin.
7. Familjet me një anëtar që nuk kanë të ardhura ose i kanë të pamjaftueshme.
8. Familje me anëtar në moshë mbi 60-vjeç të cilët kanë në përbërje anëtar mbi moshë pune përfitues të një pensioni pleqërie.
9. Familje në varfëri ekstreme në rast fatkeqësie në pamundësi të përballimit të shpenzimeve.
10. Rastet kur k/familjari ose edhe anëtarë të tjerë madhorë janë të paafitë për të punuar, por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesë Paafitësie.

2-Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet **Drejtoria e Kujdesit Social** dhe **Drejtoria e Financës, buxhetit dhe MFK**

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

KRYETAR

Ana Verushi

Minatuar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KESHILLI BASHKIAK**

VENDIM

Nr. _____ datë _____ 2026

Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i buxhetit vendor për vitin 2026.

Duke u mbështetur në Ligjin nr.139, datë 17.12.2015, "Për vetë qeverisjen vendore", Ligjin nr. 9936 dt.26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligjit nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026, Ligji nr.57/2019, "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë", neni 21, të Udhëzimeve nr. 3, 4, 5,8 datë 17.02.2017, pika 2, të Ministrit të Mirëqënies Sociale, V.K.M Nr.597, datë 04.09.2019, dhe Vendimit Nr.868, datë 29.12.2021 "Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike"i ndryshuar, Administratorët Shoqërorë të Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë, i propozojnë Këshillit të Bashkisë.

**KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:**

I-Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike , nga fondi i buxhetit vendor si më poshtë vijon:

Përfitues të fondit nga buxheti i Pushtetit Vendor do të jenë:

1. Familjet të cilat kanë aplikuar për Ndhmë Ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit.
2. Familja para se të përzgjidhet për tu trajtuar me këtë fond, duhet të jetë verifikuar paraprakisht dhe do të vlerësohet nga Administratorët Shoqërorë.
3. Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jetë pa të ardhura .
4. Familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë ose të lartë.

5. Familje të cilat kanë fëmijë në moshë madhore, me probleme të ndryshme sociale (përdorues të lëndëve narkotike, probleme me ligjin etj.) të cilët kanë vështirësi punësimi.
6. Familje rome-egjiptiane të cilat kanë probleme me transferimin dhe regjistrimin.
7. Familjet me një anëtar që nuk kanë të ardhura.
8. Familje me disa anëtarë në përbërje të së cilës ka anëtar mbi moshë pune përfitues të një pensioni pleqërie.
9. Familje në varfëri ekstreme në rast fatkeqësie në pamundësi të përballimit të shpenzimeve.
10. Rastet kur k/familjari ose edhe anëtarë të tjerë madhorë janë të paafitë për të punuar por për shkak të kritereve të komisionit biopsikosocial nuk përfitojnë pagesë Paafitësie.

2-Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet **Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës, buxhetit dhe MFK**

3- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

KRYETAR

Ana Verushi

Miratur me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë _____



Anty...
...



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

BASHKIA KORÇË

NR 615
DAT 20/01/2026
PROT

DREJTORIA E STREHIMIT SOCIAL DHE MENAXHIMIT TË BANESAVE SOCIALE

RELACION

Korçë, më 16. 01. 2026

“MBI MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA”

Subvencionimi i qirasë është një instrument i programit të strehimit social “Banesa Sociale me Qira” që ndihmon individët dhe familjet, të cilët me të ardhurat e tyre, nuk përballojnë pagesën e qirasë sociale ose të qirasë reale.

Masa e subvencionimit është në varësi të nivelit të të ardhurave të familjes dhe mund të mbulojë deri në 100% të qirasë sociale për familjet pa të ardhura.

Subvencionimi do të kryhet në bashkëfinancim me fonde të siguruar nga buxheti i shtetit nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit (MEI) bazuar në kufijtë e financimit sipas Udhëzimit Nr.31 datë 18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit”, ku thuhet që “financimi nga buxheti i shtetit për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore do të bëhet në varësi të të ardhurave për frymë të NJVV.

Referuar të dhënave të të ardhurave për frymë pwr vitin 2024, Bashkia Korçë kap një nivel të ri ardhurash në masën 8,394 lek, të cilat çojnë kufijtë e financimit në raportin 50% nga buxheti i Bashkisë dhe 50% nga buxheti i shtetit.

Sipas aplikimeve që kanë bërë qytetarët në sistemin on-line të strehimit nëpërmjet portalit unik qeveritar e-Albania për të përfituar nga programet e strehimit social, rezultojnë edhe 4(katër) familje të tjera, të cilat me marrjen e vendimit nga Këshilli Bashkiak për miratimin e listës, do të mbështeten me bonus qiraje për vitin 2026 duke e çuar në 29 numrin e përfituesve. Këto familje janë në përputhje të kushteve dhe kanë plotësuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm sipas ligjit për të përfituar nga bonusi i strehimit si më poshtë vijon:

1- Valbona Romeo Shkëmbi, kategoria minoritet egjiptian, grua kryefamiljare e divorcuar me 3 fëmijë në ngarkim, me ndihmë ekonomike, përfituese edhe në vitin 2025, me kontratë sipas aktit noterial datë 25.02.2025, e cila sipas sistemit të pikëzimit është vlerësuar me 31 pikë. Familja pa të ardhura mbështetet me bonus qiraje në masën 100%.

2- Mariglen Gentian Agushi, aplikues i ri, familje me 4 anëtarë në certifikatë, kategoria PAK për dy pjestarët madhorë në certifikatë dhe me dy fëmijë në ngarkim, me kontratë sipas aktit noterial datë 25.08.2025, i cili sipas sistemit të pikëzimit është vlerësuar me 29 pikë. Familja pa të ardhura mbështetet me bonus qiraje në masën 100%.

3- Simorela Xhemal Lato, aplikuese e re, kategoria familje njëprindërore ku përfshihen dhe vajzat-nëna me 2 fëmijë në ngarkim, me kontratë sipas aktit noterial datë 16.12.2025, e cila sipas sistemit të pikëzimit është vlerësuar me 27 pikë. Familja realizon të ardhura shumë të ulta dhe mbështetet me bonus qiraje në mënyrë të pjesshme, pasi 15% e të ardhurave duhet të përdoret për të përballuar strehimin.

4- Lavdosh Ferman Lila, aplikues i ri, familje me 4 anëtarë, kategoria PAK dhe në kushtet e përfitimit të ndihmës ekonomike, me dy fëmijë në ngarkim, me kontratë sipas aktit noterial datë 16.05.2025, i cili sipas sistemit të pikëzimit është vlerësuar me 25 pikë. Familja pa të ardhura mbështetet me bonus qiraje në masën 100%.

Në mbështetje të:

- Ligjit nr.22/2018, “Për Strehimin Social” i ndryshuar, të neneve 2, 3, 4, 16, 33, 34 dhe 38 të këtij ligji,
- VKM 384 datë 12.06.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu

strehuar sipas njërës prej programeve sociale të strehimit dhe të afatëve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”.

-VKM 362, datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”.

-VKM nr.459 datë 3.07.2019 “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”.

-VKM nr.301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”.

-Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e Strehimit”.

-Ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” i ndryshuar,

-Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore” i ndryshuar,

-Ligjit Nr.87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”

-VKB Nr.97, datë 27.07.2023 “Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve të programit subvencioni i qirasë në tregun e lirë,

-VKB Nr 139, datë 26.12.2025 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2026 dhe të PBA 2027-2028 të Bashkisë Bashkisë Korçë”, referuar dhe nivelit të qirasë mesatare të aprovuar me vendim Nr.131 datë 18.12.2025”Mbi miratimin e vlerës mesatare të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në tregun e lirë” të Këshillit Bashkiak dhe me miratimin e Komisionit të Strehimit, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Korçë të autorizojë:

-Subvencionimin e qirasë për 4(katër) familje aplikante ,sipas tabelës nr.2 bashkangjitur projekt-vendimit.

-Subvencioni i qirasë do t'i jepet përfituesve nga data që lista e përfituesve miratohet me vendim të Këshillit Bashkiak.

Drejtoresha e Strehimit Social dhe
Menaxhimit të Banesave Sociale.

Mirela Balli



Drejtoresha e Financës ,Buxhetit dhe MEK:

Valbona Ziko



KRYETARE E KOMISIONIT TË STREHIMIT

Benila Themeli



Drejtoresha e Përgjithshme Juridike
dhe e Burimeve Njerëzore,

Anxhela (Dishnica) Qeramixhi



KRYETARI I BASHKISË

Sotirag FILO



Tabela nr.2 e relacionit

Lista familjeve që përfitojnë nga subvencionimi i qirasë për vitin 2016

No.	Emri / Alesia / Mbledhori	Kategoria sipas mës. 16, të ligjit nr.22/2018	Përshkrimi	Perfshiria Familjare	Shkëlqimi e Apartamentit	Sipërfaqja e Apartamentit	Circa mes. e qirasë, në lekë, për ardhurat që Likon Familjes	Të ardhurat familjare mujore	Kategoria (sipas përkusht. 45. e rendit 2, të ligjit 22/2018)	Aftësia përballëse sipas rendit 3 të ligjit	Circa e përballëshmërisë (l*)	Subvencioni në muaj (g-k)	Subvencioni në muaj që mbledhet nga bashkia (g,l*)	Shuma që kërkohej nga buxheti (0,l*)
8	b	c	d	e	f	g	h	i	j	k	l	m	n	
1	Valbona Remio Shkëmbi	C10	31	4	1+1	59	13,610	0	pa të ardh.	0%	0	13,610	6,805	6,805
2	Martigjen Gentian Agushi	C1	29	4	1+1	60	12,000	0	pa të ardh.	0%	0	12,000	6,000	6,000
3	Simonele Xhemal Laco	B1	27	3	1+1	63	13,610	38,716	sh të ulin	15%	5,807	7,803	3,901	3,901
4	Lavdosha Feriun Lila	C1	25	4	2+1	84	15,000	0	pa të ardh.	0%	0	15,000	7,500	7,500
	Shuma Mujaletë												24,206	24,206
	Shuma Vjetore/ lekë 11muaj												266,266	266,266
														532,532

Drejtor e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale

Mirela Balli





REPUBLIKA E SHQIPËRIË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË

P/VENDIM

Nr _____, datë _____ 2026

“MBI MIRATIMIN E SUBVENCIONIMIT TË QIRASË PËR FAMILJET E PASTREHA”.

Bazuar në Ligjin nr.22/2018, “Për Strehimin Social ”i ndryshuar, në nenet 2,3, 4, 16, 33, 34 dhe 38 të këtij ligji, “VKM 384 datë 12.06.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit që duhet të paraqesë familja për tu strehuar sipas njërës prej programeve sociale të strehimit dhe të afateve, procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”, në VKM 362 , datë 29.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”, Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 “Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e Strehimit”, VKM nr.301, datë 15.04.2020 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”, Ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetqeverisjes vendore”, i ndryshuar Ligjit Nr.87/2025 “Për buxhetin e vitit 2026”, VKB Nr.97 datë 27.07.2023 “Mbi miratimin e sistemit të pikëzimit për përzgjedhjen e përfituesve të programit subvencioni i qirasë në tregun e lirë, VKB Nr.131 datë 18.12.2025 “Mbi miratimin e vlerës mesatare të subvencionimit të qirasë dhe të nivelit të qirasë mesatare në tregun e lirë”, VKB Nr.139 datë 26.12.2025 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2026 dhe të PBA 2027-2028 të Bashkisë Bashkisë Korçë” dhe me miratimin e Komisionit të Strehimit, bazuar dhe në relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Strehimit Sociale Menaxhimit të Banesave Sociale dhe me miratimin e Komisionit të Strehimit, Këshilli Bashkiak Korçë

VENDOSI:

1. Të miratojë përfitues nga programi i “Subvencionimit të Qirasë” 4(katër) familje aplikante, sipas tabelës bashkëngjitur.
2. Subvencioni i qirasë do t’i jepet përfituesve që nga data e miratimit të listës bashkëngjitur nga Këshilli Bashkiak.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale dhe Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

KRYETAR
Ana VERUSHI

Miratuar me _____ vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____

Tabela nr.2 Projekt-Vendimi

Lista familjeve që përfitojnë nga Subvencionimi i Qirave 2026

Nr.	Emri / Atesia / Mbiemri	Kategoria sipas nenit 16, të ligjit nr.22/2018 dhe piket e sistemit	Përberja Familjare	Struktura e Apartamentit	Sipërfaqe e Apartamentit	Qiraja maks. e apart. në treg për struktura të takon familja	Të ardhurat familjare mujore	Kategoria (sipas pikës 45, e nenit 2, të ligjit 22/2018)	Aftësia përballuese sipas nenit 3 të ligjit	Qiraja e përballueshme (h*)	Subvencioni në muaj	Subvencioni në muaj që mbulohet nga bashkia (0.5*)	Shuma që kërkohet nga buxheti (0.5*)
a	b	c	d	e	f	g	h	i	j	k	l	m	n
1	Valbona Romeo Shkëmbi	C10	4	1+1	59	13,610	0	pa.te.ardh	0%	0	13,610	6,805	6,805
2	Mariglen Gentian Agushi	C1	4	1+1	60	12,000	0	pa.te.ardh	0%	0	12,000	6,000	6,000
3	Simorela Xhemal Lato	B1	3	1+1	63	13,610	38,716	sh.te.ulta	15%	5,807	7,803	3,901	3,901
4	Lavdosha Ferman Lila	C1	4	2+1	84	15,000	0	pa.te.ardh	0%	0	15,000	7,500	7,500
	Shuma Mujore/leke											24,206	24,206
	Shuma Vjetore/leke 11 muaj											266,266	266,266
													532,532

KRYETAR
Ana VERUSHI



*Arbërie
social*



REPUBLIKA E SHQIPËRIE

BASHKIA KORÇE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE
MENAXHIMIT TË KONTRATAVE

DREJTORIA E STREHIMIT SOCIAL DHE MENAXHIMIT TË BANESAVE SOCIALE
DREJTORIA E FINANCËS, BUXHETIT DHE MFK
DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE

BASHKIA KORÇE

NR 506 PROT
DAT 19/01/2026

Nr. _____ prot

Datë _____

**RELACION
PËR MIRATIMIN E FONDIT PUBLIK TË BANESAVE SOCIALE DHE
PËRDORIMIN E TIJ NË BUXHETIN E VITIT 2026**

Në zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, subjektet private që aplikojnë për leje zhvillimi/ndërtimi kanë detyrimin të kontribuojnë në krijimin e fondit publik të banesave sociale. Ky kontribut përlogaritet mbi sipërfaqen funksionale të banimit për objekte banimi mbi 2,000 m², duke marrë 3% të saj, e cila jepet në sipërfaqe (m²) ose në vlerë monetare, sipas çmimit referues të zonës. Për llogaritjen e këtij detyrimi, Bashkia është bazuar në Vendimin nr. 325, datë 29.05.2024, "Për përcaktimin e rregullave për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale". Në pikën 2 të këtij vendimi parashikohet se, në kontratën paraprake që lidhet midis njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe subjektit privat që aplikon për leje zhvillimi/ndërtimi, përcaktohet forma e dhënies së kontributit në sipërfaqe (m²) ose në vlerë monetare duke u referuar çmimeve përkatëse të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa" për zonën ku realizohet ndërtimi.

Llogaritja mbështetet mbi sipërfaqen e përgjithshme funksionale të objektit të banimit.

Në praktikë, vendimmarrja për lejet e ndërtimit kryhet rast pas rasti, dhe kontributi prej 3% përcaktohet duke u bazuar në sipërfaqen totale funksionale të banimit brenda objektit. Për objektet me destinacion "Banim dhe Shërbim", përlogaritja realizohet duke marrë sipërfaqen totale të lejes së ndërtimit, prej së cilës zbriten sipërfaqet e njësive të biznesit, sipërfaqet e bodrumeve dhe çdo hapësirë tjetër që nuk lidhet drejtpërdrejt me funksionin e banimit. Nga sipërfaqja e mbetur që përbën sipërfaqen totale funksionale të banimit përlogaritet përqindja 3% që përfaqëson kontributin e detyrueshëm të subjektit privat në fondin publik të banesave sociale.

Për këtë arsye në buxhetin e vitit 2026 do të kryhet rritja e planifikimit të të ardhurave, me qëllim që buxheti të reflektojë në mënyrë transparente dhe të saktë të gjitha detyrimet që subjektet private do të realizojnë në periudhën në vijim dhe përdorimin e tyre.

Bazuar në analizën e lejeve të ndërtimit që kanë afat përfundimtar brenda vitit 2026 dhe në përlogaritjet përkatëse të sipërfaqeve funksionale të banimit, vlera e kontributit të detyrueshëm prej 3% që pritet të arketohet është: **26,000,000 (njëzet e gjashtë milion) lekë**

Kjo shumë përfaqëson të ardhurat që do të realizohen nga kontratat paraprake të lidhura apo që priten të lidhen gjatë vitit 2026 sipas VKM nr. 325/2024 "Për përcaktimin e rregullave për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale" dhe nga zbatimi i plotë i detyrimit të përcaktuar në nenin 19 të ligjit nr 22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar.

Ndryshimi i propozuar në buxhetin e Bashkisë synon të pasqyrojë në mënyrë të saktë dhe realiste nivelin e të ardhurave që do të mblidhen nga kontributi i sektorit privat për fondin e banesave sociale. Ky veprim siguron përputhshmëri me kuadrin ligjor, rrit transparencën buxhetore dhe krijon mundësi konkrete për rritjen e stokut të banesave sociale, në funksion të nevojave të komunitetit. Fondi prej

- 26,000,000 lekësh, do të përdoren për ndërtimin e banesave sociale në programin Përkujdesi Social dhe funksionin e strehimit social.

Duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, ligjin 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", ligjin nr. 22/2018 "Për strehimin social" i ndryshuar, VKM nr. 325/2024 "Për përcaktimin e rregullave për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale", si dhe VKB nr. 139 datë 26.12.2025 "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028 të Bashkisë Korçë", kërkojmë nga Këshilli Bashkiak të miratojë rritjen e planit të të ardhurave për krijimin e fondit publik të banesave sociale dhe përdorimin e tij për ndërtimin e banesave sociale, me këtë strukturë buxhetore:

SHTOHET Prog. AI122 00 Prod. P066AAK 05 Art. 2310000 +26,000,000 lekë

DREJTORIA E FINANCËS
BUXHETIT DHE MK

Valbona Ziko

DREJTORIA E TAKSAVE DHE
TARIFAVE VENDORE

Soniël Prifti

DREJTORIA E STREHIMIT SOCIAL DHE
MENAXHIMIT TË BANESAVE SOCIALE

Mirela Balli

DREJTORIA E PËRGJITHSHME
JURIDIKE DHE TË BURIMEVE NJERËZORE

Anxhela Qeramixhi (Dishnica)

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT
DHE MENAXHIMIT TË KONTRATAVE
Ndriçim Hoxha

KRYETARI I BASHKISË

SOTIRAQ FLO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr. _____ Datë _____

**PËR MIRATIMIN E FONDIT PUBLIK TË BANESAVE SOCIALE DHE
PËRDORIMIN E TIJ NË BUXHETIN E VITIT 2026**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë materialin e paraqitur nga Ekzekutivi, duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, ligjin 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", ligjin nr. 22/2018 "Për strehimin social", i ndryshuar, VKM nr. 325/2024 "Për përcaktimin e rregullave për kontributin e sektorit privat në krijimin e fondit publik të banesave sociale", si dhe VKB nr. 139 datë 26.12.2025 "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028 të Bashkisë Korçë", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë rritjen e planit të të ardhurave për krijimin e fondit publik të banesave sociale në vlerën 26,000,000 lekë.
2. Të miratojë përdorimin e tij për ndërtimin e banesave sociale, me këtë strukturë buxhetore:
SHTOHET Prog. AI122 00 Prod. P066AAK 05 Art. 2310000 +26,000,000 lekë

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave, Drejtoria e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale, Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK, si dhe Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

KRYETAR

Ana Verushi

Miraturar me _____vota
Vota Pro _____
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____



*Antetë
me*



BASHKIA KORÇE

NR 448
DAT 15/01/2006
PROT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
DREJTORIA E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE**

**RELACION
PËR VLERËSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME TË TË ARDHURAVE
PËR VITET 2027-2029**

Në zbatim të kuadrit ligjor që rregullon funksionimin, administrimin financiar dhe proceset e planifikimit në pushtetin vendor, Bashkia Korçë ka detyrimin të paraqesë pranë Këshillit të Bashkisë raportin mbi vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave. Ky detyrim i ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si edhe ligjit nr. 68, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore". Procesi është formalizuar edhe në VKB nr. 118, datë 27.11.2025, "Për miratimin e kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 dhe të buxhetit vjetor 2027 të Bashkisë Korçë", duke përcaktuar qartë afatet, hapat dhe përgjegjësitë institucionale.

Hartimi i këtij raporti përbën një proces të strukturuar dhe të domosdoshëm, i cili siguron jo vetëm përputhshmërinë me kërkesat ligjore, por edhe bazën mbi të cilën ndërtohet planifikimi financiar afatmesëm i bashkisë. Përgatitja e raportit mbështetet në një sërë aktesh ligjore dhe nënligjore, të cilat orientojnë mënyrën e administrimit të të ardhurave vendore, kriteret e vlerësimit, procedurat e mbledhjes dhe elementët e kontrollit e transparencës.

Baza ligjore që udhëheq këtë proces përfshin:

1. **Ligjin nr. 9632, datë 30.01.2006, "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar**, i cili përcakton llojet e taksave vendore, mënyrën e llogaritjes, subjektet taksapaguese dhe kompetencat e njësive të vetëqeverisjes vendore në administrimin e tyre.
2. **Ligjin nr. 9920, datë 26.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar**, që rregullon procedurat e regjistrimit, deklarimit, mbledhjes dhe kontrollit të detyrimeve tatimore, duke ndikuar drejtpërdrejt edhe mbi administrimin lokal të të ardhurave.
3. **Ligjin nr. 68/2017, "Për financat e vetëqeverisjes vendore"**, ku përcaktohen rregullat për buxhetimin afatmesëm, burimet e financimit, parimet e menaxhimit fiskal dhe raportimin e performancës financiare.
4. **Ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore"**, që sanksionon kompetencat dhe përgjegjësitë e bashkive, përfshirë detyrimin për hartimin dhe miratimin e dokumenteve të planifikimit financiar.
5. **Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"**, i ndryshuar, që përcakton standardet për sigurimin e një administrimi të përgjegjshëm, efikas dhe të kontrolluar të fondeve publike.
6. **Ligjin nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar.**
7. **Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 119, datë 27.11.2025, "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Korçë dhe penalitetet për shkeljet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2026"**, i cili përbën instrumentin kryesor rregullator për strukturën dhe administrimin e të ardhurave vendore.
8. **Të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore të tjera** që plotësojnë dhe mbështesin procesin e mbledhjes, administrimit dhe planifikimit të të ardhurave.

Kombinimi i këtij kuadri të gjerë ligjor garanton që procesi i përgatitjes së raportit të jetë i bazuar në standarde të qarta, në procedura të harmonizuara dhe në një qasje të qëndrueshme ndaj planifikimit financiar afatmesëm. Përmes tij, Bashkia Korçë siguron transparencë, përgjegjshmëri dhe saktësi në vlerësimin e potencialit të të

ardhurave, duke krijuar themelet për një buxhet të besueshëm dhe një administrim më efikas të financave vendore.

Politikat e hartimit të raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme

Në hartimin e raportit për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme është ndjekur një qasje e qartë dhe e strukturuar, e mbështetur në politikat fiskale ekzistuese dhe në analizën e ecurisë së të ardhurave ndër vite. Procesi është zhvilluar mbi supozimin se politikat fiskale do të mbeten të pandryshuara përgjatë periudhës trevjeçare, duke mundësuar një projeksion realist dhe të qëndrueshëm për financat vendore. Nëse do ketë ndryshime në legjislacion këto do të reflektohen në periudhat pasuese Ky dokument synon të ofrojë një pasqyrë të besueshme të zhvillimeve të pritshme ekonomike dhe fiskale, duke u mbështetur në të dhëna të verifikuara dhe në një metodologji të standardizuar.

Në këtë kuadër, raporti është hartuar duke garantuar qëndrueshmërinë financiare të Bashkisë dhe rritjen e efikasitetit në menaxhimin e burimeve publike. Përmes planifikimit afatmesëm, dokumenti shërben si një instrument i rëndësishëm që integron objektivat politike dhe zhvillimore në procesin buxhetor, duke siguruar koherencë mes prioritetëve dhe projeksioneve financiare.

Një tjetër element thelbësor i procesit ka qenë rritja e efikasitetit në mbledhjen e të ardhurave, duke shfrytëzuar në maksimum kapacitetin e bazës së taksueshme dhe potencialin administrativ të strukturave vendore. Në këtë drejtim, është vënë theksi edhe tek forcimi i administratës tatimore vendore, si në aspektin profesional ashtu edhe në atë teknologjik, për të garantuar një performancë më të lartë në menaxhimin e detyrimeve.

Raporti merr në konsideratë gjithashtu përmirësimin e kushteve të biznesit, duke synuar thjeshtimin e procedurave tatimore dhe krijimin e lehtësive që nxisin zhvillimin ekonomik lokal. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar përditësimit të vazhdueshëm të bazës së të dhënave, i cili mbetet një faktor kyç për rritjen e cilësisë së vlerësimeve dhe parashikimeve fiskale.

Procesi është konceptuar duke përfshirë edhe dimensionin e pjesëmarrjes qytetare, si një komponent i rëndësishëm në vendimmarrjen vendore dhe në përcaktimin e prioritetëve të zhvillimit. Po ashtu, është theksuar nevoja për forcimin e mekanizmave të mbledhjes së të ardhurave debitore, me qëllim reduktimin e detyrimeve të prapambetura dhe përmirësimin e disiplinës fiskale.

Në tërësi, politikat e ndjekura në hartimin e raportit pasqyrojnë një qasje të qëndrueshme, transparente dhe orientuese, e cila synon të sigurojë menaxhim efektiv të financave vendore dhe të krijojë bazën e duhur për zhvillim të balancuar ekonomik dhe social të Bashkisë në afatin afatmesëm.

Parashikimi i të ardhurave

Parashikimi i të ardhurave për Bashkinë Korçë mbështetet në parimet dhe drejtimet fiskale të përcaktuara në Paketën Fiskale të miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 119, datë 27.11.2025. Ky dokument përbën bazën e administrimit fiskal në territorin e bashkisë, pasi përcakton jo vetëm llojet e taksave dhe tarifave vendore, por edhe mënyrën se si ato përllogariten, kategorizohen dhe vlerësohen. Nëpërmjet tij ngrihet një sistem i qartë dhe i standardizuar për mbledhjen e detyrimeve vendore, përfshirë afatet, kështet e pagesës, lehtësitë fiskale, si dhe strukturat përgjegjëse për administrimin dhe kontrollin e tyre.

Ky kuadër rregullator nuk është vetëm një listë detyrimesh, por një mekanizëm funksional që udhëheq marrëdhënien ndërmjet Bashkisë dhe kontribuesve. Përmes detajimit të çdo takse e tarife, nga baza e taksueshme e deri te agjentët tatimorë. Paketa fiskale synon të krijojë transparencë, drejtësi dhe efikasitet në administrimin e burimeve financiare vendore, që i jep Bashkisë mundësinë të planifikojë më saktë të ardhurat, ndërkohë që i garanton qytetarëve dhe bizneseve një proces të qartë e të parashikueshëm.

Në hartimin e parashikimit afatmesëm për vitet 2027–2029, Bashkia ka synuar të vendosë në qendër një shpërndarje më të drejtë të barrës fiskale. Qasja konsiston në uljen e ngarkesës për kategori dhe grupe të caktuara, duke reflektuar një filozofi fiskale më sociale dhe proporcionale. Vlerësimi realist i kapaciteteve të burimeve vendore shërben për të identifikuar potencialet e zhvillimit dhe për të orientuar vendimmarrjen drejt objektivave të qëndrueshme afatmesme.

Kjo mënyrë planifikimi i jep Bashkisë Korçë mundësinë të ndërtojë një buxhet të besueshëm, duke garantuar jo vetëm rritje të të ardhurave, por edhe përmirësim të cilësisë së përdorimit të tyre. Përmes një parashikimi më të matur dhe më të lidhur ngushtë me realitetin ekonomik, synohet që burimet vendore të kthehen në motor zhvillimi; në rritje të shërbimeve publike, në investime komunitare dhe në rritjen e efikasitetit institucional. Në këtë mënyrë, parashikimi i të ardhurave nuk mbetet thjesht një ushtrim financiar, por shndërrohet në një proces strategjik që udhëheq zhvillimin e ardhshëm të Bashkisë Korçë, duke kombinuar saktësinë teknike me vizionin afatgjatë.

Metodat e parashikimit të nivelit të të ardhurave në parashikimin afatmesëm:

Ecuria e të ardhurave vendore gjatë viteve të fundit ka qenë një tregues i qartë i ritmeve të zhvillimit financiar dhe administrativ të Bashkisë Korçë. Trendi i realizimit për periudhën 2024–2025 ka shërbyer si bazë analitike për hartimin e parashikimit afatmesëm, duke reflektuar jo vetëm kapacitetet aktuale të mbledhjes, por edhe dinamikën e sjelljes fiskale të kontribuesve dhe ndikimin që kanë pasur politikat vendore. Këto dy vite kanë dëshmuar një stabilizim të prurjeve dhe një rritje të lehtë progresive, e cila krijon terrenin e nevojshëm për ndërtimin e një projekcioni realist për vitet në vijim.

Në këtë kontekst, zgjerimi i bazës së kapaciteteve fiskale është rezultat i drejtpërdrejtë i politikave të miratuara në nivel vendor, të cilat kanë synuar forcimin e sistemit të administrimit dhe përmirësimin e mekanizmave të kontrollit dhe formalizimit. Vendimet e miratuara nga Këshilli i Bashkisë kanë qenë një instrument thelbësor në këtë proces, duke orientuar dhe strukturuar mënyrën e mbledhjes së të ardhurave, rishikimit të kategorive tatimore dhe harmonizimit të praktikave administrative. Këto reforma kanë kontribuar jo vetëm në rritjen e transparencës, por edhe në rritjen e ndërgjegjësisë dhe përfshirjes së kontribuesve në procesin fiskal.

Duke u mbështetur në këtë performancë dhe në masat e marra, parashikimi për periudhën 2027–2029 synon të reflektojë një ecuri të qëndrueshme dhe të matur të zgjerimit të bazës fiskale. Analiza e kryer tregon se të ardhurat vendore pritet të rriten gradualisht, duke arritur në vitin 2029 një nivel gjithsej 30,224 mijë lekësh më të lartë se plani i vitit 2026, me një mesatare vjetore rritjeje prej rreth 10,075 mijë lekësh. Ky projektion përfshin të gjitha burimet vendore – taksa, tarifa dhe të ardhura të tjera – të cilat janë planifikuar të rriten me rreth 1% në vit, duke reflektuar ritmet reale të zhvillimit ekonomik dhe kapacitetet aktuale të administrimit fiskal.

Në vijim të parimit të realizimit financiar, parashikimi merr në konsideratë edhe të dhënat faktike të mbledhura në dy vitet e fundit, si dhe detyrimet debitore të krijuara ndër vite, për të cilat llogariten vetëm periudhat e vlefshme prej 18 muajsh nga momenti i faturimit. Kjo metodologji siguron që të ardhurat e planifikuara të mos mbështeten së shumti në pritshmëri të fryra apo të pasigurta, por në burime të verifikuara dhe të dokumentuara.

Në tërësi, parashikimi i të ardhurave vendore synon të sjellë më shumë transparencë, koherencë dhe saktësi në menaxhimin financiar të Bashkisë Korçë. Ai reflekton jo vetëm ambicien për rritje të qëndrueshme të burimeve, por edhe vullnetin institucional për të përmirësuar vazhdimisht performancën e administrimit fiskal. Kjo qasje strategjike krijon një bazë të fortë për planifikimin e buxhetit në vitet e ardhshme dhe për garantimin e shërbimeve cilësore për komunitetin.

Në këtë parashikim janë marrë parasysh lehtësimet dhe përjashtimet të cilat do të aplikohen gjatë vitit 2026 :

- Të gjitha subjektet të cilat bazuar në dokumentacionin ligjor vërtetojnë se gjatë vitit parardhës kanë pasur mesatarisht për harkun kohor 12 mujor mbi 20 të punësuar rezidentë në Bashkinë e Korçës, do të paguajnë 20% më pak të ngarkesës totale për tarifat vendore të vitit 2026 vetëm për selinë administrative të subjektit .
- Të gjitha subjektet të cilat bazuar në dokumentacionin ligjor vërtetojnë se gjatë vitit paraardhës kanë pasur mesatarisht për harkun kohor 12 mujor mbi 50 të punësuar rezidentë në Bashkinë e Korçës, do të paguajnë 50% më pak të ngarkesës totale për tarifat vendore të vitit 2026 vetëm për selinë administrative të subjektit .
- Të gjitha subjektet të cilat operojnë në fushën e bar-restorant, piceri, e.t.j të ngjashme me to, të cilat brenda ambientit në të cilin ushtrojnë aktivitetin e tyre do të krijojnë dhe ambiente argëtimi dedikuar fëmijëve sipas rregullores së përcaktuar do të paguajnë 20% dhe 50% më pak të ngarkesës totale për tarifat

vendore të vitit 2026. Përfitues në këtë rast do të jenë 10 subjektet e para të cilat do të aplikojnë dhe do të plotësojnë kushtet referuar vlerësimit të komisionit të posatshëm.

- Të gjitha organizatat jofitimprurëse të cilat objekt kryesor të veprimtarisë së tyre kanë aktivitetet sportive do të paguajnë 50% më pak të ngarkesës totale për tarifat vendore të vitit 2026.
- Të gjitha subjektet të cilat ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e institucioneve arsimore private si dhe ato subjekte që do të ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e arsimit privat plotësues ose jo-plotësues, organizimit të trajnimeve dhe kualifikimeve në fusha të ndryshme profesionale do të paguajnë 20% më pak të ngarkesës totale për tarifat vendore të vitit 2026.
- Përfashtohen nga pagesa e tarifave për vitin 2026 të gjitha subjektet të cilat do të zhvillojnë për herë të parë aktivitet dhe regjistrohen nga studentë të diplomuar në universitete brenda dhe jashtë vendit gjatë 2 viteve paraardhëse.
- Përfashtohen nga pagesa e tarifave për vitin 2026 të gjithë subjektet që do të regjistrojnë dhe ushtrojnë për herë të parë aktivitetin e tyre në fushën e artizanatit.
- Përfashtohen nga pagesa e tarifave për vitin 2026 dhe atë pasardhës të gjithë subjektet që do të regjistrohen nga vajzat dhe gratë e moshës **19-30 vjeç** dhe ushtrojnë për herë të parë aktivitetin e tyre në fushën e artizanatit.
- Përfashtohen nga pagesa e tarifave për vitin 2026 dhe atë pasardhës të gjithë subjektet që do të regjistrohen nga **gratë viktimat të dhunës në familje**, të cilat janë të **pajisura me vendim gjykatë ose urdhër mbrojtjeje**.
- Përfashtohen nga pagesa e tarifave për vitin 2026, për selinë administrative të gjitha subjektet të cilat bazuar në dokumentacionin ligjor vërtetojnë se gjatë vitit paraardhës kanë pasur mesatarisht për harkun kohor 12 mujor mbi 100 të punësuar rezidentë në Bashkinë e Korçës.
- Përfashtohen nga pagesa e tarifave për vitin 2026 të gjithë investitorët e huaj që do të hapin dhe zhvillojnë për herë të parë aktivitetin e tyre në Bashkinë e Korçës.
- Përfashtohen nga pagesa e tarifave për vitin 2026 të gjithë subjektet që do të regjistrojnë dhe ushtrojnë për herë të parë aktivitetin e tyre në fushën e ICT (teknologji e informacionit), aktivitetin e tyre në fushën e institucioneve arsimore private si dhe ato subjekte që do të ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e arsimit privat plotësues ose jo-plotësues, organizimit të trajnimeve dhe kualifikimeve në fusha të ndryshme profesionale.
- Përfashtohen nga pagesa e tarifave për vitin 2026 të gjithë Komunitetet fetare të njohura me ligj, organizatat jofitimprurëse që objekti kryesor i aktivitetit të tyre është me karakter fetar, organizatat jofitimprurëse përfaqësuese rinore, që synojnë mobilizimin, vetëorganizimi dhe fuqizimin e të rinjve në shoqëri, nxitjen e tyre për tu bërë pjesë e jetës integrale.
- Përfashtohen nga pagesa e tarifave për vitin 2026 të gjithë fermerët që janë regjistruar me NIPT sipas vërtetimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore sipas udhëzimit Nr. 19, datë 3.11.2014, "Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar"
- Përfashtohen nga pagesa e tarifave për vitin 2026 subjektet dhe organizatat në pronësi të Bashkisë Korçë, ndërmarrjet e varësisë së Bashkisë Korçë, institucionet që shpenzimet operative ia mbulon vetë Bashkia Korçë.
- Përfashtohen nga pagesa e tarifave vendore familjare (pastrim, ndriçim, gjelbërim) për vitin 2026 të gjitha familjet jo efektive të cilat pas verifikimeve të përsëritura nga administrata e lagjeve për njësinë administrative Korçë dhe nga njësitë respektive për njësitë e tjera administrative nuk gjenden në banesë dhe nuk banojnë në adresën e deklaruar.
- Përfashtohen nga pagesa e tarifave vendore familjare (pastrim, ndriçim) për vitin 2026 të gjitha familjet në fshatrat e njësisë administrative në të cilat nuk kryhen këto shërbime.
- Përfashtohen nga pagesa e tarifave (pastrim, ndriçim, gjelbërim) për vitin 2026 të gjithë familjet kryefamiljari e të cilave përfiton ndihmë ekonomike
- Përfashtohen nga pagesa e tarifave (pastrim, ndriçim, gjelbërim) për vitin 2026 të gjithë familjet kryefamiljari e të cilave përfiton statusin e verbërisë.
- Përfashtohen nga pagesa e tarifave (pastrim, ndriçim, gjelbërim) për vitin 2026 të gjithë familjet kryefamiljari e të cilave përfiton statusin e para-tetra plegjisë.

- Përfshihen nga pagesa e tarifave për vitin 2026 të gjithë familjet kryefamiljari i të cilave përfiton vetëm pension pleqërie / pension social kur familja përbëhet vetëm nga 1 pensionist.
- Përfshihen nga pagesa e tarifave për vitin 2026 të gjithë organizatat jofitimprurëse që do të regjistrojnë dhe ushtrojnë për herë të parë aktivitetin e tyre në Bashkinë e Korçës.
- Përfshihen nga pagimi i taksës mbi ndërtesën për vitin 2026 të gjitha ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë.
- Përfshihen nga pagimi i taksës mbi ndërtesën për vitin 2026 të gjitha ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike.

Struktura e të ardhurave për vitin buxhetor aktual dhe parashikimin për periudhën 2027 - 2029.

Emërtimi	në mijë lekë			
	Planifikim viti 2026	Parashikim viti 2027	Parashikim viti 2028	Parashikim viti 2029
Të ardhura nga taksat	735,177	739,729	744,326	748,969
Të ardhura nga tarifat	457,018	461,588	466,204	470,866
Të ardhura të tjera	85,265	86,118	86,979	87,849
Totali	1,277,460	1,287,435	1,297,509	1,307,684

Nëpërmjet grafikut të mëposhtëm po ilustrojmë peshën që zënë taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera kundrejt totalit të të ardhurave të veta të parashikuara për vitin 2026 :



Struktura e burimit të të ardhurave vendore në vitet e fundit ka krijuar një stabilitet pothuajse të qëndrueshëm ndikuar nga politikat fiskale të ndërmara ndër vite dhe pothuajse është e pandryshueshme në rritje me nivelin e të ardhurave pasi rritjet janë propocionale në të njëjtin nivel.

- Nga analiza e strukturës së burimeve vendore arrihet në përfundimin se të ardhurat nga taksat vendore zënë një peshë të konsiderueshme dhe përbëjnë burimin kryesor të të ardhurave vendore në 57.55% të totalit.

Paraqitja grafike:



Kategoritë e taksave që ndikojnë më shumë në planin e të ardhurave për vitin 2026 janë:

- Taksa mbi pasuritë e paluajtëshme (ndërtesë, truall, tokë bujqësore) e cila zë rreth **21.7 %** të planit në total:
 - a) Taksë ndërtese zë 15.5 % të planit
 - b) Taksë mbi truallin zë 2 % të planit
 - c) Taksë mbi tokën bujqësore zë 4.2 % të planit
- Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja dhe legalizimet të cilat zënë rreth **23.5 %** të planit në total,
- Struktura e burimit të të ardhurave vendore nga tarifat vendore të parashikuara zënë 36 % të totalit.

Paraqitja grafike :



Kategoritë e tarifave që ndikojnë më shumë në planin e të ardhurave për vitin 2026 janë:

- Tarifa e pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit, mirëmbajtjes së varrezave publike të cilat zënë rreth **24.9 %** të planit në total:
 - 1) Tarifa e pastrimit zë 15.5 % të planit
 - 2) Tarifa e ndriçimit zë 4.9 % të planit
 - 3) Tarifa e gjelbërimit zë 3.1 % të planit
 - 4) Tarifa e mirëmbajtjes së varrezave publike zë 1.3 % të planit

- Tarifa për zënien e hapësirës publike, tarifa e parkimit dhe tarifa vjetore e shërbimit dhe mirëmbajtjes të rrugëve të parcelave dhe të sistemit kullues të cilat zënë rreth 6 % të planit në total:

- 1) Tarifa për zënien e hapësirës publike zë 1.9 % të planit
- 2) Tarifa e parkimit zë 1.8 % të planit
- 3) Tarifa vjetore e shërbimit dhe mirëmbajtjes të rrugëve të parcelave dhe të sistemit kullues zë 2.2 % të planit.

- Struktura e burimit të të ardhurave vendore nga të ardhurat e tjera të parashikuara zënë 7 % të totalit.

Paraqitja grafike :



Kategoritë e taksave të ndara që ndikojnë më shumë në planin e të ardhurave për vitin 2026 janë:

- Të ardhurat nga taksat e ndara (taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve, tatim shitje pasuri e paluajtëshme, tatim mbi të ardhurat personale) të cilat zënë rreth 10.6% të planit në total:

- 1) Taksa e regjistrimit të përvitshëm të automjeteve zë 4.7 % të planit
- 2) Tatim shitje pasuri e paluajtëshme 2 % të planit
- 3) Tatim mbi të ardhurat personale 3.8 % të planit

Bashkëngjitur këtij relacioni po ju vëmë në dispozicion tabelën me parashikimet afatmesme të të ardhurave për periudhën 2027-2029.

**DREJTORI DREJTORISË
TË TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE**

Soniel Prifti

**DREJTORE E DREJTORISË SË PËRGJITHSHME
JURIDIKE DHE TË MENAXHIMIT
TË BURIMEVE NJERËZORE**

Anxhela (Dishmeca) Qeramixhi

**DREJTORE E DREJTORISË SË FINANCËS
BUXHETIT DHE M.F.K**

Valbona Ziko

KRYETARI I BASHKISË

Sotirag Filo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI BASHKIAK

P/V E N D I M

Nr. _____ datë _____ 2026

**“PËR VLERËSIMET DHE PARASHIKIMET AFATMESME TË TË ARDHURAVE
PËR VITET 2027-2029”**

Këshilli i Bashkisë Korçë, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe M.F.K, bazuar në dispozitat e ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 9936 dt. 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, si dhe V.K.B nr. 118 datë 27.11.2025 “Për miratimin e kalendarit të Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 dhe të buxhetit vjetor 2027 Bashkia Korçë”.

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI

1. Të miratojë vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave sipas tabelës nr. I bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet ekzekutivi i Bashkisë dhe Institucionet e Vartësisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

Miratur me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

K R Y E T A R

Ana VERUSHI

Tabella 1 : Parashikimi i të ardhurave afatmesme të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore për vitet 2027-2029

	Kodi	Emërtimi
Njësia e Vetëqeverisjes Vendore	122	Korçë

Ne mijë lekë

Nr	Emërtimi i të Ardhurave Tatimore	Realizim viti 2024	Realizim viti 2025	Planifikim viti 2026	Parashikim viti 2027	Parashikim viti 2028	Parashikim viti 2029
I.	Të ardhura nga taksa	377,721	421,431	738,177	739,729	744,326	748,969
1	Taksa mbi Ndërrimet	131,333	156,288	197,708	199,685	201,682	203,699
2	Taksa mbi trashitjen	19,967	15,021	26,043	26,303	26,566	26,832
3	Taksa mbi taksën bujqësore	26,432	25,742	53,311	53,844	54,383	54,926
4	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pajisje e pajisje	7,634	13,651	26,000	26,260	26,523	26,788
5	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	51,043	54,440	60,000	60,600	61,206	61,818
6	Tatim i detyrueshëm mbi fitimin për biznesin e vogël	1,552	0	0	0	0	0
7	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	78,544	95,003	280,000	280,000	280,000	280,000
8	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet	6,727	7,806	20,085	20,286	20,489	20,694
9	Taksa e fjetjes në hotel	8,901	10,187	10,793	10,901	11,016	11,120
10	Taksa e tabeles	8,335	10,273	11,937	12,056	12,177	12,299
11	Ikenta minerare	258	186	300	303	306	309
12	Tatimi mbi të ardhurat personale	35,574	32,834	49,000	49,490	49,985	50,485
14	Dividenti nga KRW/M	1,421	0	0	0	0	0
II.	Të ardhura nga tarifat	333,783	406,669	457,018	461,588	466,204	470,866
1	Tarifë për pajisje	166,159	170,486	198,608	200,594	202,600	204,626
2	Tarifë ndërrimi	47,786	51,129	62,570	63,196	63,828	64,466
3	Tarifë gjelbërimi	30,879	33,106	39,736	40,133	40,533	40,940
4	Tarifë servisi	806	0	1,087	1,098	1,109	1,120
5	Tarifë regjistrimi për leje transporti	1,476	1,296	1,610	1,626	1,642	1,659
6	Tarifa parkimi	19,522	19,126	23,539	23,774	24,012	24,252
7	Tarifë mbi permatat	759	773	3,000	3,030	3,060	3,091
8	Tarifë vendore për shqyrtim leje zhvillimi	450	525	1,200	1,212	1,224	1,236
9	Tarifa për zbatim e hapësirave publike	21,723	18,999	24,528	24,773	25,021	25,271
10	Tarifë varesa	13,835	13,854	17,200	17,372	17,546	17,721
11	Tarifë për shërbime të tjera administrative	8,605	73,600	6,109	6,261	6,324	6,387
12	Kontribut në Fondin Publik të banesave sociale	0	0	26,000	26,260	26,523	26,788
13	Tarifë për leje ndërtimi	258	229	750	758	765	773
14	Tarifë për depozitim të mbetjeve tërë	1,093	1,781	5,100	5,151	5,203	5,255
15	Tarifë për ujë dhe mirëmbajtje të kanaleve të ujitjes	10,820	11,885	27,997	28,277	28,560	28,845
III.	Të ardhura nga shitja e pronës dhe dhënia me qira						
1	Qira objekti+qira trashitje+qira taksë bujqësore+qira kulturore	9,612	9,280	17,894	18,073	18,254	18,436
IV.	Të ardhura nga ndërmarrjet e ndërrimeve						
V.	Të ardhura të tjera	48,916	82,871	85,265	86,118	86,979	87,849
1	Transferat e Pakashitës						
2	Tarifë për shërbime sociale (nëse parashikohet konvikte)						
3	Sporte dhe kultura						
4	Dhurata dhe sponsorizime të ndërrimeve						
5	Të ardhura nga gjetat	9,253	11,444	18,703	18,890	19,079	19,270
6	Certifikatë për mbrojtjen nga zjarri	530	559	1,130	1,141	1,153	1,164
7	Mirëtim projekti	965	1,165	1,000	1,010	1,020	1,030
8	Shërbime zjarfikse në objekte të sigurancës	0	0	10	10	10	10
9	Shërbime zjarfikse ndaj të tjerëve	0	0	340	343	347	350
10	Marrje me qira pylli	5,661	6,328	9,500	9,595	9,691	9,788
11	Të ardhura nga shitja e drurit të zjarrit+heqje materiali	0	0	100	101	102	103
12	Vendime transporti	30	21	30	30	31	31
13	Prodhimet e dyta medicinale	0	0	1,000	1,010	1,020	1,030
15	Të ardhurat nga vlerësimi	21,252	21,911	42,275	42,698	43,125	43,556
16	Të jera (centri+banesa soc.+kamata)	11,243	11,443	11,177	11,289	11,402	11,516
VI.	Totali i të ardhurave të veta (I+II+III+IV+V)	760,420	880,371	1,277,460	1,287,435	1,297,509	1,307,684
VII.	Të ardhura të huajshme						
1	Transferat të kushtetues						
2	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve						
3	Transferat specifikë						
VIII.	Të ardhurat gjithsej (VI+VII)	760,420	880,371	1,277,460	1,287,435	1,297,509	1,307,684

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Asa VERUSHI



*Arty Dë
Lush*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇE
DREJTORIA E FINANCËS, BUXHETIT DHE MFK
DREJTORIA E KUJDESIT SOCIAL

BASHKIA KORÇE

NR 645 PROT
DAT 21/01/2026

Nr. _____ prot

Datë _____

RELACION

**PËR MIRATIM E RITJES SË PLANIT TË TË ARDHURAVE DHE
PËRDORIMIN E FONDIT TË FINANCUAR NGA KËSHILLI I QARKUT KORÇË
NË VLERËN 641,850 LEKË PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT "SHËRBIME
SOCIALE E SHËNDETËSORE TË PËRSHTATSHME TË INTEGRUARA PËR TË
MOSHUARIT"**

Në kuadër të zbatimit të projektit "Shërbime sociale e shëndetësore të përshtatshme të integruara për të moshuarit", sipas marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Korçë dhe Këshillit të Qarkut Korçë, e lidhur më datë 1.9.2025 dhe 19.01.2026, si dhe urdhëri i Këshillit të Qarkut Korçë me nr. 19 datë 19.1.2026 "Për detajimin e zërit "Projekte sociale me Bashkitë e Qarkut, moshat e treta dhe fëmijët e komuniteteve", si dhe në kuadër të zbatimit të projektit "Qendra ditore për moshën e tretë" Bashkia Korçë në bashkëpunim me Këshillin e Qarkut Korçë dhe Fondacionin "Misioni Emanuel", implementon, zbaton dhe menaxhon shërbime psiko-sociale, shërbime mjekësore, argëtuese, kulturore për të moshuarit, me qëllim shmangien e izolimit, përfshirjen sociale dhe zbutjen e problemeve sociale. Objekti i kësaj marrëveshjeje, është financimi në vlerën 641,850 lekë nga ana e Këshillit të Qarkut Korçë, për shtimin e një punonjësi në qendrën komunitare, lagjia nr. 8, për shkak të rritjes së numrit të përfituesve dhe shtimit të shërbimeve. Në vijim të bashkëpunimit institucional ky pozicion do të financohet nga Këshilli Qarkut Korçë në programin A1122 Përkujdesi Social si më poshtë dhe me këtë strukturë buxhetore:

SHTOHET Prog. A1122 00 Prod. V043AAK 05 Art. 6040000 + 641,850 lekë

Duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, ligjin nr.87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", udhëzimin nr. 9 datë 20.03 .2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, VKB nr. 139 datë 26.12.2025 "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028 të Bashkisë Korçë", urdhërin nr. 12 datë 7.1.2026 "Për detajimin e shpenzimeve korrente për vitin 2026 të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë" sipas programeve dhe produkteve, marrëveshjes së

bashkëpunimit midis Bashkisë Korçë dhe Këshillit të Qarkut Korçë, e lidhur më date 1.9.2025 dhe 19.01.2026, si dhe urdhëri i Këshillit të Qarkut Korçë me nr. 19 datë 19.1.2026 "Për detajimin e zërit "Projekte sociale me Bashkitë e Qarkut, moshat e treta dhe fëmijët e komuniteteve", kërkojmë nga Këshilli Bashkiak të miratojë rritjen e planit të të ardhurave dhe përdorimin e fondit të financuar nga Këshilli i Qarkut Korçë në vlerën 641,850 lekë për zbatimin e projektit "Shërbime sociale e shëndetësore të përshtatshme të integruara për të moshuarit".

DREJTORIA E FINANCËS
BUXHETIT DHE MFK

Valbona Ziko



DREJTORIA E
KUJDESIT SOCIAL
Mariana Jorgji



DREJTORIA E PËRGJITHSHME
JURIDIKE DHE TË BURIMEVE
NJERËZORE

Anxhela Qeramixhi (Dishnica)



KRYETARI I BASHKISË
SOTIRAQ FILO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr. _____ Datë _____

**PËR MIRATIM E RITJES SË PLANIT TË TË ARDHURAVE DHE
PËRDORIMIN E FONDIT TË FINANCUAR NGA KËSHILLI I QARKUT KORÇË
NË VLERËN 641,850 LEKË PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT "SHËRBIME
SOCIALE E SHËNDETËSORE TË PËRSHTATSHME TË INTEGRUARA PËR TË
MOSHUARIT"**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK dhe Drejtoria e Kujdesit Social, duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, ligjin nr.87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, VKB nr. 139 datë 26.12.2025 "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028 të Bashkisë Korçë", urdhërin nr. 12 datë 7.1.2026 "Për detajimin e shpenzimeve korrente për vitin 2026 të Bashkisë dhe Institucioneve të varësisë" sipas programeve dhe produkteve, sipas marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bashkisë Korçë dhe Këshillit të Qarkut Korçë, e lidhur më date 1.9.2025 dhe 19.01.2026, si dhe urdhëri i Këshillit të Qarkut Korçë me nr. 19 datë 19.1.2026 "Për detajimin e zërit "Projekte sociale me Bashkitë e Qarkut, moshat e treta dhe fëmijët e komuniteteve", mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë rritjen e planit të të ardhurave të financuar nga Këshilli i Qarkut Korçë në vlerën 641,850 lekë.
2. Të miratojë përdorimin e kontributit financiar nga Këshilli i Qarkut Korçë, për zbatimin e projektit "Shërbime sociale e shëndetësore të përshtatshme të integruara për të moshuarit", për shtimin e një punonjësi në qendrën komunitare, lagjia.nr. 8, për shkak të rritjes së numrit të përfituesve dhe shtimit të shërbimeve, me këtë strukturë buxhetore:

SHTOHET Prog. AI122 00 Prod.V043AAK 05 Art. 6040000 + 641,850 lekë

3. Implementimi i këtij projekti do të kryhet nga Bashkia dhe Fondacioni Emanuel.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK si dhe Drejtoria e Kujdesit Social.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

KRYETAR

Ana Verushi

Miratuar me _____ vota
Vota Pro _____
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____



Arbush
20/12



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

BASHKIA KORÇE

**DREJTORIA E FINANCËS, BUXHETIT DHE MFK
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE MENAXHIMIT
TË KONTRATAVE**

BASHKIA KORÇE

NR 531 PROT
DAT 19/01/2026

Nr. _____ prot

Datë _____

**RELACION
PËR MIRATIM E GRANDIT TË BAZUAR NË PERFORMANCË, ME BURIM
FINANCIMI TË HUAJ NË VLERËN 1,111,093.19 LEKË**

Me Vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Aplikimeve me shkresën nr. 764 prot., datë 19.12.2025, Bashkia Korçë ka përfituar fondin prej 2,009,969.59 lekë, nga të cilat 898,876.4 lekë me burim financimi të brendshëm dhe 1,111,093.19 lekë me burim financimi të huaj. Në zbatim të udhëzimit të përbashkët me nr. 1031/5 datë 11.7.2025 dhe nr. 10725 datë 11.7.2025, midis Ministrisë së Financave dhe Ministrisë të Shtetit për Pushtetin Vendor, "Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të grandit të bazuar në performancë për bashkitë për vitin 2025", pika 8, Bashkitë venë në dijeni Këshillin Bashkiak dhe marrin vendim për përcaktimin e destinacionit dhe përdorimin e këtij fondi, (1,111,093.19 lekë). Pas marrjes së vendimit në KB, bashkitë i drejtojnë ministrisë përgjegjëse për financat, VKB për përcaktimin e destinacionit/qëllimit të përdorimit të këtij fondi, duke kërkuar çeljen e kodit të produktit/projektit, për të cilin do përdoret ky fond. Fondet e financimit të huaj për grandin e bazuar në performancë, përfitohen në formën e dhurimit, pa kusht kthimi, pa interes. Menaxhimi i këtij fondi do të kryhet në zbatim të udhëzimit të MF nr. 10 datë 12.7.2024 "Për regjistrimin, përdorimin, rakordimin dhe publikimin e fondeve të financimeve të huaja në kuadrin e marrëveshjeve ndërkombëtare", sipas skemës me thesar të plotë. Fondi i pashpërndarë trashëgohet në buxhetin e vitit pasardhës dhe përdoret me të njëjtin destinacion.

Ky fond do të përdoret për "Ndërhyrje, mirëmbajtje në Bibliotekën "Th. Mitko" dhe "Muzeu i fotografisë Gjon Mili", Korçë, në programin Kultura, Sport dhe Argëtim, në llogarinë 2310000, me këtë strukturë buxhetore:

SHTOHET Prog. AF122 00 02 Art. 2310000 + 1,111,093.19 lekë (Bashkia)

Duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, ligjin 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, ligjin 115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", aneksit 9

“Grandi i performancës për bashkitë”, në udhëzimin e përbashkët me nr. 1031/5 datë 11.7.2025 dhe nr. 10725 datë 11.7.2025, midis Ministrisë së Financave dhe Ministrisë të Shtetit për Pushtetin Vendor, “Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të grandit të bazuar në performancë për bashkitë për vitin 2025”, shkresën me nr. 764 prot., datë 19.12.2025, VKB nr. 139 datë 26.12.2025 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028 të Bashkisë Korçë”, i ndryshuar, kërkojmë nga Këshilli Bashkiak të miratojë grandin e bazuar në performancë, me burim financimi të huaj, në vlerën 1,111,093.19 lekë, me objekt: “Ndërrhyrje, mirëmbajtje në Bibliotekën “Th. Mitko” dhe “Muzeu i fotografisë Gjon Mili”, Korçë, në programin Kultura, Sport dhe Argëtim, në llogarinë 2310000.

DREJTORIA E FINANCËS
BUXHETIT DHE MFK

Valbona Ziko

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT DHE
MENAXHIMIT TË KONTRATAVE

Ndriçim Hoxha

DREJTORIA E PËRGJITHSHME
JURIDIKE DHE TË BURIMEVE

NJERËZORE

Anxhela Qeramixhi (Dishnica)

KRYETARI I BASHKISË

SOTIRAQ FILO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr. _____ Datë _____

**PËR MIRATIM E GRANDIT TË BAZUAR NË PERFORMANCË, ME BURIM
FINANCIMI TË HUAJ NË VLERËN 1,111,093.19 LEKË**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në analizë materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave, duke u bazuar në ligjin nr 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 68 datë 27.4.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", i ndryshuar, ligjin 87/2025 "Për buxhetin e vitit 2026", ligjin nr.115/2024 "Për buxhetin e vitit 2025", aneksit 9 "Grandi i performancës për bashkitë", udhëzimin nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar, në udhëzimin e përbashkët me nr. 1031/5 datë 11.7.2025 dhe nr. 10725 datë 11.7.2025, midis Ministrisë së Financave dhe Ministrisë të Shtetit për Pushtetin Vendor, "Për kriteret, procedurat, treguesit për shpërndarjen e fondit të grandit të bazuar në performancë për bashkitë për vitin 2025", shkresën me nr. 764 prot., datë 19.12.2025, VKB nr. 139 datë 26.12.2025 "Mbi miratimin e buxhetit vjetor të vitit 2026 dhe PBA 2026-2028 të Bashkisë Korçë", i ndryshuar, mbështetur në kompetencat që ka, si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

VENDOSI

1. Të miratojë grandin e bazuar në performancë, me burim financimi të huaj në vlerën 1,111,093.19 lekë.
2. Të miratojë përdorimin e këtij fondi për objektin: "Ndërrhyrje, mirëmbajtje në Bibliotekën "Th. Mitko" dhe "Muzeu i fotografisë Gjon Mili", Korçë, në programin Kultura, Sport dhe Argëtim, në llogarinë 2310000 me këtë strukturë buxhetore:
SHTOHET Prog. AF122 00 02 Art. 2310000 + 1,111,093.19 lekë (Bashkia)
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

KRYETAR

Ana Verushi

Miratuar me _____ vota
Vota Pro _____
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____

BASHKIA KORÇE
NR 682 PROT
DAT 21/01/2026



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE
DHE MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. _____ Prot.

Korçë më ____ . ____ . ____

RELACION

“PËR MIRATIMIN E PLANIT VJETOR TË PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL PËR INSTITUCIONIN E BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2026”

Bazuar në nenin 18 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 108 datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” çdo institucion i administratës shtetërore duke përfshirë edhe vetëqeverisjen vendore, përgatitin planin vjetor të nevojave për rekrutim në shërbimin civil. Në planin vjetor të pranimit në shërbimin civil duhet të parashikohen numri i vendeve vakante për të cilat duhet të shpallet konkurimi për çdo kategori dhe klasë, numri i anëtarëve të TND (trupa e nëpunësve të nivelit të lartë drejtues) si dhe grupet e administrimit të përgjithshëm dhe të posaçëm.

Bazuar në urdhërin e Kryetarit të Bashkisë Korçë nr.21 datë 16.01.2026 “Për miratimin e strukturës të administratës së Bashkisë Korçë për vitin 2026” dhe në vendimin e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore nr. 5 datë 16.01.2026 “Për miratimin e strukturës analitike të administratës së Bashkisë Korçë për vitin 2026” numri i vendeve vakante, pjesë e shërbimit civil në Bashkinë e Korçës për këtë vit është 66. Nga këto pozicione 1 vend vakant për nëpunës të kategorisë së lartë drejtuese (drejtor drejtorie të përgjithshme), 8 janë vende vakante për nëpunës të nivelit të mesëm drejtues (drejtor drejtorie), 11 janë vende vakante për nëpunës të nivelit të ulët drejtues (përgjegjës sektori) dhe 46 janë vende vakante për nëpunës të nivelit ekzekutiv (specialistë). Në këto kushte dhe bazuar në nenin 54 të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 18 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe VKM nr. 108 datë 26.02.2014 “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil” i propozojme Këshillit të Bashkisë Korçë të miratojë planin e punësimit të Bashkisë Korçë për vitin 2026.

Gjatë vitit 2026 propozohet që numri i vendeve vakante për të cilat do të shpallet konkurimi të jetë si më poshtë:

- 1 vend vakante për nëpunës të nivelit të lartë drejtues (drejtor drejtorie të përgjithshme).
- 8 vende vakante për nëpunës të nivelit të mesëm drejtues (drejtor drejtorie)

- 11 vende vakante për nëpunës të nivelit të ulët drejtues (përgjegjës sektori)
- 46 vende vakante për nëpunës të nivelit ekzekutiv (specialistë)

Rekrutimi i nëpunësve të nivelit të lartë e të mesëm drejtues dhe atyre të ulët drejtues bëhet nëpërmjet procedurës së levizjes paralele ose ngritjes në detyrë. Ndërsa përsa i përket nëpunësve të nivelit ekzekutiv rekrutimi bëhet nëpërmjet konkursit për pranimin në shërbimin civil duke bërë klasifikimin sipas natyrës së pozicionit, në grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm dhe në grupin e pozicioneve të administrimit të posaçëm. Referuar këtij klasifikimi në grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm janë **13 vende vakante**, më konkretisht, 2 Specialistë për Emergjencat Civile në Drejtorinë e Përgjithshme Juridike dhe të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (Drejtoria e Burimeve Njerëzore Protokoll Arkivës dhe shërbimeve Mbështetëse), 2 specialistë në Sektorin e Integritetit Europian, 2 specialistë në Sektorin e Projekteve të Zhvillimit në Drejtorinë e Turizmit dhe Projekteve të Zhvillimit, 2 specialistë në Sektorin e Migracionit dhe Diaspores, 1 Specialist në Sektorin e Strehimit Social dhe 1 Specialist në Sektorin e Menaxhimit të Banesave Sociale në Drejtorinë e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale, 1 specialist në Sektorin e Publikimeve dhe 2 Specialistë ndërlidhës komunitare me kohë të pjesshme. Këto pozicione klasifikohen në grupin e pozicioneve të administrimit të përgjithshëm pasi kanë të bëjnë me të njëjtat përgjegjësi administrative në të gjitha institucionet e shërbimit civil dhe ushtrimi i tyre kërkon njohuri të përgjithshme administrative. Ndërsa në grupin e pozicioneve të administrimit të posaçëm janë **33 vende vakante**. Këto pozicione klasifikohen në grupin e pozicioneve të administrimit të posaçëm pasi kanë të bëjnë me përgjegjësi specifike në një apo disa institucione të shërbimit civil dhe ushtrimi i tyre kërkon njohuri të posaçme në një profesion të caktuar. Më konkretisht këto pozicione janë si më poshtë:

- 1 Specialist për sektorin e regjistrimit, vlerësimin dhe shërbimit të taksapaguesve dhe 1 Specialist për Kontrollin dhe Mbledhjen e të Ardhurave për Njësinë Administrative Drenovë në Drejtorinë e Përgjithshme e Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontroll Territorit (Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore), 2 Specialistë për Kontabilitetin, 1 Specialist MFK dhe 1 Specialist buxheti në Drejtorinë e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit gjithsej **6 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimim në Fakultetin e Ekonomisë.
- 1 specialist për shërbimet veterinare në Drejtorinë e Përgjithshme e Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontroll Territorit, gjithësej **1 pozicion** i cili kërkon njohuri të posaçme dhe arsimim në Fakultetin e Veterinarisë.
- 1 specialist për menaxhimin e aseteve në pronësi të Bashkisë Korçë në Drejtorinë e Përgjithshme Juridike dhe të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (Drejtoria Juridike), 1 Specialist jurist në Drejtorinë e Përgjithshme e Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontroll Territorit (Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore) dhe 1 Specialist Jurist në

Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave gjithsej **3 pozicione** të cilët kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimim në Fakultetin e Drejtësisë.

- 2 Specialistë Audit në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, 1 specialist për të Dhënat e Konkurentëve dhe 1 Specialist për blerjet e vogla në Drejtorinë e Prokurimeve gjithsej **4 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimim në Fakultetin e Ekonomisë dhe/ose në Fakultetin e Drejtësisë. Pozicionet e inspektorëve të lartë të auditimit në Drejtorinë e auditit të Brendshëm duhet të jenë të çertifikuar si të tillë nga Ministria përkatëse.
- 2 Specialistë projektues, 2 Specialistë për shqyrtimin e lejave, 1 Specialist për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave demografike, etj., 1 Specialist për Energjinë Elektrike dhe 1 Specialist inxhinier ndërtimi në Drejtorinë e Përgjithshme të Planifikimit të Territorit dhe Menaxhimit të Kontratave, si dhe 1 specialist për çështjet urbane gjithsej **8 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimim në fushën e urbanistikës, arkitekturës, inxhinierisë së ndërtimit, topografisë etj.
- 1 Specialist për ndihmën ekonomike, 1 Specialist për pagesat e PAK, verberise dhe para e tetra plegjike dhe 1 Specialist për Mbrojtjen e të drejtave të Fëmijëve në Drejtorinë e Kujdesit Social, gjithsej **3 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimim në Fakultetin e Shkencave Sociale dhe Shkencave Humane.
- 4 specialistë për agronomë në Sektorin e Bujqësisë në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pyjeve, gjithsej **4 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimim në Fakultetin e Agronomisë.
- 2 specialistë Pyjesh në Drejtorinë e Bujqësisë dhe Pyjeve, gjithsej **2 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimim në Fakultetin e Inxhinierisë së Mjedisit/ Pyjeve etj.
- 2 specialistë IT në Drejtorinë e Përgjithshme Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Protokoll-Arkiva dhe Shërbimeve Mbështetëse), gjithsej **2 pozicione** të cilat kërkojnë njohuri të posaçme dhe arsimim në Fakultetin e Teknologjisë së Informacionit/Shkencave Kompjuterike.

Në zbatim të nenit 26 pika 4 e ligjit nr. 152/2015 "Për nëpunësin civil" të ndryshuar, plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e mesme ose të ulët drejtuese, përveç procedurave të lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë është i hapur edhe për kandidatë të tjerë që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendet e lira të punës, duke mos kaluar 20 për qind të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik. Në këto kushte pasi të kenë përfunduar procedurat për lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë propozojmë që të rekrutohen nga jashtë shërbimit civil nëpunës për pozicionet e mëposhtme:

- Drejtor i Drejtorisë së Turizmit dhe Projekteve të Zhvillimit
- Drejtor i Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun dhe Publikimeve

- Përgjegjës i Sektorit të Turizmit
- Përgjegjës i Sektorit për Kontrollin e Zhvillimit të Tokës

**Drejtorja e Përgjithshme Juridike
dhe Menaxhimit Burimeve Njerëzore
Anxhela (Dishnica) Qeramixhi**



**KRYETARI I BASHKISË
Sotirag Filo**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE
NJERËZORE
DREJTORIA E TURIZMIT DHE PROJEKTEVE TË ZHVILLIMIT NË BASHKINË
KORÇË.

NR. _____ PROT.

DATË _____ / _____ /2026

RELACION

"MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRZGJEDHJEN NËPËRMJET KONKURRIMIT TË SUBJEKTIT QË DO TË PROMOVOJË KORÇËN SI DESTINACION TURISTIK"

Bashkia Korçë është një nga destinacionet kryesore turistike në Shqipëri, me vlera të spikatura kulturore, historike, natyrore dhe gastronomike. Rritja e fluksit turistik kërkon ofrimin e një shërbimi profesional, dhe të besueshëm të informimit turistik.

Për shkak të numrit të lartë të turistëve por dhe ofrimin të një pakete të plote turistike lind nevoja për caktimin e një organizate jofitimprurëse që të menaxhojë informacionin turistik por dhe zyrën e informacionit turistik, të asistojë bizneset në menaxhimin e kapaciteteve turistike, të promovojë produktin vendas në panairë të ndryshme lokale kombetare dhe nderkombetare, të marrin pjesë në konferenca në favor të tregut turistik dhe të krijojë përjasje me turizmin vendas.

Ky shërbim synon të përmirësojë cilësinë e informacionit turistik, të rrisë promovimin e destinacionit Korçë dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit lokal

Për këtë arsye, është e domosdoshme që subjekti ofrues i këtij shërbimi të përzgjidhet përmes një procedure konkurruese, transparente dhe të bazuar në kritere të qarta profesionale.

Subjektit i cili do të përzgjidhet fitues nga kjo procedure konkurimi, propozohet ti vendoset në dispozicion me kontratë huapërdorje objekti me sipërfaqe 16.6 m2, pjesë e pasurisë Nr. 2/492 vol 32 faqe 100, ZK 8561 për një afat 3 vjeçar, atëherë sa do të zgjasë dhe marrëveshja e bashkëpunimit.

Sa më lart parashtruam bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, Ligjin nr. 93/2015 "Për turizmin", i ndryshuar Kodin Civil, i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë kriteret dhe procedurën e konkurimit si më poshtë vijon dhe dhënien me huapërdorje të objekti me sipërfaqe 16.6 m2, pjesë e pasurisë Nr. 2/492 vol 32 faqe 100, ZK 8561 për një afat 3 vjeçar,

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË SUBJEKTIT

KRITERET LIGJORE (10 pikë)

Subjekti aplikues duhet:

- Të jetë person juridik (OJF) i regjistruar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi (provuar me vendim gjykatë);
- Të ketë objekt veprimtarie të lidhur me turizmin, shërbimet informative turistike, marketingun turistik ose fusha të ngjashme;(vendim gjykatë)
- Të mos ketë detyrime tatimore, taksa, tarifa vendore dhe detyrime të prapambetura (vertetime nga andimistrata tatimore dhe bashkia);
- Të mos jetë në proces falimentimi apo likuidimi.(vertetim nga gjykata)
- Të mos jetë I denuar me vendim të formës së prerë (certifikate e gjendjes gjyqësore/ose e ngjashme)

KRITERI PROFESIONAL (10 pikë)

Subjekti duhet:

- Të provojë eksperiencë të mëparshme në ofrimin e shërbimeve të informimit turistik ose shërbimeve të ngjashme (kontrata të mëparshme);
- Të disponojë staf të kualifikuar, me njohuri të gjuhëve të huaja dhe të trashëgimisë turistike locale (diplome, listpagesa, cv);
- Të paraqesë një plan të detajuar të organizimit dhe funksionimit të Pikës së Informimit Turistik, mënyrës si do asistojë bizneset në menaxhimin e kapaciteteve turistike, si do promovojë produktin vendas në panairë të ndryshme lokale kombetare dhe nderkombetare, dhe pjesëmarrjen në konferenca të ndryshme në favor të tregut turistik;
- Të ketë minimum 10 vite eksperiencë në fushën e turizmit.

KAPACITETI FINANCIAR (10 pikë)

Subjekti aplikues duhet:

- Të demonstrojë kapacitet financiar për realizimin e shërbimit (Projekti që do të zbatohet në ofrimin e këtij shërbimi);
- Aftësi për të menaxhuar fonde dhe projekte

- Afësi për të siguruar të ardhura shtesë (projekte donacione, partneritete) të qëndrueshme

Për kriteret e sipërcituara duhet të sillët dokumentacioni përkatës provues original ase I njëhsuar me origjinalin.

PROCEDURA E KONKURIMIT

- Shpallja e thirrjes publike nga Bashkia Korçë në faqen zyrtare te çebit të Bashkisë Korçë dhe afishim në stendën e njoftimeve;
- Shpallja do të qëndrojë e afishuar/publikuar për një afat 2 javor nga data e afishimit;
- Subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë aplikimet brenda afatit dy javor në zyrën e Protokoll Arkivës në Bashkinë Korçë në zarf të mbyllur;
- Vlerësimi i aplikimeve të bëhet nga një komision i posaçëm i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë;
- Renditja e subjekteve do të bëhet sipas pikëzimit të kriterëve;.Grupi I punes ngritur me urdher të kryetarit I paraqet raportin e vleresimit kryetarit për miratim.
- Kryetari shpall fituesin me vendim dhe nenshkruan marrëveshjen përkatëse.

Drejtor i Përgjithshme:

A. Qeremixhi (Dishnica)



KRYETAR I BASHKISË

Sotirag Filo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**

P/VENDIM

Nr. _____, datë ____/____/2026

**“MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRZGJEDHJEN NËPËRMJET
KONKURRIMIT TË SUBJEKTIT QË DO TË PROMOVOJË KORÇËN SI
DESTINACION TURISTIK”**

Në mbështetje të nenit 54 të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” I ndryshuar, Ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar, Kodi i Procedurave Administrative, Këshilli I Bashkisë

V E N D O S I:

Të miratojë kriteret e nevojshme mbi bazën e të cilave do të kryhet përzgjedhja e OJF që do të promovojë korçën si destinacion turistik si më poshtë:

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË SUBJEKTIT

KRITERET LIGJORE (10 pikë)

Subjekti aplikues duhet:

- Të jetë person juridik (OJF) i regjistruar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi (provuar me vendim gjykatë,);
- Të ketë objekt veprimtarie të lidhur me turizmin, shërbimet informative turistike, marketingun turistik ose fusha të ngjashme;(vendim gjykatë)
- Të mos ketë detyrime tatimore, taksa, tarifa vendore dhe detyrime të prapambetura (vertetime nga andimistrata tatimore dhe bashkia);
- Të mos jetë në proces falimentimi apo likuidimi.(vertetim nga gjykata)
- Të mos jetë i denuar me vendim të formës së prerë (certifikate e gjendjes gjyqësore/ose e ngjashme)

KRITERI PROFESIONAL (10 pikë)

Subjekti duhet:

- Të provojë eksperiencë të mëparshme në ofrimin e shërbimeve të informimit turistik ose shërbimeve të ngjashme (kontrata të mëparshme);
- Të disponojë staf të kualifikuar, me njohuri të gjuhëve të huaja dhe të trashëgimisë turistike locale (diplome, listpagesa. cv);
- Të paraqesë një plan të detajuar të organizimit dhe funksionimit të Pikës së Informimit Turistik, mënyrës si do asistojë bizneset në menaxhimin e kapaciteteve turistike, si do promovojë produktin vendas në panairë të ndryshme locale, kombetare dhe nderkombetare, dhe pjesëmarrjen në konferenca të ndryshme në favor të tregut turistik;
- Të ketë minimum 10 vite eksperiencë në fushën e turizmit.

KAPACITETI FINANCIAR (10 pikë)

Subjekti aplikues duhet:

- Të demonstrojë kapacitet financiar për realizimin e shërbimit (Projekti që do të zbatohet në ofrimin e këtij shërbimi);
- Aftësi për të menaxhuar fonde dhe projekte
- Aftësi për të siguruar të ardhura shtesë (projekte donacione, partneritete) të qëndrueshme

Për kriteret e sipërcituara subjekti duhet të paraqesë dokumentacioni e kërkuar për secilin kriter në origjinal ose i njëjësuar me origjinalin.

PROCEDURA E KONKURIMIT

- Shpallja e thirrjes publike nga Bashkia Korçë në faqen zyrtare të uebit të Bashkisë Korçë dhe afishim në stendën e njoftimeve;
 - Shpallja do të qëndrojë e afishuar/publikuar për një afat 2 javor nga data e afishimit;
 - Subjektet e interesuara duhet të dorëzojnë aplikimet brenda afatit dy javor në zyrën e Protokoll Arkivës në Bashkinë Korçë në zarf të mbyllur;
 - Vlerësimi i aplikimeve të bëhet nga një komision i posaçëm i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë;
 - Renditja e subjekteve do të bëhet sipas pikëzimit të kriterëve;.Grupi I punes ngritur me urdher të kryetarit I paraqet raportin e vleresimit kryetarit për miratim.
 - Kryetari shpall fituesin me vendim dhe nënshkruan marrëveshjen përkatëse.
1. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Korçë të nënshkruajë marrëveshjen me subjektin e përzgjedhur fitues për një afat 3 vjeçar nga data e nënshkrimit.
 2. Të japë me huapërdorje për subjektin fitues, objekti me sipërfaqe 16.6 m2, pjesë e pasurisë Nr. 2/492 vol 32 faqe 100, ZK 8561 për një afat 3 vjeçar, aq sa do të zgjasë dhe marrëveshja e bashkëpunimit sipas genplanit bashkëpunimit.
 3. Kontrata e huapërdorjes të lidhet me një afat 3 vjeçar sa dhe marrëveshja e bashkëpunimit.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, dhe Drejtoria e Turizmit dhe Projekteve të Zhvillimit në Bashkinë Korçë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

ANA VERUSHI


Miratuar me _____ vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____

GEN-PLAN

ADRESA : ZK : 8561 PASURIA NR 2/492=10941 M2 (RRUGE)
VOL 32; FQ 100



QELIMI : HUAPERDORJE



SIPERFAQJA E OBJEKTIT = 16.6 M2

HARTOI
Ing Arber Gremi

Arber
Gremi

Digitally signed by
Arber Gremi
DN: cn=Arber Gremi,
o=Arber Gremi, ou=Arber
Gremi, email=arber.gremi@arbergremi.com



REPUBLIKA E SHQIPËRIE

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHMË JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE
NJERËZORE

BASHKIA KORÇË

NR 501 PROT
DAT 16/01/2026

Nr. ____ PROT.

DATË ____ / ____ /2026

RELACION

"PËR MIRATIMIN E DISA VLERËSIMEVE, QË MUND TË JEPEN NGA KRYETARI I BASHKISË KORÇË "

Ligji nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" të ndryshuar, në nenin 9 të tij përcakton të drejtat dhe përgjegjësitë e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për të dhënë tituj nderi dhe stimuj (Neni 9 pikë 1.7 gërma a). Ndërsa në nenin 54 të këtij ligji përcaktohet shprehimisht se "*Këshilli i Bashkisë ka kompetencën për të dhënë stimuj dhe tituj nderi që udhëhiqet nga parimi i nderimit publik dhe i vlerësimit të kontributit dhe që jepen si shenjë nderimi ndaj shtetasve shqiptarë apo të huaj, për veprimtari dhe kontribut të dalluar në fusha të ndryshme, për mbrojtjen dhe promovimin e interesave apo komuniteteve të njësive të vetëqeverisjes vendore*".

Në këtë kontekst propozojmë që përveç Këshillit Bashkiak dhe kryetari i Bashkisë mund të japë vlerësime, falenderime me iniciativë personale, që nuk janë tituj nderi në kuptim të ligjit por vlerësime simbolike.

Propozojmë që vlerësimet simbolike që mund të jepen me iniciativën e Kryetarit të Bashkisë të jenë "Mirënjohje e Kryetarit të Bashkisë", "Çertifikatë pjesmarrjeje" dhe "Mik i Bashkisë".

SIMBOLIKA "MIRËNJOHJE E KRYETARIT TË BASHKISË" është një vlerësim, mirënjohje dhe falenderim që jepet nga Kryetari i Bashkisë për persona ose institucione që kanë kontribuar ndjeshëm në komunitet, në kulturë, art, sport, mjedis, edukim, veprimtari humanitare ose sociale, arritje personale që nderojnë qytetin, bashkëpunim institucional që ka sjellë përfitime për komunitetin.

Qëllimi i simbolikës është të nderojë persona që kanë sjellë vlerë të jashtëzakonshme qytetit.

- Të forcojë marrëdhënien mes komunitetit dhe institucioneve vendore.

- Të promovojë shembuj pozitivë dhe frymëzues për shoqërinë.

Kjo simbolikë përfshin stemën dhe logon e Bashkisë firmën e kryetarit të bashkisë numrin dhe datën e dhënies

Në tekst Zakonisht përfshihet një formulim i tipit:

- "Në shenjë vlerësimi për kontributin e shquar në..."
- "Për angazhimin e vyer në shërbim të komunitetit..."

Kjo lloj simbolike mund të jetë në formën e një Certifikatë e certifikuar dhe e kornizuar, plaketë ose trofe me emrin e personit ose medalion simbolik.

Dorëzimi i simbolikës bëhet shpesh në një aktivitet publik, apo event kulturor dhe shënon respekt zyrtar dhe publik ndaj kontributit të vlerësuar.

CERTIFIKATË PJESEMARRJE është një dokument ceremonial që përdoret për të vërtetuar se një person ka marrë pjesë në një aktivitet, trajnim, event, konkurs, seminar apo konferencë të organizuar nga Bashkia Korçë apo institucione, organizata që kanë marrëdhënie juridike me Bashkinë Korçë. Elementet zyrtare që përfshin certifikata është emri i institucionit që organizon aktivitetin, logo dhe firma, detajet e aktivitetit, emri dhe mbiemri i pjesëmarrësit, dhe firma e Kryetarit të Bashkisë dhe/ose firma e koordinatorit të projektit.

Në tekst zakonisht përfshihet një formulim i tipit: "Certifikohet se ka marrë pjesë në..." "Ka qenë pjesë e aktivitetit..." "Në shenjë vlerësimi për pjesëmarrjen në..."

TITULLI SIMBOLIK "MIK I BASHKISË" është një vlerësim nderi, i cili i jepet personave fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që kanë dhënë kontribut të dukshëm, të çmuar dhe me ndikim pozitiv në zhvillimin, promovimin, mbështetjen ose përmirësimin e komunitetit dhe interesave të Bashkisë. Ky titull simbolik jepet si shenjë vlerësimi për veprimtari, iniciativa, bashkëpunime ose ndihmesa të veçanta, që kanë sjellë vlerë të shtuar për qytetin dhe banorët e tij, për ndihmë të jashtëzakonshme në rast emergjencash civile, fatkeqsi natyrore etj.

U jepet personave, individëve, organizatave, shoqatave, bizneseve etj që kanë kontribuar dhe ndihmuar Bashkinë në projekte të ndryshme sociale e humanitare, shëndetësi arsim, mjedis, kanë promovuar qytetin dhe kontribuar në kulturë, art e sport etj, kanë bashkëpunuar me Bashkinë Korçë për projekte në dobi të komunitetit, kanë financuar iniciativa lokale, ndihmuar dhe modernizuar shërbimet publike.

Ky lloj titulli simbolik mund të jetë në formën e një certifikatë të kornizuar, plaketë ose trofe me emrin e personit ose medalion simbolik.

Sa më lart parashtruar bazuar në Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" I ndryshuar, Ligjit Nr. 94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë", Kodi i Procedurave Administrative, i propozojmë Këshilli Bashkiak të japë pëlqimin për miratimin e disa

vlerësimeve mirënjohjeje dhe falenderime, që mund të jepen nga kryetari i Bashkisë Korçë, për personazhe që kanë dhënë një kontribut të veçantë për Bashkinë Korçë, me simbolikën "Mirënjohje e Kryetarit të Bashkisë", "Çertifikatë Pjesëmarrje" dhe titullin simbolik "Mik i Bashkisë".

Drejtorë Përgjithshme:

A. Qeramirchi (Dishnica)



Drejtorë e Qendrës të Artit dhe Kulturës

Zamir Kiti



KRYETAR I BASHKISË

Sotirag Filo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË

P/VENDIM

Nr. _____, datë ____/____/2026

"PËR MIRATIMIN E DISA VLERËSIMEVE, QË MUND TË JEPEN NGA KRYETARI I BASHKISË KORÇË"

Në mbështetje të nenit 54 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" I ndryshuar, Ligjit Nr. 94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë". Kodi i Procedurave Administrative Këshilli i Bashkisë

V E N D O S I:

1. Ti japë të drejtën kryetarit të Bashkisë Korçë të japë vlerësime, mirënjohje dhe falenderime për personazhe që kanë dhënë një kontribut të veçantë për Bashkinë Korçë ;
2. Vlerësimet që mund të jepen nga Kryetari i Bashkisë janë simbolika "Mirënjohje e Kryetarit të Bashkisë" "Çertifikatë pjesëmarrje" dhe titulli simbolik "Mik i Bashkisë";
3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore e Burimeve Njerëzore dhe Qendra e Artit dhe Kulturës Korçë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

ANA VERUSHI

Miratuar me _____ vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbatuar më datë _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE
NJERËZORE

RELACION

**"PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT TË "STIMULIMI I ARTIZANËVE" DHE
PËRZGJEDHJEN E PARTNERIT PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTI NË
PAZARIN E KORÇËS"**

"Stimulimi i Artizanëve" është një projekt nga i cili Bashkia Korçë synon të mbështesë nevojat aktuale të zhvillimit ekonomik lokal dhe orientimet strategjike për nxitjen e sipërmarrjes kreative në fushën e artizanatit /zejtarisë. Mbështetur në këtë relacion po ju parashtrojmë qëllimet kryesore të projektit, duke përfshirë misionin dhe vizionin, strategjinë, realizimin e objektivave dhe asetet në dispozicion.

Misioni i këtij projekti është:

Zhvillimi ekonomik lokal, nxitja e sipërmarrjes kreative dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore mbështetje financiare dhe asistencë profesionale për artizanet dhe prodhuesit kreative lokale, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik rritjen e punësimit dhe gjallërimit të jetës urbane dhe turistike të qytetit.

Nëpërmjet këtij projekti propozohet ti jepet rëndësi dhe prioritet fushës së artizanatit/zejtarisë si dhe formave të tjera të prodhimit dhe shprehjes kreative në dizajn, punime artistike, produkte kulturore, etj

Ky projekt synon zgjerimin e fushës së mbështetjes për sipërmarrjet kreative, krijimin e një strukture më gjithëpërfshirëse dhe fleksibile, rritjen e ndikimit ekonomik dhe social si dhe përshtatjen me trendet bashkëkohore të zhvillimit urban dhe turizmit kulturor.

"Stimulimi i Artizanëve" është një projekt ambicioz që synon të krijojë një hapësirë të dedikuar për zejtarinë tradicionale dhe bashkëkohore dhe industrinë kreative. Përmes një strategjie të qartë dhe një strukture organizative, ky projekt synon të kontribuojë në zhvillimin ekonomik-kulturor të bashkisë, duke promovuar dhe mbështetur artizanët/zejtarët dhe kreativitetin në të gjitha format e tij.

Bashkia Korçë i është drejtuar Këshillit të Qarkut Korçë me kërkesë për mbështetje financiare për këtë projekt, me shkresë nr. 13543 Prot. datë 18.12.2025 protokolluar prane Këshillit të Qarkut Korçë me nr. 1228 prot datë 19.12.2025.

Nëpërmjet Vendimit Nr. 50 datë 23.12.2025 *"Për Miratimin e Buxhetit të Këshillit të Qarkut për vitin 2026"* Këshilli i Qarkut Korçë do të financojë projektin dhe Bashkia Korçë do të përgjigjet për realizimin e këtij projekti. Bashkia Korçë do të realizojë procedurat përkatëse të marrjes me

qira të ambienteve dhe do të paguajë shpenzimet operatore energji elektrike, uje etj. Bashkia Korçë do të ndjekë procedurën e përzgjedhjes së organizatave/shoqerive të artizanëve sipas kriterëve dhe kushteve ligjore që përcaktohen në këto relacion si dhe në ligji Nr. 70/2016 "Për Zejtarinë në Republikën e Shqipërisë".

Pas përfundimit të procedurës së përzgjedhjes së ambienteve, këto do të vihen në dispozicion një organizate/shoqate e cila në bashkëpunim me Bashkinë Korçë do të vendosin shpërndarjen e artizanëve në këto ambiente.

Kriteret për përzgjedhjet e organizatës/shoqatës së artizanëve do të jenë si më poshtë:

KRITERET LIGJORE (10 pikë)

Subjekti aplikues duhet:

- Të jetë person juridik (organizate/shoqate) i regjistruar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi (provuar me vendim gjykatë/dokument tjetër lëshuar sipas kërkesave të ligjit nga institucionet përkatëse);
- Të ketë përvojë të dokumentuar në zbatimin e projekteve për zhvillimin ekonomik lokal;
- Të krijojë mundësi për vetëpunësim dhe sipërmarrje të vogël;
- Të ketë objekt veprimtarie të lidhur me artizanatin /zejtarinë ose fusha të ngjashme;
- Të mos ketë detyrime tatimore, taksa, tarifa vendore dhe detyrime të prapambetura; (vertetime nga andimistrata tatimore dhe bashkia);
- Të mos jetë në proces falimentimi apo likuidimi.(vertetim nga gjykata);
- Të mos jetë i denuar me vendim të formës së prerë (çertifikatë e gjëndjes gjyqësore/ose e ngjashme)

KRITERI PROFESIONAL (10 pikë)

Subjekti duhet:

- Të provojë eksperiencë të mëparshme në ofrimin e shërbimeve artizanale (kontrata të mëparshme);
- Të disponojë staf të kualifikuar, me njohuri të gjuhëve të huaja dhe të trashëgimisë artizanale (diplome, listpagesa, cv);
- Të paraqesë një plan të detajuar të organizimit dhe funksionimit të projektit të "*Stimulimi i Artizanëve*", mënyrës si do asistojë dhe do promovojë produktin vendas në panairë të ndryshme lokale kombëtare dhe pjesëmarrjen në konferenca të ndryshme në favor të tregut në fushën e artizanëve/zejtarëve;
- Të ketë minimum 5 vite eksperiencë në fushën e artizanatit/zejtarisë.

KAPACITETI FINANCIAR (10 pikë)

Subjekti aplikues duhet:

- Të demonstrojë kapacitet financiar për realizimin e shërbimit (Projekti që do të zbatojë në ofrimin e këtij shërbimi);

- Aftësi për të menaxhuar fonde dhe projekte
- Aftësi për të siguruar të ardhura shtesë (projekte donacione, partneritete) të qëndrueshme.

Për kriteret e sipërcituara duhet të sillët dokumentacioni përkatës provues original ose i njësuar me origjinalin.

Bazuar në ligjin Nr. 70/2016 "Për Zejtarinë në Republikën e Shqipërisë", ligjin nr. 139/2015 datë 17.12.2015 « *Për vetëqeverisjen vendore* » Nenin 25 *Funksionet e bashkiave në fushën e kulturës, sportit dhe shërbimeve argëtuese*: Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve: 1. Zhvillimin, mbrojtjen dhe promovimin e vlerave e të trashëgimisë kulturore me interes vendor, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve. 2. Organizimin e aktiviteteve kulturore dhe promovimin e identitetit kombëtar e lokal, si dhe administrimin e objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve4. Organizimin e aktiviteteve sportive, çlodhëse e argëtuese, zhvillimin dhe administrimin e institucioneve e të objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

Bazuar në Nenin 54 « *Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak* »; duke marrë parasysh përfitimet që ky projekt do të sjellë për komunitetin dhe ekonominë lokale, kërkojmë miratimin e projektit që do të financohet nga Këshilli i Qarkut Korçë.

Kërkojmë të autorizohet Kryetari i Bashkisë Korçë të nënshkruajë marrëveshjet e partneritetit, kontratat e qirasë dhe çdo marrëveshje tjetër të nevojshme për zbatimin e këtij projekti.

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE**

Anxhela Dëshnica Qeramixhi



KRYETARI BASHKISË

SOTIRAQ FILO





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**

P/V E N D I M

Nr. _____ datë _____ 2026

**“PËR MIRATIMIN E PROJEKTIT TË “STIMULIMI I ARTIZANËVE” DHE
PËRZGJEDHJEN E PARTNERIT PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTI NË
PAZARIN E KORÇËS”**

Drejtorja e Financës, Buxhetit dhe MFK; Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Turizmit, Projekteve të Zhvillimit, bazuar në nenin 25 të ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, referuar nenit 54 «Detyrat dhe kompetencat e Këshillit bashkiak» VKB NR. 139 datë 26.12.2025 “ Për projekt buxhetin e Bashkisë Korçë i vitit 2026 dhe PBA 2026- 2028” ligji Nr. 70/2016 “Për Zejtarinë në Republikën e Shqipërisë” dhe mbas diskutimeve të këshilltarëve:

KËSHILLI BASHKIAK

V E N D O S I

1. Të miratojë projektin e “*Stimulimi i Artizanëve*” Korçë.
2. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Korçë të kryejë procedurat e konkursit dhe të përzgjedhjes së ambineteve ku do të ushtrohet aktiviteti i artizanëve dhe prodhuesve kreative lokale.
3. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Korçë të kryejë procedurën e përzgjedhjes të organizatës/shoqatës me të cilin Bashkia Korçë do të bashkëpunojë për realizimin e projektit dhe nëshkrimin e marrëveshjeve me këtë subjekt.
4. Ambientet ku do të zhvillohet aktiviteti i artizanëve dhe prodhuesve kreative lokale do të jetë në Pazarin e Vjetër Korçë.
5. Kriteret për përzgjedhjet e organizatës/shoqatës së artizanëve do të jenë si më poshtë:

KRITERET LIGJORE (10 pikë)

Subjekti aplikues duhet:

- Të jetë person juridik (organizatë/shoqatë) i regjistruar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi (provuar me vendim gjykatë/dokument tjetër lëshuar sipas kërkesave të ligjit nga institucionet përkatëse);
- Të ketë përvojë të dokumentuar në zbatimin e projekteve për zhvillimin ekonomik lokal;
- Të krijojë mundësi për vetëpunësim dhe sipërmarrje të vogël;
- Të ketë objekt veprimtarie të lidhur me artizanatin /zejtarinë ose fusha të ngjashme;
- Të mos ketë detyrime tatimore, taksa, tarifa vendore dhe detyrime të prapambetura; (vertetime nga andimistrata tatimore dhe bashkia);
- Të mos jetë në proces falimentimi apo likuidimi.(vertetim nga gjykata);

- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë (çertifikatë e gjëndjes gjyqësore/ose e ngjashme)

KRITERI PROFESIONAL (10 pikë)

Subjekti duhet:

- Të provojë eksperiencë të mëparshme në ofrimin e shërbimeve artizanale (kontrata të mëparshme);
- Të disponojë staf të kualifikuar, me njohuri të gjuhëve të huaja dhe të trashëgimisë artizanale (diplome, listpagesa. cv);
- Të paraqesë një plan të detajuar të organizimit dhe funksionimit të projektit të *"Stimulimi i Artizanëve"*, mënyrës si do asistojë dhe do promovojë produktin vendas në panairë të ndryshme lokale kombëtare dhe pjesëmarrjen në konferenca të ndryshme në favor të tregut në fushën e artizanëve/zejtarëve;
- Të ketë minimum 5 vite eksperiencë në fushën e artizanatit/zejtarisë dhe prodhuesve kreative lokale.

KAPACITETI FINANCIAR (10 pikë)

Subjekti aplikues duhet:

- Të demonstrojë kapacitet financiar për realizimin e shërbimit (Projekti që do të zbatohet në ofrimin e këtij shërbimi);
- Aftësi për të menaxhuar fonde dhe projekte
- Aftësi për të siguruar të ardhura shtesë (projekte donacione, partneritete) të qëndrueshme.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe MFK; Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore si dhe Drejtoria e Turizmit, Projekteve të Zhvillimit.

7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

K R Y E T A R

ANA VERUSHI

Miratuar me _____ vota

Vota Pro _____

Vota Kundër _____

Vota Abstenim _____

Zbardhur më datë _____



Lufti
eviz



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE DHE E MENAXHIMIT TË BURIMEVE
NJERËZORE
KLUBI SHUMËSPORTËSH SËNDERBEU

BASHKIA KORÇE

NR 630 PROT
DAT 21/01/2026

NR. ____ PROT.

DATE ____/____/2026

RELACION

“PËR

MIRATIMIN DHE PËRDORIMIN E SIMBOLIT “KORÇA EUROPEAN CITY OF
SPORT” NË KUADËR TË MARRJES SË TITULLIT “KORÇA QYTETI EUROPIAN I
SPORTIT 2026”

Këshilli i Bashkisë Korçë me vendim nr. 33 datë 27.03.2025 ka vendosur të miratojë kërkesën për aplikim, për titullin “Qyteti European i Sportit 2026” tek ACES, e cila është një shoqatë jofitimprurëse me qendër në Bruksel, dhe përcakton çdo vit Qytetin European të Sportit.

Gjithashtu me këtë vendim marrje Këshilli ka autorizuar kryetarin e Bashkisë Korçë për ndjekjen e procedurave të aplikimit. Shoqata ACES ka vlerësuar se Korça përmbush të gjitha kriteret për të qënë Qyteti European i Sportit për vitin 2026, duke i dhënë titullin “Korça European City of Sport” për vitin 2026.

Në këto kushte, propozojmë që në të gjitha shkresat që prodhon Bashkia Korçë, ndërmarrjet e varësisë, njësitë administrative/rajonet, ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare ku bashkia zotëron mbi 50 % të kapitalit, kuotave apo aksioneve, Këshilli Bashkiak, krahas simbolit të “Republikës të Shqipërisë” dhe simbolit të Bashkisë Korçë, të vendoset dhe simboli i “Korça European City of Sport”, për gjatë gjithë vitit 2026.

Sa më lart parashtruam, në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.7, shkronja c, nenit 54, shkronja “I”, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 79/2017 “Për sportin”, të

ndryshuar, vlerësimi të organizatës Aces Europe, i propozojmë Këshillit të japë miratimin për përdorimin e simbolit të "Korça European City of Sport" sipas modelit bashkalidhur, në të gjitha shkresat zyrtare dhe dokumentat administrative të prodhuara nga Bashkia Korçë, institucionet e saj të varësisë, njësitë administrative, rajonet, ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare ku bashkia zotëron mbi 50 % të kapitalit, kuotave apo aksioneve shkresat dhe materialet e Këshillit Bashkiak, përdorimin e simbolit edhe në posterat, fiesat, si dhe në të gjitha eventet e Bashkisë Korçë që do të zhvillohen në kuadër të "Korça European City of Sport, 2026", për gjatë gjithë vitit 2026.

Drejtorë e Përgjithshme:

A. Qeramixhi (Dishnica)



Drejtorë e Klubit Shumësportësh "Skënderbeu"

Olsa Vaso



KRYETAR I BASHKISË

Sotirag Filo





REPUBLIKA E SHQIPËRISE

**BASHKIA KORÇË
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**

P/VENDIM

Nr. _____, datë ____/____/2026

“PËR

**MIRATIMIN DHE PËRDORIMIN E SIMBOLIT “KORÇA EUROPEAN CITY OF
SPORT” NË KUADËR TË MARRJES SË TITULLIT “KORÇA QYTETI EUROPIAN I
SPORTIT, 2026”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b” dhe nënpika 1.7, shkonja c, nenit 54, shkronja “k” dhe “l”, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, ligjit nr. 79/2017 “Për sportin”, të ndryshuar, vlerësimit të organizatës Aces Europe, me propozimin e kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Miratimin e simbolit “Korça European City of Sport,” sipas modelit bashkëlidhur këtij vendimi në kuadër të marrjes së titullit “Korça European City of Sport, 2026”.
2. Simboli “Korça European City of Sport,” përdoret në të gjithë dokumentet administrative të prodhuara nga Bashkia Korçë, institucionet e saj të varësisë, njësitë administrative/lagjet, ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare ku bashkia zotëron mbi 50 % të kapitalit, kuotave apo aksioneve dhe në të gjithë shkresat dhe materialet e prodhuara nga Këshilli Bashkiak.
3. Simboli përdoret edhe në posterat, ftesat, si dhe në të gjitha eventet e Bashkisë Korçë që do të zhvillohen në kuadër të “Korça European City of Sport, 2026”.
4. Simboli “Korça European City of Sport, 2026”, sipas këtij vendimi përdoret gjatë gjithë vitit 2026.

5. Ngarkohet Këshilli Bashkiak, Bashkia Korçë, institucionet e saj të varësisë, njësitë administrative, rajonet administrative, ndërmarrjet dhe shoqëritë tregtare ku bashkia zotëron mbi 50 % të kapitalit, kuotave apo aksioneve për zbatimin e këtij vendimi,
1. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

ANA VERUSHI

Miraturar me _____ vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbatuar më datë _____

Model 1 (për dokumentet që dalin nga institucioni)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**BASHKIA KORÇË
(EMËRTESE E STRUKTURËS)**

Nr. _____ prot.

Korçë, më ____ . ____ . ____

Lënda: (Shënohet shkurtimi përmbajtësor i dokumentit).

**EMËRTIMI I PLOTË NË RASËN DHANORE, ME GËRMA KAPITALE, I
INSTITUCIONIT TË CILIT I DËRGOHET**

(Emërtimi i vendit ku ka selinë institucioni të cilit i dërgohet)

Për dijeni: (në rastet kur janë institucione të tjera për dijeni dhe shënohet emërtesa dhe vendi ku ka selinë institucionit, njësoj si më sipër)

Në vijim / Në përgjigje suajës / tonës me Nr. _____, datë ____ . ____ . ____

.....
.....

Konceptoi: nistore e emrit, pikë, mbiemri i plotë, nënshkrimi i konceptuesit

Pranoi: nistore e emrit, pikë, mbiemri i plotë, nënshkrimi i përgjegjës të strukturës së nivelit të parë (nëse ka).

Miratoi: nistore e emrit, pikë, mbiemri i plotë, nënshkrimi i përgjegjës të strukturës së nivelit të dytë (nëse ka).

KRYETARI I BASHKISË

Sotirag Filo



Korça
ave

BASHKIA K O R Ç E

NR 519 PROT
DATA 18/01/2026

K 2008 sh.a.
Korça
KB-15290018

Ish-uzina e instrumentave,
Bul. "Midhi Kostani", Korçë

Nr. 4 Prot.

Date: 14/01/2026

Kërkesë

Drejtuar: Asamblesë të Përgjithshme të Aksionerëve të "Korça 2008" sh.a

Lenda: Thirrja e Asamblesë të Përgjithshme të Aksionerëve për emerimin e audituesit ligjor, për auditimin ligjor të pasqyrave financiare për vitin 2025 të shoqërisë "Korça 2008" sh.a

Të nderuar përfaqesues të Asamblesë, nën cilesinë e Administratorit të shoqërisë "Korça 2008" sh.a kërkoj mbledhjen e Asamblese të Përgjithshme të Aksionerëve për shqyrtimin dhe miratimin e një materiali të përgatitur dhe dërguar secilit prej jush në formë elektronike prane Sekretarise të Këshillit Bashkiak, sipas rendit të ditës si me poshtë, për mbledhjen e datës 29/ 01/2026 të Këshillit Bashkiak.

Ju lutemi ta merrni parasysh kërkesën, shqyrtimin dhe miratimin e tij në mbledhjen e radhës.

Administratori

Klevis Furxhi

Klevis Furxhi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

KËSHILLI BASHKIAK

P/VENDIM

Nr _____ Datë ____/____/2026

“PËR EMËRIMIN DHE MIRATIMIN TË AUDITUESVE LIGJORË PËR AUDITIMIN LIGJOR TË PASQYRAVE FINANCIARE PËR VITIN 2025 TË”KORÇA 2008” sh.a.”

Bazuar në nenin 135 pika 2 gërma (ç) të ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare”, i ndryshuar dhe gërma (d) për miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në gërmat “c” e “ç” të kësaj pike, ligjit 10 091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar”, në Statutin e Aktin e themelimit të shoqërisë “Korça 2008” sh.a. Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve:

KËSHILLIT BASHKIAK KORÇË

VENDOSI

1. Të emërojë audituesit ligjor. Z/Znj _____ me nr personal _____ dhe Z/Znj. _____ me nr personal _____
2. Për regjistrimin e këtij vendimi në QKB ngarkohet administratori i shoqërisë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen ekspertët e shoqërisë të emëruar sipas pikes 1.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Keshillit Bashkiak KRYETAR

Eva NAÇI

Ana VERUSHI

Miratuar me ____ vota

Vota Pro ____

Vota Kundër ____

Vota Abstenim ____

Zbardhur më datë ____/____/____



Qendra Sportive Korçë



BASHKIA KORÇE
NR 520 PROT
DATA 13/01/2026

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA SPORTIVE KORÇË sh.a**

Nr 14 Prot

Datë 12/01/2026

KËRKESË

Drejtuar: Asamblesë të Përgjithshme të Aksionerëve të Qendra Sportive Korçë sh.a

Lënda: Thirrja e Asamblesë të Përgjithshme të Aksionerëve nga Qendra Sportive Korçë sh.a

Të nderuar përfaqësues të Asamblesë, nën cilësinë e Administratorit të Qendra Sportive Korçë sh.a, kërkoj mbledhjen e Asamblesë të Përgjithshme të Aksionerëve për shqyrtimin dhe miratimin e dy materialeve të përgatitura dhe dërguar secilit prej jush në formë elektronike, për mbledhjen e muajit Janar të Këshillit Bashkiak.

Ju lutemi ta merrni parasysh kërkesën, shqyrtimin e materialeve dhe miratimin e tyre në mbledhjen e radhës.

- 1. Për emërimin dhe miratimin e skemes të shpërblimeve të ekspertëve kontabël të autorizuar për auditimin ligjor të pasqyrave financiare për vitin 2025 të Qendra Sportive Korçë sh.a**
- 2. Për miratimin e trajtimit ushqimor dhe dietave për Ekipin e Pare dhe Akademine "Skenderbeu" për vitin 2026**

Faleminderit

ADMINISTRATORI

Luis QIRINXHI



KRYETARI I KËSHILLIT MBIKQYRËS

Kletjon KITA



BASHKIA KORÇE
NR 520 PROT
DATA 19/01/2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA SPORTIVE KORÇË sh.a

RELACION

Datë 12/01/2026

Për emërimin dhe miratimin e skemes të shpërblimeve të Audituesëve Ligjorë për auditimin ligjor të pasqyrave financiare për vitin 2025 të Qendra Sportive Korçë sh.a

Bazuar në nenin 135 pika 2 gërma (ç) të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare", i ndryshuar dhe gërma (d) për miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në gërmat "c" e "ç" të kësaj pike, ligjit 10 091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe Kontabilistit të Miratuar", ligjit Nr. 47/2016 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 10 091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe Kontabilistit të Miratuar" të ndryshuar, në Statutin dhe Aktin e themelimit të shoqërisë "Qendra Sportive Korçë" sh.a i kërkoj Asamblesë të Përgjithshme të Aksionerëve të propozojë dhe të emërojë Audituesit Ligjor, si dhe të miratojë skemën e shpërblimeve të këtyre Audituesëve për auditimin ligjor të pasqyrave financiare për vitin 2025 të Qendra Sportive Korçë sh.a, duke u mbështetur në tabelën me treguesit lidhur me afatet kohore të auditimit ligjor të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të Institutit të Ekspertëve Kontabël Të Autorizuar me Vendimin nr. 163 datë 01.07.2024 dhe Tab.1.1

Tab1.1

Totali i Aktivit me të ardhurat	Niveli referues
Deri në 15 milion lekë	60 orë pune
150 - 500 milion lekë	60 - 90 orë pune
500 milion - 1 miliard lekë	90 - 120 orë pune
1 - 2 miliard lekë	120 - 180 orë pune

Shënim: Të ardhurat e "Qendra Sportive Korçë" sh.a për vitin 2025 janë: 5,504,336 lekë

Subvencione Bashkia Korçë: 74,941,139 lekë

Aktive: 509,493,784 lekë

Totali i Aktivit me të ardhurat : 589,939,259 Lekë

si dhe në bazë të vendimit të Asambleja e Përgjithshme e Anëtarëve të Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar datë 29.06.2011 i cili ka miratuar një tarifë normale orare për kryrjen e auditimit ligjor prej 3000 lekë/orë.

Shoqëria do të paguajë Ekspertët Kontabël të Regjistruara për misionin që do të kryejnë si më poshtë:

Orë pune $90 \times 3,000$ lekë/orë = 270,000 lekë

Në shumën e mësipërme nuk është përfshirë TVSH-ja.

Faleminderit

ADMINISTRATORI

Luis QIRINXHI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONERËVE

P/VENDIM

Nr. _____ Datë ____/____/2026

Për emërimin dhe miratimin e skemes të shpërblimeve të Audituesëve Ligjorë për auditimin ligjor të pasqyrave financiare për vitin 2025 të Qendra Sportive Korçë sh.a

Bazuar në nenin 135 pika 2 gërma (ç) të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare", i ndryshuar dhe gërma (d) për miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në gërmat "c" e "ç" të kësaj pike, ligjit 10 091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", ligjit Nr. 47/2016 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 10 091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe Kontabilistit të Miratuar" të ndryshuar, në Statutin dhe Aktin e themelimit të shoqërisë "Qendra Sportive Korçë" sh.a Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve:

VENDOSI

1. Të emërojë ekspert kontabël të autorizuar Z/Znj. _____ me nr personal _____ dhe Z/Znj. _____ me nr personal _____.
2. Të miratojë skemën e shpërblimeve të ekspertëve kontabël të autorizuar për auditimin ligjor të pasqyrave financiare për vitin 2025 të Qendra Sportive Korçë sh.a në shumën 270,000 lekë pa TVSH
3. Për regjistrimin e këtij vendimi në QKB ngarkohen administratoret e shoqërisë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen ekspertët e shoqërisë të emëruar sipas pikes 1.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Eva NAÇI

KRYETAR

ANA VERUSHI

6. Miratuar me _____ vota

7. Vota Pro _____

8. Vota Kundër _____

9. Vota Abstenim _____

10. Zbardhur më datë _____



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONERËVE**

VENDIM

Nr _____ Datë ____/____/2026

Për emërimin dhe miratimin e skemes të shpërblimeve të Audituesëve Ligjorë për auditimin ligjor të pasqyrave financiare për vitin 2025 të Qendra Sportive Korçë sh.a

Bazuar në nenin 135 pika 2 gërma (ç) të ligjit 9901 datë 14.04.2008 "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare", i ndryshuar dhe gërma (d) për miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në gërmat "c" e "ç" të kësaj pike, ligjit 10 091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", ligjit Nr. 47/2016 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 10 091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor organizimin e profesionit të Audituesit Ligjor dhe Kontabilistit të Miratuar" të ndryshuar, në Statutin dhe Aktin e themelimit të shoqërisë "Qendra Sportive Korçë" sh.a Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve:

VENDOSI

1. Të emërojë ekspert kontabël të autorizuar Z/Znj. _____ me nr personal _____ dhe Z/Znj. _____ me nr personal _____.
2. Të miratojë skemën e shpërblimeve të ekspertëve kontabël të autorizuar për auditimin ligjor të pasqyrave financiare për vitin 2025 të Qendra Sportive Korçë sh.a në shumën 270,000 lekë pa TVSH
3. Për regjistrimin e këtij vendimi në QKB ngarkohen administratoret e shoqërisë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen ekspertët e shoqërisë të emëruar sipas pikes 1.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

K R Y E T A R

ANA VERUSHI

6. Miratuar me _____ vota
7. Vota Pro _____
8. Vota Kundër _____
9. Vota Abstenim _____
10. Zbardhur më datë _____



BASHKIA KORÇE
NR 520 PROT
DATA 12/01/2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
QENDRA SPORTIVE KORÇË sh.a

Datë 12/01/2026

RELACION

Për miratimin e trajtimit ushqimor dhe dietave për Ekipin e Pare dhe Akademine "Skenderbeu" për vitin 2026

Nën cilësinë e Administratorit të "Qendra Sportive Korçë" sh.a, në mbështetje të Ekipit të Parë dhe Akademisë "Skënderbeu", në nenin 135 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 « Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare », i ndryshuar si dhe në Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë duke ju referuar listës të federimit numri i të cilës i kalon 30 persona, nevojës që ekipi i Skënderbeut ka për mbështetje financiare në arritjen e rezultateve, kërkoj miratimin e fondit në vlerën 57.500 lekë në muaj për person, për 30 sportistë (futbollistë dhe staf), për 10 muaj dhe dietën ditore për ekipin e parë dhe Akademinë "Skenderbeu". Vlera totale e parashikuar për këtë kontribut është 38,666,400 lekë.

Kjo pagesë do të kryhet nga Bashkia duke e transferuar fondin tek " Qendra Sportive Korçë " sh.a. "Qendra Sportive Korçë" sh.a detyrohet sipas transferimit të mësipërm të bëjë pagesën mujore për 30 sportistë të federuar (lista do të jetë e firmosur nga drejtuesit e klubit të futbollit "Skënderbeu"), për 10 muaj si dhe pagesat e dietave ditore për ekipin e parë dhe Akademinë "Skenderbeu".

ADMINISTRATORI

Luis QIRINXHI



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONERËVE**

P/VENDIM

Nr _____, datë ____/____/2026

**Për miratimin e trajtimit ushqimor dhe dietave për Ekipin e Parë dhe
Akademinë "Skënderbeu" për vitin 2026**

Asambleja e Përgjithshme e aksionarëve të shoqërisë « Qendra Sportive Korçe sh.a » me propozim të Administratorit, dhe bazuar në nenin 135 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 « Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare », i ndryshuar si dhe në Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve të anëtarëve :

VENDOSI :

1. Të miratojë trajtimin ushqimor për Ekipin e Parë " Skënderbeu " në vlerën 57.500 lekë në muaj për person për 30 sportistë (futbollistë dhe staf) për 10 muaj dhe dietën ditore për ekipin e parë dhe Akademinë " Skënderbeu " për vitin 2026.
2. Kjo pagesë do të kryhet nga Bashkia duke e transferuar fondin tek " Qendra Sportive Korçe " sh.a.
3. " Qendra Sportive Korçe " sh.a detyrohet sipas transferimit të mësipërm të bëjë pagesën mujore për 30 sportistë të federuar (lista do të jetë e firmosur nga drejtuesit e klubit të futbollit " Skënderbeu ").
4. Fondi nuk duhet të kalojë vlerën e miratuar në buxhetin vjetor të vitit 2026
5. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga data 01.01.2026
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe " Qendra Sportive Korçe " sh.a.
7. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

K R Y E T A R

ANA VERUSHI

1. Miratuar me _____ vota
2. Vota Pro _____
3. Vota Kundër _____
4. Vota Abstenim _____
5. Zbardhur më datë _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E AKSIONERËVE

VENDIM

Nr _____, datë ____/____/2026

Për miratimin e trajtimit ushqimor dhe dietave për Ekipin e Parë dhe Akademine "Skënderbeu" për vitin 2026

Asambleja e Përgjithshme e aksionarëve të shoqërisë « Qendra Sportive Korçe sh.a » me propozim të Administratorit, dhe bazuar në nenin 135 të ligjit 9901 datë 14.04.2008 « Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare », i ndryshuar si dhe në Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqërisë, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve të anëtarëve :

VENDOSI :

8. Të miratojë trajtimin ushqimor për Ekipin e Parë " Skënderbeu " në vlerën 57.500 lekë në muaj për person për 30 sportistë (futbollistë dhe staf) për 10 muaj dhe dietën ditore për ekipin e parë dhe Akademine " Skënderbeu " për vitin 2026.
9. Kjo pagesë do të kryhet nga Bashkia duke e transferuar fondin tek " Qendra Sportive Korçe " sh.a.
10. " Qendra Sportive Korçe " sh.a detyrohet sipas transferimit të mësipërm të bëjë pagesën mujore për 30 sportistë të federuar (lista do të jetë e firmosur nga drejtuesit e klubit të futbollit " Skënderbeu ").
11. Fondi nuk duhet të kalojë vlerën e miratuar në buxhetin vjetor të vitit 2026
12. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga data 01.01.2026
13. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe " Qendra Sportive Korçe " sh.a.
14. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Eva NAÇI

K R Y E T A R

ANA VERUSHI

6. Miratuar me _____ vota
7. Vota Pro _____
8. Vota Kundër _____
9. Vota Abstenim _____
10. Zbardhur më datë _____